



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 70

Tiranë – E mërkurë, 12 maj 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 251, datë 5.5.2021	Për miratimin e raportit të pestë periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e minoriteteve”..... 6877
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 10.5.2021	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, të pronës me emërtimin “Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8602, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar..... 6953
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 169, datë 21.4.2021	Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar”..... 6955
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 27, datë 5.5.2021	Për disa ndryshime në rregulloren “Për veprimet me fondet në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë”..... 6963
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 47/4, datë 10.5.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Unaza Lindore Tiranë, loti 3”..... 6963



VENDIM
Nr. 251, datë 5.5.2021

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË
PESTË PERIODIK KOMBËTAR MBI
ZBATIMIN E KONVENTËS KUADËR TË
KËSHILLIT TË EVROPËS, “PËR
MBROJTJEN E MINORITETEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 2, të nenit 25, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e minoriteteve”, ratifikuar me ligjin nr. 8496, datë 3.6.1999, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të pestë periodik kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e minoriteteve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RAPORTI I PESTË PERIODIK
PARAQITUR NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MBËSHTETUR NË NENIN 25,
PARAGRAFI 2, TË KONVENTËS KUADËR
TË KËSHILLIT TË EVROPËS “PËR
MBROJTJEN E MINORITETEVE”

PËRMBAJTJA
HYRJE

I. Masat për zbatimin e Konventës Kuadër dhe dialogun me Komitetin Këshillues të Konventës

II. Masat e ndërmarra për të adresuar çështjet për veprime të menjëhershme të identifikuara në ciklin e katërt të monitorimit dhe si një mundësi për të vlerësuar çështjet kryesore gjatë cikleve të raportimit

III. Masat për zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër, masat për zbatimin e

rekomandimeve të tjera të ciklit të katërt të monitorimit

Neni 3 Qëllimi i zbatimit individual të Konventës Kuadër

Neni 4 Ndalimi i diskriminimit

Neni 5 Kultura

Neni 6 Toleranca dhe dialogu ndërkulturor

Neni 8 E drejta për të manifestuar fenë ose besimin dhe krijimin e institucioneve fetare

Neni 9 Akses në media

Neni 10 Përdorimi i gjuhës dhe marrëdhëniet me autoritetet

Neni 11 Emrat, mbiemrat (patronimet), shenjat dhe treguesit topografikë

Neni 12 Arsimit

Neni 13 Hapja e institucioneve private

Neni 14 E drejta për të mësuar dhe t'u mësuar në gjuhën amtare

Neni 15 Pjesëmarrja në jetën publike

Neni 16 Përbërja e popullsisë

Nenet 17–18 Bashkëpunimi dypalësh dhe ndërkombëtar

IV. Informacion mbi zbatimin e të drejtave në nivel vendor

Aneks të Raportit

LISTA E SHKURTIMEVE

AMA Autoriteti i Mediave Audiovizuale

AP Avokati i Popullit

ASCAP Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar

BE Bashkimi Evropian

KK Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

DPSH Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

DNJF Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas

KE Këshilli i Evropës

KMD Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

MASR Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

MEPJ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

MD Ministria e Drejtësisë

MB Ministria e Brendshme

MFE Ministria e Financave dhe Ekonomisë

MSHMS Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

OSHC Organizatë e shoqërisë civile

RSH Republika e Shqipërisë

RTSH Radio-Televizioni Shqiptar

ZVAP Zyra vendore e arsimit parauniversitar



HYRJE

1. Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve¹ është nënshkruar nga Republika e Shqipërisë² më 29.6.1995, ratifikuar me ligjin nr. 8496, datë 3.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve”.

2. Bazuar në nenin 25 (pika 1 dhe pika 2) të Konventës Kuadër prej vitit 2001, Shqipëria ka paraqitur periodikisht pranë Këshillit të Evropës, katër raporte periodike mbi zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër, mbi respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave në Shqipëri³. Në kuadrin e cikleve periodike të monitorimit, pas paraqitjes së Raporteve kombëtare periodike janë miratuar Opinione përkatëse të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër⁴. Pas shqyrtimit të Opinioneve përkatëse të Komitetit Këshillues⁵ dhe paraqitjes së komenteve të autoriteteve shqiptare mbi këto Opinione⁶, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka miratuar rezolutat përkatëse mbi zbatimin e Konventës Kuadër nga Shqipëria⁷.

3. Në kuadrin e ciklit të katërt të monitorimit, masat e ndërmarra nga Shqipëria mbi zbatimin e Konventës Kuadër u shqyrtuan nga Komiteti Këshillues i Konventës Kuadër bazuar në Raportin e katërt të paraqitur nga autoritetet shqiptare në

vitin 2016, si dhe informacionet e mbledhura gjatë vizitës së këtij Komiteti në Shqipëri, në muajin mars 2018, gjatë takimeve me përfaqësues të institucioneve shtetërore, vizitave të zhvilluara në Bashkinë e Tiranës, Finiqit, Himarës dhe Shijakut, si dhe me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore.

4. Pas miratimit dhe publikimit të Opinionit të Komitetit Këshillues dhe kryesisht gjatë vitit 2020 janë zhvilluar diskutimet në Grupin e Raporteve për të Drejtat e Njeriut, mbi projektrezolutën për zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare nga Shqipëria. Në datën 13 janar 2021, në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (KE), u miratua me konsensus Rezoluta për zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare nga Shqipëria.

5. Bazuar në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht neni 25 pika 3, Ministritë dhe institucionet kompetente, sipas fushave, informojnë periodikisht Ministrinë për Evropën dhe Punët të Jashtme (MEPJ), në kuadrin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, në të cilat RSH-së është palë. Bazuar në pikën 4 të këtij neni, MEPJ-ja drejton procesin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, të cilat i paraqet për miratim pranë Këshillit të Ministrave. Në funksion të përgatitjes së këtij Raporti, Ministria e Punëve të Jashtme, si institucioni përgjegjës për hartimin e raporteve kombëtare në kuadër të të drejtave të njeriut ka informuar institucionet kompetente dhe është ngritur një grup pune ndërinstitucional për hartimin e këtij Raporti, mbështetur në urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 5.3.2014, “Për ngritjen e grupit ndërmintor të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”.

6. Raporti është hartuar në përputhje me udhëzimet për përgatitjen e raporteve në kuadrin e ciklit të pestë të monitorimit. Në pjesën e parë të Raportit paraqitet informacion mbi masat e për zbatimin e Konventës Kuadër, procesin e hartimit të raportit dhe vijimin e dialogut me Komitetin Këshillues. Në pjesën e dytë paraqitet informacion mbi masat e ndërmarra për të adresuar çështjet dhe rekomandimet për veprime të menjëhershme të

¹ Këtej e tutje Konventa Kuadër. Versioni anglisht: Framework Convention for the Protection of National Minorities.

² Këtej e tutje RSH.

³ Raporti i parë është paraqitur në korrik 2001; Raporti i dytë paraqitur maj 2007; Raporti i tretë paraqitur janar 2011; Raporti i katërt nëntor 2016.

⁴ Këtej e tutje Komiteti Këshillues.

⁵ Opinioni i parë i Komitetit Këshillues miratuar në shtator 2002 (ACFC/INF/OP/I(2003)004); Opinioni i dytë miratuar në maj 2008 (ACFC/OP/II(2008)003); Opinioni i tretë miratuar në nëntor 2011 (ACFC/OP/III(2011)009). Opinioni i katërt miratuar 11 tetor 2018 dhe publikuar në maj 2019 (ACFC/OP/IV(2018)006). Opinione e cikleve të mëparshme, përfshirë edhe Opinionin e ciklit të katërt gjenden në faqen e internetit: <https://www.coe.int/en/web/minorities/albania>.

⁶ Komentet e Qeverisë shqiptare mbi 4 Opinione, paraqitur përkatësisht: shkurt 2003 (GVT/COM/INF/OP/I(2003)004); dhjetor 2008 (GVT/COM/II(2008)005); qershor 2012 (GVT/COM/III(2012)003); mars 2019 (GVT/COM/IV(2019)002). Komentet respektive gjenden të publikuara në faqen e internetit: <https://www.coe.int/en/web/minorities/albania>.

⁷ Rezolutat e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Ministrave miratuar përkatësisht: maj 2005 – Resolution ResCMN(2005)2; korrik 2009 Resolution CM/ResCMN(2009)5; 12 shkurt 2014 Resolution CM/ResCMN(2014)1. Rezoluta e ciklit të katërt, miratuar janar 2021. Rezolutat përkatëse gjenden të publikuara në faqen e internetit: <https://www.coe.int/en/web/minorities/albania>.

<https://www.coe.int/en/web/minorities/albania>.



identifikuara në ciklin e katërt të monitorimit. Në pjesën e tretë paraqitet informacion mbi masat për zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër dhe rekomandimeve të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër. Në pjesën e katërt të Raportit jepet informacion mbi zbatimin e të drejtave të pakicave në nivel vendor, në disa Bashki të vendit. Pjesë përbërëse e këtij Raporti janë edhe anekset, në të cilat jepet informacion shtesë në funksion të një raportimi gjithëpërfshirës, sipas fushave.

7. Raporti i Pestë Periodik mbi zbatimin e “Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve” miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

I. Masat për zbatimin e Konventës Kuadër dhe vijimin e dialogut me Komitetin Këshillues

8. Ndër objektivat kryesorë në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut është përmirësimi i mëtejshëm i mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve/pakicave kombëtare, zbatimi në praktikë i këtyre të drejtave, në përputhje me angazhimet në kuadër të organizatave ndërkombëtare dhe procesit të integritetit evropian. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” është miratuar nga Kuvendi në muajin tetor 2017 dhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2017.⁸ Ky ligj i hartuar për herë të parë në Shqipëri është bazuar në Konventën Kuadër, angazhimet në kuadrin e procesit të integritetit evropian të vendit, ekspertizën e organizatave ndërkombëtare, praktikat e mira evropiane, nevojat dhe veçoritë e vendit, si dhe zhvillimin e një procesi gjithëpërfshirës të konsultimit me shoqatat e pakicave kombëtare.

9. Ky ligj reflekton dhe përmbush rekomandimet e organeve monitoruese të Konventës Kuadër, rezolutës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, për sa i përket miratimit të një ligji specifik. Procesi i hartimit të ligjit mbi pakicat kombëtare ka qenë një proces gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke vlerësuar shumë të rëndësishëm edhe bashkëpunimin dhe

konsultimin e të gjithë aktorëve, përfshirë shoqatat e pakicave, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe ekspertizën e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Lartë për Pakicat Kombëtare të OSBE-së. Ligji për pakicat kombëtare, i konceptuar si një ligj kuadër adreson të gjitha çështjet substanciale të parashikuara nga Konventa Kuadër dhe listën e të drejtave themelore të pakicave kombëtare të evidentuara nga Komisioni i Venecias. Ligji është vlerësuar në përputhje me standardet evropiane nga ekspertiza ndërkombëtare e Këshillit të Evropës.

10. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” parashikon garancitë ligjore garantimin e të drejtave të pakicave kombëtare si (të drejta individuale), të drejtat dhe liritë themelore, si: drejtat civile, politike, sociale etj., që Kushtetuta dhe kuadri ligjor dhe nënligjor sipas fushave parashikojnë për të gjithë shtetasit shqiptarë. Garantimi i të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare bazohet në kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare: kriteret objektive të cilat kanë të bëjnë me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, gjuhësore të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qenë ose jo pjesë-pjesë e pakicës kombëtare. Ligji nr. 96/2017 plotëson kuadrin ligjor dhe institucional për pakicat kombëtare në Shqipëri, si dhe shërben për qartësimin e politikave ndaj pakicave, duke adresuar rekomandimet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër, gjatë cikleve të mëparshme të monitorimit. Ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij synojnë të garantojnë gëzimin dhe ushtrimin e plotë të të drejtave individuale të personave që u përkasin pakicave kombëtare, për të mbrojtur identitetin e veçantë të pakicave kombëtare, mosdiskriminimin dhe barazinë para ligjit.

11. Ligji adreson një sërë çështjesh që lidhen me: përkufizimin, kriteret ligjore të njohjes, shmangien e dallimeve midis pakicave kombëtare dhe atyre etno-gjuhësore, si dhe përmban parashikime ligjore për garantimin dhe ushtrimin e të drejtave, mekanizmat e përfaqësimit. Kuadri ligjor dhe nënligjor bën të mundur marrjen e masave konkrete për të mbrojtur të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si: e

⁸ Ligji nr. 96/2017 përmban terminologjinë në shqip “pakicat kombëtare”, që është që është i njëjtë me termin minoritete në referim të termit anglisht “national minorities”.



drejta për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, elemente të veçanta që karakterizojnë jetën e komunitetit të tyre, mësimin e gjuhës amtare, veprimtarinë kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj. Ky ligj parashikon përkufizimin e një pakice kombëtare, duke eliminuar diferencimin e dy kategorive të pakicave (pakicave kombëtare dhe etnike-gjuhësore) dhe njohjen formale të pakicave si pakica kombëtare. Për qëllimet e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë, janë: pakica greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

12. Garantimi i të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve/pakicave kombëtare bazohet në kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare: kriteret objektive lidhur me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, gjuhësore të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qenë ose jo pjesë-pjesë e pakicës kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është pandashmërisht e lidhur me kriterin objektiv të identitetit të personit, dhe nuk nënkupton thjesht një të drejtë për një individ që të zgjedhë arbitrarisht që t'i përkasë një pakice kombëtare.

13. Pas publikimit të Opinionit të katërt të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër në muajin mars 2020, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), si institucioni i cili ka rol kryesor në ndjekjen e zbatimit të angazhimeve ndërkombëtare dhe procesin e raportimit mbi zbatimin e konventave për të drejtat e njeriut, ka informuar të gjitha institucionet qendrore dhe të pavarura me qëllim promovimin dhe ndërgjegjësimin mbi rezultatet e ciklit të katërt të monitorimit të Konventës Kuadër. Janë zhvilluar takime periodike me përfaqësuesit e shoqatave të pakicave kombëtare për informimin mbi gjetjet dhe rekomandimet e Opinionit të Komitetit Këshillues.

14. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH” dhe në kuadrin e dialogut me Komitetin Këshillues të Konventës Kuadër, kemi informuar mbi miratimin dhe zbatimin e këtij ligji dhe procesin e hartimit të paketës së akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Në komentet e autoriteteve shqiptare mbi Opinionin e Katërt të Komitetit Këshillues është

paraqitur informacion mbi zbatimin e Konventës Kuadër dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare në vend. Gjetjet dhe rekomandimet e Opinionit të Komitetit Këshillues dhe të Rezolutës mbi zbatimin e Konventës, kanë shërbyer dhe mbajtur parasysh në procesin e hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”.

15. Referuar edhe cikleve të mëparshme të raportimit, ku Opinionet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër janë përkthyer edhe në gjuhët e pakicave kombëtare. Pas publikimit të Opinionit të katërt, në bashkëpunim edhe me Zyrën e Këshillit të Evropës, në kuadër të zbatimit të fazës së dytë të Instrumentit Horizontal Facility për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022 (Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey), do të bëhet i mundur përkthimi i këtij Opinionit edhe në gjuhët e pakicave kombëtare. Ky angazhim nuk është mundur që të realizohet edhe për shkak të vështirësive të krijuara nga pandemia Covid-19.

16. Duke konsideruar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave si pjesë përbërëse e të drejtave të njeriut, si dhe një ndër prioritetet kryesore, Qeveria shqiptare është e angazhuar në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, që rrjedhin nga konventat mbi të drejtat e njeriut. Mbështetur në urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 5.3.2014, “Për ngritjen e grupit ndërministror të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, MEPJ-ja koordinon procesin e përgatitjes së raporteve kombëtare mbi zbatimin e konventave për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe Raportin mbi Konventën Kuadër, në bashkëpunim me institucionet shtetërore, institucionet e pavarura. Ky Raport është hartuar si rezultat i koordinimit të punës dhe përfshirjes së institucioneve qendrore, sipas fushave të kompetencës së tyre mbi çështjet që trajton kjo Konventë.

17. Raporti është përgatitur në bashkëpunim me institucionet qendrore, si: Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Kulturës etj., Komiteti për Pakicat Kombëtare. Në këtë proces në kuadrin e përgatitjes



së Raportit janë informuar institucionet e pavarura, si: Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim marrjen e mendimeve dhe kontributeve të tyre. Me qëllim informimin mbi zbatimin e të drejtave të pakicave kombëtare në nivel vendor, në këtë Raport është përfshirë edhe kontributi i njësive të qeverisjes vendore. Gjithashtu, lidhur me procesin e përgatitjes së Raportit janë informuar edhe shoqatat e pakicave kombëtare, nëpërmjet Komitetit për Pakicat Kombëtare, si institucioni përfaqësues i pakicave kombëtare.

II. Informacion mbi masat e ndërmarra për të adresuar çështjet për veprime të menjëhershme të identifikuar në ciklin e katërt të monitorimit dhe si një mundësi për të vlerësuar çështjet kryesore gjatë cikleve të monitorimit

Rekomandimet për ndërmarrjen e masave të menjëhershme:

- Miratimi i legjislacionit dytësor (kuadrit nënligjor) të nevojshëm për ta bërë ligjin mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare të zbatueshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të dispozitave të Konventës Kuadër për Pakicat Kombëtare.

18. Nxjerrja e akteve nënligjore për pakicat bazohet në dispozitat e ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH” dhe detyrimet që rrjedhin nga Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”. Ky ligj dhe kuadri nënligjor në zbatim të tij parashikojnë dispozita për zbatimin e të drejtave specifike të pakicave kombëtare: vetidentifikimi, mosdiskriminimi, të drejtat arsimore, kulturore, ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të tyre, përfaqësimi në jetën ekonomike, sociale, publike etj., krijimin e kushteve dhe mundësive për ushtrimin e të drejtave specifike lidhur me përdorimin e gjuhës së pakicave në marrëdhëniet me autoritetet, përdorimin e emrave, mbiemrave, treguesit topografikë në gjuhën e pakicave kombëtare, mekanizmin institucional për përfaqësimin e pakicave dhe forcimin e rolit dhe kompetencave të Komitetit Shtetëror të Pakicave Kombëtare; krijimin e Fondit për Pakicat Kombëtare për mbështetjen e nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e

identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar të pakicave kombëtare. Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji veçanërisht për sa i takon mbledhjes së të dhënave, arsimet, përdorimit të gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet administrative, bazohet në kriteret objektive dhe kriterin subjektiv (parimi i vetidentifikimit), siç parashikohet edhe nga ligji nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare” dhe kriteret e parashikuara nga Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është e lidhur me kriterin objektiv përkatës të identitetit të personit (neni 3 i Konventës Kuadër).

19. Në zbatim të ligjit mbi pakicat kombëtare, institucionet përgjegjëse kanë detyrimin ligjor për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji (12 akte nënligjore të parashikuara). MEPJ-ja ka pasur rol drejtues dhe koordinues të Grupit Ndërinstitucional të Punës, nën drejtimin e zv.ministrit të MEPJ-së (urdhri i Kryeministrit në muajin janar 2018), për koordinimin e procesit, zhvillimin e konsultimeve ndërinstitucionale dhe konsultimeve/dëgjësive publike. Është ndjekur rregullisht dhe me vëmendje të shtuar procesi, duke sjellë në vëmendje të institucioneve përgjegjëse hartimin dhe miratimin e paketës së plotë të akteve nënligjore. Gjatë hartimit të paketës së akteve nënligjore në periudhën 2018–aktualisht është synuar vazhdimësia e një procesi sa më gjithëpërfshirës dhe transparent me përfshirjen e të gjithë aktorëve, bazuar në ekspertizën ndërkombëtare (Këshillit të Evropës dhe Komisionerit të Lartë për Pakicat Kombëtare të OSBE-së). Ka vijuar zhvillimi i procesit të gjerë të konsultimit me shoqatat e pakicave kombëtare dhe të grupeve të interesit, bazuar në praktikën pozitive të ndjekur gjatë hartimit të projektligjit mbi pakicat kombëtare.

20. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, gjatë periudhës 2018 – dhjetor 2020 janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore të paketës së akteve nënligjore (8 akte nënligjore nga 12 të parashikuara), katër vendime në fushën e arsimit, dy vendime mbi pjesëmarrjen në jetën publike, sociale, kulturore, dy vendime mbi krijimin dhe



funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare⁹, konkretisht:

1) VKM-ja nr. 561, datë 29.9.2018, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”;

2) VKM-ja nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”;

3) VKM-ja nr. 726, datë 12.12.2018 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare”;

4) VKM-ja nr. 227, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”;

5) VKM-ja nr. 286, datë 10.5.2019, “Për miratimin e procedurave të zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare”;

6) VKM-ja nr. 462, datë 3.7.2019, “Për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë”;

7) VKM-ja nr. 463, datë 3.7.2019 “Mbi përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre”;

8) VKM-ja nr. 1155 datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”.

21. Aktualisht, janë në proces hartimi dhe konsultimi përfundimtar 4 projektvendime

(Komiteti *ad hoc* për njohjen e pakicave, përdorimi i gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet vendore, mbledhja e të dhënave dhe miratimi i Fondit të Pakicave Kombëtare), konkretisht:

1) Projektvendimi, “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr. 96/2017)”.

2) Projektvendimi, “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”.

3) Projektvendimi, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”. Ky projektvendim ka si qëllim garantimin e parimit të vetidentifikimit të personave që u përkasin pakicave dhe verifikimi i të dhënave mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, lidhet me kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare dhe shërben për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji;

4) Projektvendimi, “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e “Fondit për pakicat kombëtare”.

- *Respektimi i parimit të vetidentifikimit; mos mbështetja ekskluzivisht në të dhënat arkivore dhe “provat” e regjistrimit civil për të verifikuar vërtetësinë e vetëdeklarimeve të personave që u përkasin pakicave kombëtare; shfuqizimin e dispozitave të ligjit të vitit 2011, përpara regjistrimit të ardhshëm mbi sanksionet për përgjigje “të pasakta” mbi pyetjen mbi përkatësinë etnike (kombësia), (neni 3 i Konventës Kuadër)*

22. Siç është informuar edhe gjatë cikleve të mëparshme të raportimit, si dhe referuar edhe komenteve të qeverisë shqiptare mbi Opinionin e katërt të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër (publikuar mars 2019)¹⁰, lidhur me censusin e popullsisë dhe banesave, dëshirojmë të theksojmë si vijon: në formularin e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 u përfshi edhe pyetja mbi përkatësinë

⁹ Informacion i detajuar mbi përmbajtjen e akteve nënligjore jepet në vijim, në pjesën e tretë të Raportit dhe ankeset.



etnike, që nënkupton vetëdeklarimin, si një kriter për identifikimin e përkatësisë etnike të popullsisë. Me përfshirjen e pyetjes mbi kombësinë është zbatuar neni 3 i Konventës Kuadër, “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, mbi vetëdeklarimin e përkatësisë etnike dhe neni 20/2 i Kushtetutës, që garanton shprehjen lirisht të përkatësisë etnike. Pyetja lidhur me përkatësinë etnike dhe fetare ka qenë një pyetje fakultative (jo e detyrueshme), që nënkupton se asnjë individ nuk do të kishte arsye për të shtrembëruar të vërtetën dhe për t’iu përgjigjur ose jo kësaj pyetje. Sipas të dhënave të censusit, përqindja e pakicave në Shqipëri në atë vit u llogarit rreth 1.4% e numrit të përgjithshëm të popullsisë banuese në territorin e Shqipërisë¹¹.

23. Sa i takon ligjit për censusin e vitit 2011, sqarojmë se ligji nr. 10 442, datë 7.7.2011 ka bërë disa ndryshime në ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000, “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”, të ndryshuar. Sipas këtij ligji “regjistrimi” është mbledhja e informacionit përmes pyetësorëve dhe përpunimi i të dhënave të tilla, në mënyrë që të sigurojë një listë të plotë të të gjithë individëve, familjeve, banesave dhe ndërtesave të përdorura për qëllime banimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky ligj përmbante një dispozitë të veçantë për informimin e publikut për qëllimin dhe procedurat e regjistrimit, dhe detyrimet ligjore në lidhje me të bëhen publike përmes mediave dhe një fushate të gjerë informacioni, të drejtuar nga INSTAT-i. Ky ligj kishte përcaktuar shkeljet dhe sanksionet përkatëse, me gjobë, e cila përbën kundërvajtje penale: 1) Refuzimi për të bërë deklaratë ose bërja e një deklarimi të rremë; 2) Shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe rregullave të tjera të përcaktuara në këtë ligj. Ligji për regjistrimin e popullsisë parashikonte, gjithashtu, të drejtën e ankimit kundër sanksioneve për kundërvajtje administrative. Nuk ka pasur asnjë rast të aplikimit të kundërvajtjeve për përgjigje “të pasakta” në pyetjen mbi përkatësinë etnike.

24. Në datën 26 nëntor 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Bazuar në ligjin nr. 140/2020 të miratuar në muajin nëntor 2020, censi

do të organizohet dhe kryhet nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Censit dhe me mbështetjen e Komisioneve të Censit që do të ngrihen në çdo Bashki të vendit. Në këtë ligj është përfshirë specifikisht parimi i vetidentifikimit të lirë të përkatësisë etnike, në përputhje me nenin 3 të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, rekomandimet e organeve monitoruese të Këshillit të Evropës dhe rekomandimet në kuadrin e dialogut me Bashkimin Evropian.

25. Ligji nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave” rregullon organizimin dhe realizimin e censit të popullsisë dhe të banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë. Censi i Popullsisë dhe i Banesave është planifikuar të kryhet në vitin 2022 (periudha 1 tetor – 15 nëntor). Censi do të ofrojë informacion për të gjitha temat thelbësore, si: banorët e zakonshëm rezidentë të Shqipërisë dhe karakteristikat e tyre gjeografike, demografike, ekonomike, arsimore, migratore, njësitë ekonomike familjare dhe karakteristikat e banesave, si dhe temat jothelbësore, si: aftësia e kufizuar, etnia, gjuha, feja ose bujqësia. Tematikat mbi të cilat është ndërtuar pyetësori i Censit për marrjen e të dhënave, i referohen rregullores së zbatimit të KE-së nr. 2017/543 dhe rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara. Censi do të krijojë informacionin bazë statistikor mbi popullsinë, ndërtesat dhe banesat për të gjithë territorin e Shqipërisë, i cili është thelbësor për ndërtimin e institucioneve, zhvillimin e qëndrueshëm, demokracinë dhe mirëqeverisjen në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

26. Parashikimet ligjore mbi vetidentifikimin në ligjin nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave”: neni 4/2 “Pyetësori i censit”, parashikon, se: “Pyetësori i censit përmban edhe pyetje për identitetin etnik, gjuhën dhe fenë, përgjigjet e të cilave bazohen në të drejtën e vetidentifikimit të individit. Këto pyetje përmbajnë për të anketuarin alternativën për t’iu përgjigjur “Unë preferoj të mos përgjigjem”. Neni 21/2 “Kundërvajtjet” parashikon, se: “Çdo deklarim ose zgjedhja e alternativës “Unë preferoj të mos përgjigjem”, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji, nuk përbën kundërvajtje administrative. Ky ligj, në nenin 25, parashikon shprehimisht se “ligji nr. 8669, datë 26.10.2000, “Për censusin e

¹¹ Në lidhje me këtë pyetje, kanë preferuar që të mos përgjigjen 13.96% e popullsisë banuese (në totalin e popullsisë banuese shqiptare prej 2.800.138 banorësh).



përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”, i ndryshuar¹², shfuqizohet”.

27. Në kuadrin e zhvillimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave janë parashikuar të realizohen një sërë aktivitete, si: hartimi dhe miratimi i Strategjisë së zhvillimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave Censi i Popullsisë dhe Banesave 2022; informimi dhe komunikimi me ministritë, institucionet, organet e qeverisjes vendore, grupet e interesit. Kryerja e këtij procesi do të realizohet në përputhje me parimet dhe rekomandimet për Censet e Popullsisë dhe Banesave, si dhe në përputhje me angazhimet ndërkombëtare në kuadrin e procesit të integrimit evropian dhe angazhimet në kuadrin e organizatave ndërkombëtare.

- *Parandalimi i pabarazisë dhe diskriminimit ndaj pakicës rome dhe pakicës egjiptiane*¹³

28. Planit Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020, i miratuar me VKM-në nr. 1072, datë 23.12.2015, është i mbështetur, në parimin themelor të mosdiskriminimit. Ky Plan, targeton dy komunitetet përkatëse, dhe parashikon aktivitete për nxitjen e integrimit të romëve dhe egjiptianëve. Planit i Veprimit është hartuar në konsultim të ngushtë me ministritë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga komuniteti rom dhe egjiptian, si dhe aktorë të tjerë. Ky Plan, përfshin politika specifike dhe masa konkrete, që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin në realizimin e objektivave, në sektorët respektivë dhe programet publike, që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Për herë të parë është një plan masash konkrete i shoqëruar me një analizë buxhetore në përputhje me Planifikimin Buxhetor Afatmesëm dhe mbështetjen financiare të partnerëve. Sipas kostimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, pjesë të këtij dokumenti, rezulton se rreth 60% e fondeve të nevojshme për zbatimin e masave, do të mbulohen nga buxheti i shtetit, duke përmblusur në këtë mënyrë edhe rekomandimet e Bashkimit Evropian. Procesi i hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve ka qenë

gjithëpërfshirës me përfshirjen e organizatave rome dhe egjiptiane.

29. Parimet kryesore të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, janë: 1) Nxitja e përfshirjes sociale. - Aktivitetet e Planit të Veprimit synojnë të nxisin përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në shoqëri e jo të krijojnë sisteme paralele për t'u përdorur nga këto komunitete. 2) Përdorimi i një qasjeje të targetuar/synuar për trajtimin e çështjeve specifike të përjashtimit. – Ndërhyrjet e targetuara kanë pasur si synim integrimin e tyre në sistemin e përgjithshëm dhe të përmirësojnë aksesin e tyre në shërbimet publike ekzistuese. 3) Respektimi i dallimeve – Planit i Veprimit respekton dallimet mes komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe brenda vetë këtyre komuniteteve. 4) Angazhimin e romëve dhe egjiptianëve. – Planit i Veprimit përfshin mekanizmat për angazhimin e romëve dhe egjiptianëve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike. 5) Nxitja e bashkëpunimit midis qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, shoqërisë civile, komunitetit ndërkombëtar dhe veçanërisht vet komuniteteve. 6) Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale. – Planit i Veprimit trajton nevojat në një sërë fushash kyçe përfshirë: në dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimin urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integrimit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. 7) Matja e progresit: Planit i Veprimit është i pajisur me tregues për matjen e progresit të zbatimit dhe treguesit fillestarë. 8) Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor: Planit i Veprimit pranon faktin se gratë rome dhe egjiptiane kanë më tepër gjasa të vuajnë përjashtimin dhe diskriminimin gjinor. 9) Buxhetimi për zbatimin: ministritë e linjës kanë identifikuar një buxhet për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, ministritë kanë identifikuar edhe hendeqet e financimit për ndihmë nga donatorë.

30. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është aktualisht në procesin e hartimit të Planit të ri për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve 2021–2025. Procesi është formalizuar me krijimin e grupit të punës me urdhrin nr. 521, datë 23.9.2020 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në dhjetor të 2020-s janë

¹² I ndryshuar me ligjin nr. 10442, datë 7.7.2011.

¹³ Informacion i detajuar jepet në vijim në pjesën e tretë të raportit, mbi zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër dhe të rekomandimeve specifike.



organizuar takime *online* për të gjitha fushat, si: arsimi, mbrojtja sociale, regjistrimi civil dhe aksesi në drejtësi, kujdesi shëndetësor, strehimi social dhe antiracizmi ndaj romëve dhe egjiptianëve. Duke synuar promovimin e integritetit të pakicave rome dhe egjiptiane, morën pjesë nëpunësit civilë të ministrive të linjës dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, si dhe organizatat e shoqërisë civile, për të prezantuar rekomandimet e tyre mbi çështjet që lidhen me Romët. Dokumentet kryesore të përdorura gjatë hartimit të planit, janë: 1) Deklarata e Poznanit, e nënshkruar vitin e kaluar nga kryeministrat e Ballkanit Perëndimor; 2) Kuadri Strategjik i BE-së 2020–2030 për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen; 3) Rekomandimet e seminarit të katërt Shqipëri–BE. Si fushë strategjike për herë të parë është përfshirë fusha e “antiracizmit ndaj romëve dhe egjiptianëve”, me qëllim adresimin e tij në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve strukturore, për të garantuar një shoqëri jodiskriminuese.

31. Në nivel vendor, janë miratuar në disa bashki të vendit planet vendore të zhvillimit të pakicës rome dhe egjiptiane, të cilat adresojnë fusha prioritare për përfshirjen dhe integritetin e këtyre pakicave, si në: punësimin, strehimin, shëndetësinë, ofrimin e shërbimeve, mbrojtjen sociale dhe regjistrimin civil¹⁴. Konkretisht në Bashkinë e Tiranës me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 4, datë 31.1.2018 është miratuar Plani Lokal i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017–2020. Bazuar në Planin Lokal dhe Planin Kombëtar për zhvillimin dhe integritetin e pakicës rome dhe egjiptiane, strukturat e shërbimeve sociale, pranë bashkive, kanë mbështetur dhe ofruar shërbime për individët dhe familjet rome dhe egjiptiane.

32. Gjithashtu, me mbështetjen e Këshillit të Evropës janë hartuar dhe miratuar 7 plane vendore, të cilat kanë në fokus integritetin e pakicave rome dhe egjiptiane. Këto dokumente vendore përfaqësojnë modele të mira ku çështjet rome adresohen në mënyrë ekskluzive, por edhe të përfshira nën një kuadër më të përgjithshëm vendor të kohezionit social midis grupeve të tjera sociale si Plani i Veprimit për Përfshirjen Sociale. Planet e miratuara, janë:

- Roskovec: Plani Social 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Roskovec me vendimin nr. 47, datë 17 maj 2019;

- Fier: Plani Vendor i Veprimit për Integritetin e Pakicës Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Fier me vendimin nr. 73, datë 18 qershor 2019;

- Përmet: Plani Vendor i Veprimit për Integritetin e Pakicës Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Përmet me vendimin nr. 109, datë 19 dhjetor 2019;

- Pogradec: Plani Vendor i Veprimit për Integritetin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec nr. 22, datë 28 janar 2020;

- Vlorë: Plani Vendor i Veprimit për Integritetin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Vlorë nr. 15, datë 27 shkurt 2020;

- Elbasan: Plani Vendor i Veprimit për Integritetin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Elbasan me vendimin nr. 43, datë 30 prill 2020;

- Korçë: Plani Vendor i Veprimit për Integritetin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Korçë me vendimin nr. 47, datë 29 maj 2020.

33. Gjatë muajit dhjetor 2020 u organizuan shtatë takime (*webinare*) konsultative mbi buxhetimin e përgjegjshëm rom në kuadër të programit të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës ROMACTED me bashkitë partnere dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Këto aktivitete patën si qëllim lehtësimin e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje (në distancë) dhe ndërveprimin midis përfaqësuesve të bashkisë dhe grupeve institucionale të punës dhe atyre të pakicave rome dhe egjiptiane dhe grupeve komunitare të veprimit, mbi përfshirjen e nevojave dhe projekteve prioritare të parashikuara në planet vendore për integritetin e pakicave rome dhe egjiptiane në buxhetin e vitit 2021. Buxheti i përgjegjshëm është reflektuar si një prioritet dhe kërkesë kundrejt njësitë të vetëqeverisjes vendore. Faza e 2-të e programit ROMACTED, prej muajit janar 2021, do të vijojë mbështetjen kundrejt zbatimit efektiv dhe monitorimit të planeve

¹⁴ Informacion i detajuar jepet në vijim në pjesën e tretë të Raportit.



vendore rreth në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike dhe partnerë të tjerë vendorë.

- *Qasje efektive në të drejtën për arsimin, hapja e klasave ose shkollave që japin mësim në ose në një gjuhë të pakicës kombëtare*

34. Ligji nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare”, në nenin 13, parashikon të drejtën e arsimit në gjuhën e pakicës: 1) Personat, që i përkasin një pakice kombëtare, gëzojnë të drejtën të mësojnë gjuhën e pakicës. 2) Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato banojnë tradicionalisht ose në numër thelbësor, nëse ka kërkesë të mjaftueshme, u sigurohen mundësi për të mësuar ose për të marrë mësim në gjuhën e pakicës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

- Kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për arsimin dhe çështjet vendore.

- Masat e përshtatshme në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, me qëllim nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare dhe të shumicës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

- Masat e përshtatshme për krijimin e mundësive dhe kushteve për pajisjen me tekste shkollore, formimin fillestar, trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

- Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të hapin dhe të drejtojnë institucione private të sistemit arsimor dhe institucione të arsimit profesional, kur plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi në fushën e arsimit.

35. Siç është evidentuar edhe më sipër në paragrafin 20, në zbatim të ligjit nr. 96/2017, në fushën e arsimit janë miratuar një sërë aktesh nënligjore për garantimin e së drejtës së arsimit të

pakicave kombëtare, hapjen dhe funksionimin e klasave për mësimin e tyre, pajisjen me tekste shkollore etj., konkretisht:

- VKM-ja nr. 561, datë 29.9.2018, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”;

- VKM-ja nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”.

36. Bazuar në VKM-në nr. 561, datë 29.9.2018, nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, njësia arsimore vendore përkatëse dhe komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare. Bazuar në VKM-në nr. 561, klasat në gjuhën e pakicave kombëtare hapen kur numri i nxënësve të pakicave është jo më i vogël se 15 nxënës për klasë, ndërsa në raste të veçanta kur numri i nxënësve të pakicave është më i vogël se 15 nxënës për klasë, funksionimi i klasave me nxënës të pakicave bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

37. Bazuar në VKM-në nr. 227, datë 17.4.2019, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve publike parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”, përgatiten, shtypen, botohen dhe shpërndahen tekstet shkollore në gjuhën amtare të pakicave kombëtare.

38. VKM-ja nr. 1155, datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare” hartohet në zbatim të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- Ky vendim ka për qëllim t’u garantojë personave, që u përkasin pakicave kombëtare, të drejtën për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare në institucione arsimore të caktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, sipas kurrikulave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.



- Vendimi parashikon kriteret, për: 1) Përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore; 2) Numrin thelbësor të nxënësve që u përkasin pakicave; 3) Kërkesën mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare, për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare, konkretisht:

a) numri i personave që i përkasin pakicës kombëtare, i cili duhet të jetë jo më pak se 20 për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative, si nënndarje e bashkisë;

b) periodha e regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas periudhave të regjistrimit të popullsisë, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga regjistrat themeltarë të gjendjes civile dhe/ose Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010. Kjo periudhë të lidhet me periudhat kur është kryer zyrtarisht regjistrimi i popullsisë, fakt që mund të vërtetohet nga regjistrat e gjendjes civile;

c) kërkesa shkresore, paraqitur nga prindër apo kujdestarë të fëmijëve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë bashkisë/njësisë administrative, ku shprehet vullneti në mënyrë shkresore dhe bazuar në të drejtën e vetë identifikimit, të mjaftueshme për formimin e klasës.

- Për krijimin e klasave të pakicave kombëtare, për të lehtësuar dhe mundësuar arsimin e këtyre nxënësve, propozohet që numri i nxënësve për klasë të jetë 15, numër i dallueshëm ky nga krijimi i klasave të tjera të sistemit arsimor parauniversitar.

- Prindërit apo kujdestarët nga ana e tyre do të duhet të shprehin vullnetin e tyre që fëmijët e tyre të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare. Ky vullnet bazohet në të drejtën e vetëidentifikimit të tyre dhe reflektohet përmes kërkesës me shkrim që depozitohet në bashki apo njësinë administrative. Numri i nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare që kanë të drejtën të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, duhet të jetë jo më pak se 15 nxënës për klasë. Ky është numri që vlerësohet si i mjaftueshëm për hapjen e një klase.

- Parashikimin e një numri të ulët nxënësish për krijimin e klasës në bazë të kërkesës shkresore nga prindërit apo kujdestarët e cila lidhet me kërkesën shkresore dhe elementet e saj, sipas përcaktimeve të këtij projektvendimi.

- Parashikimin e rolit të prefektit i cili administron informacionin e dërguar prej tij nga

njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe kryen verifikimin nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara në këtë projektvendim. Prefekti përcakton njësinë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat personat që i përkasin një pakice kombëtare do t'u sigurohet e drejta për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare.

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore i kanë të drejtën e nismës për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në përputhje me parashikimet në ligjore për krijimin dhe funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare.

- *Rishikimi, në konsultim me përfaqësuesit e pakicave kombëtare, i ndikimit të reformës administrative dhe territoriale në aksesin në të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare; zbatimi i pragut prej 20%, i cili kushtëzon aksesin e disa të drejtave të caktuara, për komunitetet lokale (lagjet) në një mënyrë fleksibël*

39. Ligji nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në RSH", parashikon se: "njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë: 61 bashki dhe 12 qarqe. Ndarjet administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, përcaktohen nga ky ligj.

40. Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Në nenin 5 të këtij ligji, parashikohet se: 1) Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë. 2) Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore. 3) Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh. Bashkitë, shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj përcaktohen me ligj. 4) Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore. 5) Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut vendoset në një nga bashkitë që përfshihen në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj. Sipas nenit 6, nënndarjet e bashkisë parashikohet: 1) Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale,



historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj. 2) Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe fshatrave, pjesë e çdo njësie administrative, përcaktohen me ligj. Shpallja e qyteteve të reja bëhet me ligj. 3) Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje. Një lagje, si rregull, mund të krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë. Ndarja e qyteteve në lagje dhe shtrirja e tyre territoriale miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

41. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH”, pika 2 parashikon se “Në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat, që u përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht ose përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj njësie, bazuar në kërkesën e tyre, organet e vetëqeverisjes vendore krijojnë kushtet, për aq sa është e mundur, për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave dhe këtyre organeve. Në pikën 3 të këtij neni parashikohet shprehimisht se “me vendim të organeve të njërive të vetëqeverisjes vendore, ku mbi 20% e banorëve u përkasin pakicave kombëtare, kur ka një kërkesë të mjaftueshme prej tyre, emërtimet e njësive administrative përkatëse, të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe, shfaqen dhe në gjuhën e pakicës përkatëse, sipas parashikimeve ligjore për vetëqeverisjen vendore”.

42. Ligji nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare” ka synuar qartësimin e termit numër thelbësor, nisur nga fakti se edhe vetë Konventa Kuadër parashikon këtë term, por nuk përcakton shprehimisht se çfarë nënkupton. Pragu prej 20% i popullsisë së pakicës kombëtare i parashikuar nga ligji, lidhet me garantimin të së drejtës për përdorimin e gjuhës së pakicës, në marrëdhënie me autoritetet administrative vendore, si dhe vendosjen e toponimeve. Ky prag është një standard i pranuar në përgjithësi bazuar në përvojat evropiane, si dhe rekomanduar nga ekspertiza e Këshillit të Evropës.

III. Masat për zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër dhe masat për zbatimin e rekomandimeve të tjera të ciklit të katërt të monitorimit¹⁵

Neni 3 – Qëllimi dhe fusha e zbatimit të Konventës Kuadër

Rekomandimi 33 – Zbatimi i parimit të lirë të vetidentifikimit

Rekomandimi 34 – Zbatimi i kriterit të shtetësisë në lidhje me aksesin në të drejtat e pakicave kombëtare

43. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare në nenin 3 të tij parashikon se “1. Pakicë kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. 2. Në kuptimin e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

44. Lidhur me njohjen e pakicave kombëtare (pakicave të reja krahas pakicave kombëtare të njohura me këtë ligj, neni 4 i këtij ligji, parashikon: 1. Njohja formale e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, përveç atyre të parashikuara në nenin 3, pika 2, bëhet me ligj, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, dhe nenet 6 e 7 të këtij ligji. 2. Kërkesa për njohje formale depozitohet pranë ministrit përgjegjës për punët e brendshme nga grupi i shtetasve që pretendojnë se i përkasin një pakice kombëtare. 3. Kërkesa shqyrtohet nga një komision *ad hoc*, i cili ngrihet pranë ministrit përgjegjës për punët e brendshme. Ngritja, funksionet e komisionit, si dhe procedurat për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 4. Vendimet e komisionit *ad hoc* mund të ankimohen pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

45. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare” (neni 5 “Ushtrimi i të drejtave”)

¹⁵ Rekomandimet e Opinionit të Katërt të Komitetit Këshillues dhe Rezolutës së Komitetit të Ministrave mbi zbatimin e Konventës Kuadër nga Shqipëria.



parashikon se “Çdo person, që i përket një pakice kombëtare, ka të drejtën të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhura me këtë zgjedhje. 2. Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, i ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë e garantuara me këtë ligj, në mënyrë individuale dhe në komunitet me të tjerët, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky nen është në përputhje me nenin 3 të Konventës Kuadër.

46. Në kuptim të këtij neni, ligji mbi pakicat kombëtare përmban dy parime të veçanta, por të ndërruarura paragrafi 1, i garanton së pari çdo personi që i përket një pakice kombëtare lirinë që të zgjedhin për t’u trajtuar apo jo si të tillë. Ligji krijon mundësinë që çdo personi vendos nëse dëshiron apo jo që të vendoset nën mbrojtjen që sigurojnë edhe parimet e Konventës Kuadër. Ky paragraf nuk nënkupton thjesht një të drejtë për një individ që të zgjedhë arbitrarisht që t’i përkasë një pakice kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është pandashmërisht e lidhur me kriterin objektiv, përkatës të identitetit të personit. Ky nen garanton se nuk do të ketë asnjë disavantazh nga zgjedhja e lirë për atë që ajo garanton, apo nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhura me këtë zgjedhje, si dhe synon të sigurojë që gëzimi i lirisë për të zgjedhur nuk do të cenohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Paragrafi 2 garanton se të drejtat dhe liritë që burojnë nga parimet e Konventës kuadër mund të ushtrohen në mënyrë individuale apo në bashkësi me të tjerët.

Rekomandimi 44 – Mosmbështetja ekskluzive në të dhënat arkivore dhe të dhënat e regjistrat civil për të verifikuar autenticitetin e deklarimeve të personave që u përkasin pakicave

47. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare” parashikon si instrument të mbledhjes së të dhënave bazuar në të drejtën e vetidentifikimit regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë në Republikën e Shqipërisë. Edhe neni 3 i Konventës Kuadër, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare” parashikon se çdo personi që i përket një pakice kombëtare, ka lirinë që të zgjedhë për t’u trajtuar apo jo si të tillë. Zgjedhja subjektive individuale është pandashmërisht e lidhur me kriteret objektive të identitetit të personit. Siç kemi evidentuar më sipër, neni 5 i ligjit nr. 96/2017, i garanton çdo

personi që i përket një pakice kombëtare lirinë që të zgjedhin për t’u trajtuar apo jo si të tillë.

48. Neni 6 i këtij ligji parashikon të drejtën e vetidentifikimit, konkretisht: 1) Çdo person ka të drejtë të deklarojë përkatësinë në një pakicë kombëtare, bazuar në të drejtën e vetidentifikimit, sipas parashikimeve të legjislacionit për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë së Republikës së Shqipërisë dhe në rastet e parashikuara në këtë ligj. 2) Askush nuk mund të detyrohet të zbulojë ose të bëjë publike të dhëna në lidhje me përkatësinë e tij/e saj në një pakicë kombëtare dhe as përkatësinë e tij/e saj etnike, gjuhësore ose fetare, me përjashtim të rasteve kur ky zbulim të dhënash është i nevojshëm për ushtrimin e të drejtave të parashikuara në nenet 3, 7, 11, 12, 13, 14 dhe 15, të këtij ligji.

49. Në nenin 7 të këtij ligji, lidhur me mbledhjen e të dhënave parashikohet: 1) Për garantimin e të drejtave të pakicave kombëtare, institucionet publike në nivel qendror dhe vendor mbledhin të dhëna në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, bazuar në të drejtën e vetidentifikimit të këtyre personave dhe në dokumentacionin e Gjendjes Civile, në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të këtij ligji dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. 2) Kriteret, dokumentacioni, si dhe procedurat përkatëse për mbledhjen e të dhënave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për punët e brendshme.

50. Miratimi akteve nënligjore që lidhet me zbatimin e këtij ligji, veçanërisht për sa i takon njohjes së pakicave të reja, mbledhjes/verifikimit të të dhënave, arsimimit, përdorimit të gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet administrative bazohet në kriterin subjektiv (parimi i vetidentifikimit) dhe kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare, që shërbejnë për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji. Sipas ligjit nr. 96/2017, projektvendimi, “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare” do të propozohet nga Ministria e Brendshme, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga neni 4, pika 3, e ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”. Neni 4, i ligjit nr. 96/2017, parashikon njohjen formale të pakicave kombëtare, përveç 9 pakicave



të njohura (të parashikuara në nenin 3, pika 2). Njohja e pakicave kombëtare (të reja) bëhet me ligj, në përputhje me kriteret e përcaktuara të këtij ligji (neni 3/1, dhe nenet 6 e 7).

- Projektvendimi parashikon që kërkesa për njohje formale paraqitet pranë Ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme nga grupi i shtetasve që pretendojnë se i përkasin një pakice kombëtare, shqyrtohet nga Komisioni *ad hoc* që ngrihet për këtë qëllim, sipas përcaktimeve të të ligjit nr. 96/2017.

- Komisioni *ad hoc*, në përbërje me përfaqësues të institucioneve, fusha e përgjegjësisë së të cilave lidhet me të drejtat e pakicave kombëtare shqyrton kërkesën e paraqitur duke verifikuar plotësimin e kriterëve ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017.

- Ky projektvendim parashikon kompetencën që ka Komisioni për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga grupi i shtetasve, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve/parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 96/2017 (kriteret objektive të identitetit- lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale, shfaqjen e vullnetit për të ruajtur këto elemente, si dhe bazohet në kriterin subjektiv që nënkupton zgjedhjen personale për të qenë ose jo pjesë-pjesë e pakicës kombëtare), nenin 6 (e drejta e vetidentifikimit) dhe nenin 7/1 të këtij ligji, që referon dokumentacionin e gjendjes civile.

- Në rast se pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, vlerësohet plotësimi i kriterëve ligjore, Komisioni vendos pranimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare dhe i paraqet ministrit të Brendshëm propozimin, për vijimin e procedurave për propozimin e projektvendimit mbi projektligjin për njohjen e një pakice kombëtare.

- Siç kemi evidentuar edhe më sipër, drafti i projektvendimit është hartuar nga Ministria e Brendshme dhe është në proces të konsultimit.

51. Projektvendimi Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare” parashikohet të miratohet në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”. Thëksojmë se ky projektvendim, do të bazohet në parimin e

vetidentifikimit të personave që u përkasin pakicave dhe se verifikimi i të dhënave mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare lidhet me kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare dhe shërben për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji.

Siç kemi evidentuar edhe më sipër, drafti i projektvendimit në proces të hartimit dhe konsultimit, sipas detyrimeve të parashikuara nga ligji nr. 96/2017.

Rekomandimi 45 – Miratimi i ligjit mbi censin dhe mbledhja e të dhënave bazuar në parimin e vetidentifikimit të përkatësisë etnike

52. Siç kemi informuar edhe më sipër, në kuadër të punës përgatitore për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2022, INSTAT-i ka përgatitur projektligjin e ri të CENS-it, i cili është diskutuar në komisionet parlamentare, si dhe u votua në parim në seancën parlamentare të datës 26 nëntor 2020. Në ligjin nr. 140/2020, “Për censin e popullsisë dhe banesave” (neni 4/2 “Pyetësori i censit”) parashikohet se pyetësori i censit përmban edhe pyetje për identitetin etnik, përgjigjet e së cilës bazohen në të drejtën e vetidentifikimit të individit. Pyetje mbi identitetin etnik përmban për të anketuarin alternativën për t’iu përgjigjur “Unë preferoj të mos përgjigjem”. Ky ligj parashikon shprehimisht (neni 21/2 “Kundërvajtjet”) se nuk përbën kundërvajtje administrative “Çdo deklaram ose zgjedhja e alternativës “Unë preferoj të mos përgjigjem”. Bazuar në nenin 21, përgjigjet e mbledhura nga këto pyetje nuk do të jenë objekt i sanksioneve (penalitetëve) administrative.

53. Ligji siguron krijimin e bazës ligjore të konsoliduar për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe banesave, duke marrë në konsideratë standardet e reja ndërkombëtare të vendosura për censet e ardhshme të popullsisë dhe banesave, terminologjitë, procedurat dhe institucionet e përfshira. Gjithashtu ai do të mundësojë përputhshmërinë me terminologjitë dhe përkufizimet e legjislacionit të BE-së, si dhe do të mundësojë përmbushjen e rekomandimeve të Konferencës së Stacionienëve Evropiane (CES 2020) për censet e popullsisë dhe banesave.

54. Gjatë hartimit të Pyetësorit të Censit, INSTAT-i ka kryer disa tryeza konsultative me grupet e interesit, ku përmendim përfaqësuesit e pakicave kombëtare. Gjatë tryezave është diskutuar përmbajtja e pyetësorit, si dhe janë mbledhur të



gjitha komentet/sugjerimet e pakicave kombëtare, lidhur me hartimin e pyetjes, përmirësimin e procesit të mbledhjes së të dhënave, diskutimi i problemeve të hasura në censin e kaluar, me qëllim përmirësimin në censin e ardhshëm. INSTAT-i gjatë muajit nëntor 2020 ka organizuar *workshop*-in për pyetësonin e CENS, me qëllim rishikimin e pyetësorit me ekspertë ndërkombëtarë për të siguruar përputhshmërinë e përmbajtjes së tij me rekomandimet ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë të mundësojë relevancën kombëtare në informacionin e mbledhur.

55. Censi i Popullsisë dhe Banesave 2022 do të ndjekë metodën universale të numërimit të drejtpërdrejtë, bazuar në operacionet në terren me përpilimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur metoda të reja për mbledhjen e të dhënave. Censi i Popullsisë dhe Banesave 2022 do të marrë në konsideratë kërkesat e përdoruesve vendas, rekomandimet e fundit ndërkombëtare, në veçanti, rekomandimet dhe standardet e adresuara në vendet evropiane, të Kombeve të Bashkuara dhe nga Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian (EUROSTAT), si dhe duke përfshirë cilësinë e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

56. Tematikat mbi të cilat është ndërtuar pyetësori i Censit për marrjen e të dhënave, i referohen standardeve të BE-së dhe rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara. Censi si operacion statistikor, që do të realizohet nga INSTAT-i, synon të ofrojë të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analiza private e publike të vendimarrjes, për kërkime shkencore dhe, në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes e të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

57. Një element shumë i rëndësishëm për realizimin e aktiviteteve, është zhvillimi i një procesi të gjerë informimi dhe komunikimi në nivel qendror dhe vendor, si dhe informimi dhe komunikimi me publikun e gjerë përfshirë edhe shoqatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare dhe personat që u përkasin pakicave kombëtare, mbi dispozitat ligjore, metodologjinë e censit dhe zhvillimin e tij. Sigurimi i informacioni për temat thelbësore, si dhe temat jothelbësore (ku përfshihet edhe identiteti etnik (përkatësia etnike); organizimi i tryezave informuese dhe fushatave efektive për

komunikim dhe ndërgjegjësim, të të gjithë qytetarëve, grupeve të interesit dhe grupet e synuara, edhe me përfshirjen e shoqatat e pakicave kombëtare dhe personat që u përkasin pakicave kombëtare. Trajnimi i stafit që do të zhvillojë procesin në terren lidhur edhe me pyetjet mbi temat thelbësore dhe jothelbësore (si: identiteti etnik, gjuha dhe feja), përgjigjet e të cilave bazohen në të drejtën e vetidentifikimit të individit. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura gjatë censit, përfshirë edhe të dhënat mbi identitetin etnik, komunikimi dhe transparenca në lidhje me rezultatet e Censit dhe aksesit në informacionin e Censit.

Rekomandimi 47 – Zhvillimi i mekanizmave për mbledhjen e të dhënave të besueshme mbi numrin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si dhe të dhënave mbi aksesin në të drejta, në bashkëpunim me shoqatat e pakicave kombëtare

58. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) pas miratimit të Planit të Veprimit të Integritetit për pakicën romë dhe pakicën egjiptian 2016–2020, ngriti me urdhrë ministri nr. 276, datë 30.12.2016 “Vënien në funksionim të Sistemit ROMALB”. Sistemi ROMALB administrohet nga MSHMS dhe shërben për mbledhjen e të dhënave shtetërore dhe harmonizimin e statistikave për masat e Planit të Veprimit sipas fushave. ROMALB ka shërbyer gjithashtu edhe për monitorimin dhe vlerësimin e situatës së romëve dhe egjiptianëve, si kryerjen e ndërhyrjeve për përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre. Gjithashtu në nivel kombëtar dhe vendor, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore identifikohen të dhëna mbi pakicat kombëtare dhe të dhëna mbi aksesin në të drejta dhe ofrimin e shërbimeve¹⁶.

Neni 4 i Konventës Kuadër “Ndalimi i diskriminimit”

59. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH” (kreu II “Të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare”), neni 5 “Ushtrimi i të drejtave”, parashikon se: 1) Çdo person, që i përket një pakice kombëtare, ka të drejtën të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhura me këtë zgjedhje. 2)

¹⁶ Informacion i detajuar jepet në vijim dhe në anekset pjesë përbërëse e këtij Raporti.



Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, i ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë e garantuara me këtë ligj, në mënyrë individuale dhe në komunitet me të tjerët, në të gjithë territorin e RSH-së. Në nenin 8 të këtij ligji “Ndalimi i diskriminimit” parashikohet se: 1) Ndalohet çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare. 2) Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme:

a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës;

b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional;

c) për të forcuar dialogun ndërkulturor;

d) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional.

3) Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi.

60. Ligji, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka pësuar ndryshime, me ligjin nr. 124/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221 datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” të cilat kanë hyrë në fuqi në nëntor 2020. Ndryshimet ligjore kanë rritur garancitë ligjore për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Me ndryshimet e reja ligjore, përcaktohen forma të reja të diskriminimit, si: diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, veçimi, shqetësimi seksual. Përcaktohen “format e rënda të diskriminimit”, të cilat meritojnë të ndëshkohen më rëndë dhe të parandalohen kudo ku shfaqen.

Rekomandimet 57–58 - Aktivitetet e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Zyrës së Avokatit të Popullit dhe bashkëpunimi mbi zbatimin e rekomandimeve të tyre¹⁷.

61. Struktura e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është zgjeruar në funksion të përmbushjes së kompetencave ligjore, janë shtuar 3 zyra rajonale.

Rekomandimet e paraqitura nga KMD-ja, kanë pasur si qëllim zbatimin e parimeve të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, konkretisht:

- për projektligjin, “Për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

- për projektligjin, “Për programet sociale të strehimit”, janë mbajtur parasysh propozimet;

- mbi projektligjin, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”;

- rekomandim mbi strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane, në zonën e Selitës, Tiranë;

- rekomandime mbi aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”;

- rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për marrjen e masave për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar, të grupeve të disavantazhuara, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuar rome, egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara nga familjet e varfra;

- rekomandim në lidhje me mbështetjen financiare, “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”. Rekomandim për miratimin e një fondi shtesë të skemës së ndihmës ekonomike.

62. Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol aktiv gjatë gjithë procesit të hartimit të projektligjit mbi pakicat kombëtare, duke dhënë vërejtje dhe sugjerime, të cilat janë pasqyruar në një masë të mirë të tyre, në përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Me gjithë zhvillimet pozitive që lidhen me miratimin dhe hyrjen në fuqi, të ligjit nr. 96/2017, apo edhe të miratimit dhe hyrjes në fuqi të disa prej akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, përsëri mbetet problematike pjesa e nxjerrjes në tërësi të të gjitha akteve nënligjore, të parashikuara si të nevojshme, për mundësimin e zbatimit real të këtij ligji.

63. Gjatë procesit të konsultimit të projektligjit, “Për censin e popullsisë dhe të banesave”, Avokati i Popullit ka dhënë rekomandimet lidhur me: “zhvillimin e një censusi të ri të popullsisë, mbi bazën e kriterëve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, ku pakicat, do të gjenin veten për

¹⁷ Informacion i detajuar mbi veprimtarinë e këtyre institucioneve jepet në vijim në pjesën e katërt të Raportit (anekset pjesë përbërëse e raportit).



t'u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre”.

64. Avokati i Popullit ka trajtuar problematikat e pakicës kombëtare rome dhe pakicës kombëtare egjiptiane, të cilët hasin ende shumë pengesa për përfshirjen dhe integrimin në sistemin social: strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, arsimimin, punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor. Nga ana e këtij institucioni, institucioneve përgjegjëse u janë dërguar një sërë rekomandimesh në kuadër të përmirësimit të kushteve të jetesës për integrimin e romëve dhe egjiptianëve¹⁸.

- Rekomandim për plotësimin e kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, drejtuar Kryeministrit. Ky rekomandim është zbatuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, apo edhe të miratimit dhe hyrjes në fuqi të disa prej akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

- Rekomandim për përsheptimin e procesit të miratimit dhe hyrjes në fuqi të akteve nënligjore që duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, drejtuar Kryeministrit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Rekomandim, “Për marrjen e masave të domosdoshme, të menjëhershme, për pakicën rome dhe pakicën egjiptiane. Për evidentimin e numrit real të individëve dhe familjeve në nevojë, pjesë e komuniteteve rome dhe egjiptiane, të vendosura brenda territorit të njësisë administrative, të administruara nga bashkitë, ka pasur një reagim të mirë ndaj këtij rekomandimi nga shumica e njësive të qeverisjes vendore.

- Rekomandim për marrjen e masave të mëtejshme, për përballimin e kostove financiare të sigurimit të barrierave mbrojtëse (maskave) ndaj përhapjes së Covid-19, për personat e pakicës rome dhe pakicës egjiptiane.

65. Sipas Avokatit të Popullit, një çështje sensitive lidhur me problematikat që shqetësojnë komunitetet e pakicave rome dhe egjiptiane në vend, është dëbimi me forcë, nga vendqëndrimet e

tyre komunitare të pozicionuara në periferitë e qyteteve kryesore, ku edhe kanë ndërtuar kryesisht baraka. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, janë adresuar disa lehtësira në fushën e strehimit, për individët dhe familjet rome dhe egjiptiane, si dhe ka një parashikim të përgjithshëm për dëbimet me forcë, por sipas këtij institucioni nuk janë të mjaftueshme. Lidhur me këtë konstatim të Avokatit të Popullit, sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” është miratuar VKM-ja nr. 361, datë 29.5.2019 “Mbi përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi apo strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj dhe të bashkëpunimit institucional”.

66. MSHMS-ja ka mbështetur punën e institucioneve të pavarura duke i vënë në dispozicion informacione dhe materiale që janë kërkuar prej tyre. Gjithashtu, ata kanë qenë pjesë e takimeve konsultative, dialogëve publikë, raportimeve vjetore që MSHMS-ja ka organizuar në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të politikave për integrimin e romëve dhe egjiptianëve. Gjatë procesit të konsultimit dhe hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare” janë informuar dhe marrë mendimet e këtyre institucioneve të pavarura.

Rekomandimi 66 – Parandalimi, lufta kundër pabarazisë dhe diskriminimit të romëve dhe egjiptianëve

67. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me mbështetjen e projektit ROMACTED është fokusuar në zbatimin e politikave specifike të romëve dhe egjiptianëve në nivel vendor. Në vitin 2018 është nënshkruar memorandum i mirëkuptimit në kuadrin e bashkëpunimit trepalësh midis Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe bashkive të Elbasanit, Pogradecit, Korçës, Fierit, Roskovecit, Vlorës dhe Përmetit. Tetë bashki të vendit (Tiranë, Durrës, Shkodër, Berat, Pogradec, Lezhë, Kurbin, Korçë) kanë miratuar plane vendore veprimi për integrimin e romëve dhe egjiptianëve.

68. Garantimi i kujdesit shëndetësor cilësor, të barabartë dhe pa diskriminim për të gjitha gratë, burrat, vajzat e djemtë romë dhe egjiptianë është prioritet i MSHMS-së, i adresuar në mënyrë të vazhdueshme përmes masave të veçanta që synojnë

¹⁸ Informacion i detajuar jepet në pjesën e katërt të Raportit – anekset pjesë përbërëse e tij.



përmirësimin e aksesit në shëndetësi të grupeve më në nevojë. Në kuadër të programit të kujdesit shëndetësor të komunitetit, vëmendje të veçantë i kushtohet vaksinimit, mamografisë dhe shërbimeve të tjera parandaluese, përmes qasjes me shërbime afër vendbanimit për kategoritë e veçanta, veçanërisht për pakicat rome dhe egjiptiane. Kontakti i drejtpërdrejtë në komunitet dhe dhënia e informacionit mbi kujdesin shëndetësor me një gjuhë të përshtatshme e lehtësisht të kuptueshme për pakicat rome e egjiptiane, është një përparësi e këtij programi, paralelisht me rritjen e aksesit në shërbimet shëndetësore atje ku ata jetojnë.

69. Me miratimin e Strategjisë së re të Kujdesit Parësor po punohet për të bashkërenduar kujdesin shëndetësor me atë social. Një ndër qëllimet e Strategjisë së re është sigurimi i shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale për t'iu përgjigjur nevojave individuale të individëve dhe grupeve të cënueshme, me fokus të veçantë gratë dhe vajzat që pësojnë diskriminim të shumëfishtë.

70. Organizatat e shoqërisë civile marrin pjesë në takimet kombëtare dhe rajonale që organizohen nga MSHMS-ja dhe partnerët. Gjatë viteve 2016–2020 organizata janë ftuar në: a) Takimet vjetore në kuadër të monitorimit të planit të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve 2016–2020; b) Seminaret e dialogut publik midis Qeverisë së Shqipërisë dhe BE-së; c) Takime rajonale për zbatimin deklaratës së Poznanit; d) Takimet konsultative për hartimin e Planit të ri për integrimin e romëve dhe egjiptianëve 2021–2025; e) Takime sipas çështjeve, fushave dhe problematikave që organizohen.

71. Në zbatim të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, strukturat e Policisë së Shtetit garantojnë respektimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe në veçanti për personat e privuar nga liria (ku përfshihen dhe personat që u përkasin pakicave kombëtare) në përputhje me parimin e mosdiskriminimit. Janë ndjekur me përparësi, zbatimi i procedurave standarde për parandalimin dhe eliminimin e ushtrimit të dhunës, keqtrajtimeve dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare, si dhe ndëshkimin disiplinor apo penal në raste të tilla, për punonjësit e policisë.

72. Personave të ndaluar apo arrestuar që u përkasin pakicave kombëtare përfshirë pakicën rome dhe egjiptiane, u garantohen dhe respektohen të drejtat ligjore në mënyrë të barabartë, dhe pa

diskriminim, ushtrimi i së drejtës për të bërë/paraqitur kërkesë apo ankesa lidhur me trajtimin që u bëhet në ambientet e policisë, kushtet e qëndrimit, veprimet e sjelljet e personelit policor, shkeljet dhe cenimet e të drejtave që mund t'u bëhen nga punonjësit e policisë. Nga ana e strukturave qendrore të Policisë së Shtetit në vazhdimësi janë përgatitur dhe dërguar për njohje dhe zbatim gjithë strukturave të Policisë akte të tilla administrative, si: tërheqje vëmendje, letër porosi, përschkrime, përgjithësime, urdhra etj. Në përmbushje të këtij detyrimi, janë përcaktuar rregullat dhe procedurat standarde për marrjen, evidentimin, trajtimin/zgjidhjen e kërkesë/ankesave të këtyre personave. Procedurat standarde mbi “Trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë ankesave të tyre”, janë rishikuar dhe miratuar me urdhrin nr. 925, datë 18.7.2019, të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

73. Policia e Shtetit bashkëpunon me institucionet e pavarura, Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në mbështetje, të promovimit të kuadrit ligjor, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe ligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare, sipas detyrimeve në fushën e zbatimit të Policisë së Shtetit. Janë organizuar aktivitete bashkëpunimi të strukturave të Policisë së Shtetit me institucionet e pavarura:

- gjatë vitit 2018, janë realizuar 5 takime dhe tryeza me Komisionerin kundër Mbrojtjes nga Diskriminimi, si dhe organizata të komunitetit egjiptian dhe rom;

- gjatë vitit 2019, janë realizuar 10 takime mbi rekomandimet e Avokatit të Popullit mbi të drejtat e grave të dhunuara, pakicave kombëtare (romë dhe egjiptianë);

- gjatë vitit 2020, janë realizuar 10 takime me partnerët ndërkombëtar mbi parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, mbrojtjen e pakicave kombëtare, me Institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

74. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) nga viti 2016 – aktualisht ka



trajtuar rastet e mëposhtme, lidhur me pakicat kombëtare¹⁹:

- gjatë vitit 2016, janë trajtuar, 82 çështje (75 ankesa dhe 7 *ex-officio*) (sipas fushave: 16 arsim; 10 punësim dhe 56 shërbime);

- në vitin 2016, Komisioneri është shprehur me 70 vendime dhe 2 rekomandime në fushën e arsimit;

- gjatë vitit 2017, janë trajtuar, 92 çështje (89 ankesa dhe 3 çështje *ex-officio*);

- në vitin 2017, Komisioneri është shprehur me 72 vendime dhe 1 rekomandim në fushën e arsimit;

- gjatë vitit 2018, janë trajtuar, 63 çështje (59 ankesa dhe 4 çështje *ex-officio*);

- gjatë vitit 2018, Komisioneri është shprehur me 64 vendime: 41 vendime themeli, 20 vendime mospranimi; dhe 1 vendim pezullim shqyrtimi, 2 vendime ndërprerje të procedurave.

- gjatë vitit 2019, janë trajtuar, 35 çështje (33 ankesa dhe 2 çështje *ex-officio*);

- gjatë vitit 2019, KMD-ja është shprehur me 33 vendime: 26 vendime themeli, 4 vendime mospranimi dhe 3 vendime ndërprerje të procedurave;

- gjatë vitit 2020, janë trajtuar, 16 çështje (15 ankesa dhe 1 çështje *ex-officio*), me subjekte: 4 meshkuj; 4 femra, 4 grup personash dhe 3 organizata të shoqërisë civile (OJF);

- gjatë periudhës janar–nëntor 2020, Komisioneri KMD është shprehur me 14 vendime: 12 vendime themeli dhe 2 vendime mospranimi.

Rekomandimi 67 – Zbatimi efektiv dhe financimi i Planit Kombëtar të Veprimit

75. Plan i Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020 targeton dy pakicat përkatëse dhe parashikon aktivitete për nxitjen e integritetit të romëve dhe egjiptianëve me fondet e parashikuara nga buxheti i shtetit, por duke identifikuar edhe hendekun financiar për periudhën 2016–2020, si dhe mundësinë e financimit nëpërmjet koordinimit me ndihmën e huaj.

76. Ky Plan Veprimi përfshin një buxhet të caktuar për zbatimin e çdo veprimtarie. Në varësi të llojit të veprimtarisë, Plan i Veprimit specifikon: a) financimin nga qeveria, b) financimin nga

donatorët, c) kombinimin e financimit nga qeveria dhe financimit nga donatorët. Analiza buxhetore që shoqëron këtë Plan tregon që burimet për financimin e zbatimit të Planit do të mbulohen 55% nga fondet e buxhetit të shtetit dhe 45% nga fondet e donatorëve. Nuk janë përfshirë gjithashtu buxhetet e bashkive, sepse ato do të pasqyrohen në planet lokale të veprimit për romët dhe egjiptianët (ndërsa plani kombëtar fokusohet në burimet dhe përgjegjësitë kombëtare). Megjithatë, në Planin e Veprimit janë përfshirë fondet e ministrive që u akordohen bashkive (p.sh. nëpërmjet granteve të vogla në fushën e strehimit apo ndihma ekonomike etj.).

- Neni 5 i Konventës Kuadër Politika për mbështetjen e kulturave të pakicave kombëtare – rekomandimet 74–75

77. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare në nenin 12 “Ruajtja e identitetit kulturor të pakicave kombëtare” parashikon se: 1. Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre gjuhësor, kulturor, fetar dhe trashëgiminë e tyre kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë, në përputhje me përcaktimet e nenit 2, të këtij ligji, të drejtën e kreutimit të ngjarjeve që lidhen me promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor. 3. Strategjitë, programet dhe planet e veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që pakicat kombëtare të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për arsimin dhe kulturën. 4. Pa cenuar masat e marra në përputhje me politikën e integritetit të përgjithshëm të pakicave kombëtare, ndalohen politikat apo praktikatat që synojnë asimilimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre.

78. VKM-ja nr. 462, datë 3.7.2019, “Për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë” parashikon bazën ligjore për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për sigurimin e pjesëmarrjes së personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike. Personave, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, u garantohet

¹⁹ Informacion i detajuar mbi veprimtarinë e KMD-së, rastet e trajtuara jepet në vijim, në anekset, pjesë përbërëse e Raportit.



pjesëmarrje e barabartë në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit. Ky vendim parashikon ndër të tjera se “Personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë, në veçanti, të drejta lidhur me çështjet për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kulturës, të traditave dhe identitetit të pakicës, së cilës ata i përkasin”.

79. Për projektet e paraqitura nga pakicat kombëtare parashikohet për herë të parë, përcaktimi me përqindje për projektet nga pakicat kombëtare, konkretisht: “Nga numri i përgjithshëm i projekteve që do të financohen, 5% e tyre të mbështeten me burime financiare, logjistike dhe/ose materiale për shoqatat kulturore/individët, të cilët kanë aplikuar dhe që u përkasin pakicave kombëtare”. VKM-ja parashikon se Ministria e Kulturës, në projektet me thirrje, që organizon çdo vit, mbështet financiarisht, bazuar edhe në nivelin cilësor, projektet e personave që u përkasin pakicave kombëtare në drejtim të mbrojtjes së identitetit kulturor, etnik e gjuhësor dhe trashëgiminë kulturore të tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të pakicave kombëtare në projekte të ndryshme bëhen në përputhje me ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, dhe udhëzimin e përvitshëm që nxjerr Ministria e Kulturës, “Për thirrjet për projektpropozime”.

80. Gjithashtu, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare” është miratuar VKM nr. 463, datë 3.7.2019, “Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre” me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky vendim parashikon se: Personat që u përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre të dallueshëm në Republikën e Shqipërisë. 2. Ministria përgjegjëse në fushën e kulturës dhe ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë kanë detyrimin për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve e të planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat, që u përkasin pakicave kombëtare për

të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të tyre.

81. Ky vendim parashikon:

- ministria përgjegjëse në fushën e kulturës dhe ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë garantojnë mbrojtjen dhe promovimin e gjuhës së personave, që u përkasin pakicave kombëtare, si një element përbërës të identitetit të tyre;

- ministria përgjegjëse për kulturën dhe institucionet në varësi të saj marrin masat për të krijuar kushtet e nevojshme për garantimin dhe ushtrimin e së drejtës së personave, që u përkasin pakicave kombëtare për ruajtjen e zhvillimin e identitetit të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor e fetar të tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. 5. Ministria përgjegjëse për kulturën, në strategjinë për kulturën dhe në programin kombëtar “Edukimi përmes kulturës” parashikon dhe krijon kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen, katalogimin e digjitalizimin për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave, që u përkasin pakicave kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare dhe ndalimin e praktikave, që synojnë asimilimin e kulturës dhe të identitetit të tyre të dallueshëm;

- ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë planifikon veprimtari të veçanta për institucionet publike të arsimit parauniversitar, me qëllim ruajtjen, promovimin, zhvillimin e kulturave, identitetin kulturor të dallueshëm dhe të gjuhëve të pakicave kombëtare;

- ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë mbështet të rinjtë e organizatat rinore për organizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe promovuese për ruajtjen e zhvillimin e kulturave, të identitetit dhe të gjuhëve të pakicave kombëtare, si dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare;

- ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë dhe ministria përgjegjëse në fushën e kulturës promovojnë programe e projekte për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave, gjuhëve dhe elementeve kryesore të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare, zhvillimin e aktiviteteve në konsultim me ta dhe përfaqësuesit e tyre, bazuar në nevojat e grupeve të ndryshme dhe në përputhje me procedura transparente;



- kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, ku aplikojnë përfaqësues të pakicave kombëtare janë të parashikuara në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

- burimet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të mbulohen nga buxheti vjetor që parashikohet çdo vit për ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

82. Ligji nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën” synon të sigurojë mbështetjen e pakicave kombëtare, dialogut ndërkulturor, përmes aktiviteteve artistiko-kulturore. Në nenin 32 parashikohet se pushteti qendror parashikon për pushtetin vendor financimin në masën 30% nga fondet për kulturën duke mirë menaxhuar dhe shfrytëzuar programin dedikuar artit dhe kulturës.

83. Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025, pas dëgjësive me të gjitha grupet e interesit, u miratua me VKM-në nr. 903, datë 24.12.2019. Kjo Strategji ka si qëllim “Nxitjen dhe përfaqësimin e vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimin e praktikave më të mira. Si objektiv specifik parashikohet “Promovimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore”. Për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare në vend do të përcaktohet mbështetja financiare e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe studimore të kësaj trashëgimie me synim mbrojtjen dhe katalogimin e digjitalizimin për ruajtje të kulturës e identitetit të pakicave kombëtare dhe ndalimin e praktikave, që synojnë asimilimin e kulturës dhe të identitetit të tyre të dallueshëm. Ky aktivitet do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin e Pakicave Kombëtare.

84. “Edukimi përmes kulturës” parashikon dhe krijon kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen, katalogimin e digjitalizimin për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare.

85. Objektivi i Ministrisë së Kulturës (MK) është sigurimi i një aksesimi më të madh dhe pjesëmarrje aktive në kulturë duke zhvilluar dhe zbatuar projekte që mbrojnë dhe promovojnë identitetin kulturor dhe gjuhët e pakicave kombëtare.

Aktivitetet në përmbushje të këtij objekti janë: 1) Mbështetja financiare nga MK-ja e rrjetit të aktiviteteve të organizuara nga shoqatat kulturore të pakicave kombëtare apo që përfshijnë kulturën e grupeve të ndryshme kulturore. 2) Publikimi i literaturës së shkruar në gjuhën e pakicave, me ose pa përkthim në gjuhën shqipe. 3) Rritja e përfaqësimit të grupeve nga pakicat kombëtare në festivalet artistike kombëtare e ndërkombëtare të organizuara nga MK-ja. 4) Dhënia e asistencës profesionale dhe këshillimit për standardet e dokumentimit të diversitetit dhe trashëgimisë jomateriale të pakicave (trajnime, seminare).

86. Ministria e Kulturës bazuar në ligjin nr. 96, datë 13.10.2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të tij ka në fokus integrimin e vlerave kulturore të komuniteteve dhe pakicave kombëtare që jetojnë në vendin tonë në të gjitha veprimtaritë kombëtare që ajo zhvillon, sidomos në ato të trashëgimisë kulturore jomateriale. Në këtë linjë, Ministria e Kulturës vijon të mbështesë financiarisht organizime ndër më prioritaret me të njëjtin fokus, duke përmendur aktivitete si:

- “Përmeti multikulturor, minoritete dhe etni” Festivali Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës. Në kriteret shkencore të pjesëmarrjes parashikohet pasqyrimi si pjesë të trashëgimisë kulturore shpirtërore kombëtare, të gjitha ato vlera të krijuara nga pakicat kombëtare.”

- Festivali Multikulturor Berat;

- Kremtimi i 8 Prillit, Ditës Botërore të Romëve;

- Mbështetje financiare për botime veprash letrare mbi romët në Shqipëri;

- Mbështetje financiare për organizimin e projektit “Ditët e minoritetit rom në Shqipëri”;

- Mbështetje financiare për koncert festiv me muzikë dhe veshje tradicionale nga pakica rome;

- Kremtimi i 5 majit, Ditës së Shën Gjergjit (Herdelezi) – festë nga trashëgimia kulturore e pakicës rome;

- Kremtimi i Ditës Ndërkombëtare të Vllehëve;

- Organizimi i takimit botëror të Vllahëve në Ditën e Shën Mërisë në Voskopojë;

- Promovime veprash letrare dhe historike mbi pakicën arumune në Shqipëri;

- Organizimi i takimeve me pakicën maqedonase në Prespë;

- Mbështetje financiare për koncertin folklorik të pakicave kombëtare në Sarandë.



- Sigurimi i një aksesit më të lartë dhe pjesëmarrje aktive në kulturë nga pakicat kombëtare mund të sigurohen duke zhvilluar dhe zbatuar projekte që mbrojnë dhe promovojnë identitetin kulturor dhe gjuhën e tyre, si:

- dhënia e asistencës profesionale dhe këshillimit për standardet e dokumentimit të diversitetit dhe trashëgimisë jomateriale (trajtime, seminare);

- mbështetja financiare nga MK-ja e rrejtit të aktiviteteve të organizuara nga shoqatat kulturore sidomos të punës kërkimore në bashkëpunim dhe me pushtetin vendor;

- publikimi i literaturës së shkruar në gjuhët e pakicave kombëtare, së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe;

- rritja e përfaqësimit të grupeve të pakicave kombëtare në festivalet artistike kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga Ministria e Kulturës etj.

Neni 6 – Toleranca dhe dialogu ndërkulturor – rekomandimet 80–81–88–89, 90

87. Ligji, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, është një garanci lidhur me respektimin e të drejtave të pakicave pa diskriminim, në fushat si arsim, punësim, të mira dhe shërbime. Me ligjin nr. 124/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, u miratuan më 15.10.2020 ndryshimet ligjore në ligjin, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të cilat hynë në fuqi më 18 nëntor 2020. Janë shtuar shkaqe të reja të diskriminimit si diskriminimi për shkak shtetësisë, karakteristikat e seksit, jetesë me HIV/AIDS dhe pamja e jashtme.

88. Ligji nr. 10221, më datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 “Objekti” parashikon shprehimisht se: Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, shoqërore, nivelin arsimor, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

89. Në ndryshimet e reja ligjore, përcaktohen:

- forma të reja të diskriminimit, si: diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, veçimi, shqetësimi seksual;

- “format e rënda të diskriminimit”, të cilat meritojnë të ndëshkohen më rëndë dhe të parandalohen kudo ku shfaqen;

- përcaktohet roli aktiv i organizatave me interesa legjitime duke u mundësuar atyre paraqitjen e ankesave drejtpërdrejtë pranë institucionit ose mund të paraqesin informacion të besueshëm për nisjen e hetimeve kryesisht nga Komisioneri;

- përcaktohet detyrimi i autoriteteve publike për të promovuar barazinë dhe mosdiskriminimin;

- një nga risitë e ligjit është “zhvendosja e barrës së provës”, duke i kaluar subjektit ndaj të cilit pretendohet se ka kryer sjellje diskriminuese. Sigurimi i zhvendosjes së barrës së provës në ligjin, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” do të bënte që ai parim të zbatohet në çdo fushë dhe në të gjitha rastet kur pretendohet se nuk zbatohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit;

- si shtesë e re në ligj, është mundësia e marrjes së ekspertëve kur shqyrtohet çështja në varësi të kompleksitetit të fushës ku po hetohet (mendim profesional). Ndryshimet sigurojnë gjithashtu, mundësinë e bashkimit të rasteve, për ekonomi procedurale, që vijnë nga subjekte të ndryshme, por që kanë të njëjtin objekt dhe i referohen së njëjtës sjelljeje diskriminuese të pretenduar.

- Komisionerit KMD i është shtuar edhe një kompetencë e re, krahas monitorimit të zbatimit të ligjit, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, siç është monitorimi i zbatimit të ligjit, “Për barazinë gjinore në shoqëri”;

- ndryshimet ligjore kanë parashikuar gjithashtu, kompetencën e Komisionerit, për të paraqitur padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive dhe të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;

- me ndryshimet ligjore, vendimet me gjobë të Komisionerit KMD do të konsiderohen si “Tituj ekzekutivë”, për lehtësimin e procedurave të ekzekutimit të gjobave (pas vendimit të gjykatës për lëshim urdhri ekzekutimi).

90. Ndryshimet ligjore mundësojnë detyrimin e medias kombëtare për të publikuar vendimet e



Komisionerit KMD që kanë gjetur diskriminim përmes gjuhës së urrejtjes. Vendosja e një detyrimi të tillë do të mundësojë një efektivitet më të madh. Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut ndryshimet e fundit ligjore në ligjin, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (neni 33, pika 17), parashikojnë se: “Operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt gjuhën e urrejtjes”. Gjithashtu, në kuadër të ndryshimeve ligjore është parashikuar detyrimi i autoriteteve publike për të promovuar barazinë, për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (neni 7/3).

91. Detyrimi i publikimit vetëm për këtë formë diskriminimi lidhet së pari me faktin që konsumimi i kësaj sjelljeje ndodh publikisht, prandaj dhe vendimi i marrë duhet të këtë rezonance publike; se dyti, lidhet me efektshmërinë e vendimeve të Komisionerit në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga personat publike. Vendosja e një detyrimi të tillë do të mundësojë rritjen e efektivitetit të tij.

92. Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të Komisionerit (KMD), gjithashtu edhe të përfaqësuesve në zyrat rajonale në qytetin e Fierit, të Shkodrës dhe të Korçës. Aktivitetet ndërgjegjëse kanë qëllim nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave kombëtare; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

- *Rekomandimi 81 – Ndihma juridike falas*

93. Me zbatimin e reformës në drejtësi, një reformë e thellë që preku në tërësi çdo element të sistemit të drejtësisë, pati edhe një reformim të thellë të sistemit të ndihmës juridike falas, duke ofruar një frymë të re, në sinkron me kërkesat dhe

legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë eficiente dhe efektive.

94. Nenet 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike falas” përcaktojnë subjektet që përfitojnë nga skema e ndihmës juridike falas, duke i dhënë një vend të veçantë të miturve në konflikt me ligjin, të miturve viktimat të veprave penale, të miturit të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, si dhe të miturit që janë nën kujdestari. Përfitues të ndihmës juridike falas janë edhe viktimat e dhunës në familje, viktimave e të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore

95. Pas krijimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë ka pasur zhvillime të rëndësishme në kuadër të forcimit të aksesit në drejtësi përmes shërbimeve të ndihmës juridike falas. Tashmë është miratuar i gjithë kuadri ligjor për ndihmën Juridike. Në zbatim të ligjit janë miratuar të gjitha 13 aktet nënligjore që ligji parashikon. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë pasur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin më të mëdha.

96. Në vitin 2020 u mundësua për herë të parë një konsolidim i sistemit të ndihmës juridike parësore përmes garantimit të një sërë ofruesish dhe konkretisht:

- 7 (shtatë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Gjirokastrë;

- 12 (dymbëdhjetë) organizata jofitimprurëse të autorizuar që operojnë në Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Shkodër;

- 9 (nëntë) klinika ligjore pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë, Vlorë, Durrës, Shkodër.

97. Një nga risitë thelbësore të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” është përcaktimi i organizatave jofitimprurëse të autorizuar si ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Për herë të parë parashikohet një procedurë tërësisht e re, procedurë, e cila ka për qëllim të autorizojë dhe financojë organizata jofitimprurëse për të ofruar



ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti në rrethin ku këto organizata operojnë.

98. Organizatat jofitimprurëse krahas qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe klinikave të ligjit pranë institucioneve të arsimit të lartë, përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas të qytetarët në mënyrë profesionale dhe cilësore, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Të gjitha këto organizata janë të angazhuara në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike falas për të miturit (si kategori e veçantë drejtpërdrejt përfutuese e këtij shërbimi). Gjithashtu, njëra prej këtyre organizatave të autorizuar nga ministri i Drejtësisë është e dedikuar posaçërisht në ofrimin e këtij shërbimi për të miturit.

99. Gjithashtu, në vitin 2020 u mundësua për herë të parë, një platformë *online* e dedikuar shërbimeve ligjore falas²⁰, si dhe vendosja në dispozicion i numrit të gjelbër 08001010. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundësuar për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore *online* përmes platformës juristionline.al.

100. Në vitin 2020 rezultojnë 73 avokatë në listën e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore. Për të garantuar rregullsi, transparencë dhe cilësi në ofrimin e ndihmës juridike janë miratuar edhe udhëzimet për rregullat e zbatimit të tarifave dhe parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore. Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë është sanksionuar për herë të parë një metodologji sa i përket mënyrës së mbikëqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimit të të gjithë ofruesve të ndihmës juridike falas. Gjatë vitit 2020 ka përfunduar mbikëqyrja dhe monitorimi 3-mujor i qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, si dhe ka përfunduar faza e parë e monitorimit për të gjithë avokatët e ndihmës juridike dytësore, sipas qyteteve ku ofrojnë shërbimin.

- *Rekomandimi 81 – Mbrojtja e grave dhe fëmijëve nga komunitetet vulnerabël nga dhuna shfrytëzimi dhe abuzimi*

101. Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare²¹, janë marrë masa konkrete ligjore, institucionale për të eliminuar të gjitha llojet e format e dhunës duke pasur në vëmendje gratë dhe vajzat nga grupet e marxhinalizuara, të cilat përballen dhe me diskriminimin e shumëfishtë. Kuadri i politikave për barazi gjinore, luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore garanton gëzimin e të drejtave dhe për gratë dhe vajzat romë. Ndryshimet e fundit të ligjit, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të cilat hynë fuqi në datën 18.11.2020, janë një garanci më e madhe për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe pritjet të rrisin efektivitetin në trajtimin e rasteve. Fushata e 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore i jep një rëndësi të veçantë grave dhe vajzave nga grupet e marxhinalizuara.

102. Kuadri ligjor, ndërkombëtar dhe i brendshëm, që normon punën e Policisë së Shtetit për realizimin e misionit të saj, garanton të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve në territorin RSH-së, përfshirë dhe të drejtat e pakicave kombëtare, pa dallime për shkaqe si, gjinia, raca, feja, etnia, gjuhës, bindjet politike, fetare, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, raciale, përkatësisë etnike dhe fetare. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

103. Policia e Shtetit, trajton të gjitha rastet e dhunës në familje sipas, detyrimeve që burojnë nga ky ligj, pa diskriminim dhe vetëm sipas procedurave standarde të punës. Të dhënat që mbledh dhe administron Policia e Shtetit nuk janë të ndara sipas përkatësisë etnike, si rrjedhojë nuk mund të vihen në dispozicion të dhëna specifike për viktima të dhunës me përkatësi etnike të ndryshme, që jetojnë në RSH. Të dhënat e kërkuara jepen për të miturit viktima të veprës penale, neni 124/b, ku përmbledhet keqtrajtimi fizik apo psikologjik, detyrimi, shfrytëzimi, përdorimi ose shtytja për të punuar apo lypur, si rrjedhojë nuk mund të veçohen rastet e lypjes.

²¹ Konventa e OKB-së, “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW; Konventa e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit)).

²⁰ www.juristionline.al.



Këto të dhëna nuk administrohen në bazë të përkatësisë etnike të të miturit.

104. Të dhëna statistikore për “Keqtrajtimin e të miturve”, neni 124/b i Kodit Penal, për periudhën 2016–2020, janë:

- gjatë vitit 2016 – janë evidentuar 35 të mitur të dëmtuar;
- gjatë vitit 2017 – janë evidentuar 41 të mitur të dëmtuar;
- gjatë vitit 2018 – janë evidentuar 32 të mitur të dëmtuar;
- gjatë vitit 2019 – janë evidentuar 20 të mitur të dëmtuar;
- gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2020 – janë evidentuar 18 të mitur të dëmtuar.

105. Në kuadër të parandalimit dhe goditjes së fenomenit të trafikimit të personave, nga ana e strukturave kundër trafikëve të paligjshme është punuar për rritjen e numrit të hetimeve proaktive, rritjen e identifikimit të hershëm të viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe marrjen e masave mbrojtëse e trajtimin e tyre, sipas procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

- Për vitin 2016 – janë evidentuar 21 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 21 autorë.
- Për vitin 2017 – janë evidentuar 22 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 25 autorë.
- Për vitin 2018 – janë evidentuar 8 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 9 autorë.
- Për vitin 2019 – janë evidentuar 7 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 8 autorë.
- Për 6-mujorin e parë të vitit vitin 2020 janë evidentuar 4 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 4 autorë.

- Gjuha e urrejtjes

106. Për periudhën 2016–2020, janë zbatuar rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë ndërmarrë hapa konkretë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, masa në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, duke zbatuar rekomandimet e këtyre institucioneve, mbi parandalimin e fyerjes nga ana e punonjësve të Policisë apo gjuhën e urrejtjes për grupe të caktuara, ku përfshihen edhe persona që i përkasin pakicës rome dhe pakicës egjiptiane.

107. Avokati i Popullit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë angazhimit institucional për luftën

kundër gjuhës së urrejtjes dhe masave që shteti dhe gjithë shoqëria shqiptare duhet të ndërmarrë ndaj këtij fenomeni. Aleanca kundër Gjuhës së Urrejtjes u krijua më 20 dhjetor 2019, në Tiranë, si një nismë e Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Këshillit Shqiptar të Medias për të luftuar fenomenin e “gjuhës së urrejtjes” në të gjitha dimensionet që ai shfaqet në shoqërinë shqiptare. Krijimi i “Aleancës kundër Gjuhës së Urrejtjes”, është një shembull i mirë që nuk duhet të jetë i vetëm dhe i mjaftueshëm në këtë përpjekje që kërkon angazhim gjithëpërfshirës.

Neni 7 – Liria e grumbullimeve paqësore, liria e organizimit, liria e shprehjes dhe liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar

Neni 8 – E drejta për të manifestuar fenë ose besimin, si dhe për të krijuar institucione fetare

108. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare” në nenin 10 “Liria e ndërgjegjes dhe e fesë” parashikon: 1. Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u garantohet e drejta e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë dhe kanë të drejtën të shfaqin, individualisht ose në komunitet me të tjerët, fenë ose besimin e tyre. 2. Personat, që i përkasin një pakice kombëtare, kanë të drejtë të krijojnë organizatat dhe shoqatat e tyre fetare, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

109. Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare” – neni 9 “Liria e organizimit dhe e drejta e përfaqësimit”, parashikohet se: personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u garantohen dhe gëzojnë këto të drejta:

a) të drejtën e lirisë së grumbullimeve paqësore dhe lirisë së organizimit;

b) të drejtën të krijojnë dhe të marrin pjesë në parti politike, shoqata, si dhe organizata të tjera civile, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, me qëllim shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të tyre;

c) të drejtën të zgjidhen në organet përfaqësuese në nivel qendror dhe vendor, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 9 Aksesi në media. Rekomandimet 98–99 – Programet në gjuhët e pakicave kombëtare

110. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare në nenin 14 “Liria e shprehjes, e mendimit, dhe e



drejta e informimit” parashikon: 1) Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u garantohet dhe gëzojnë të drejtën të shprehin mendime dhe opinione, si dhe të marrin e të shpërndajnë informacione në gjuhën e pakicave, pa diskriminim dhe pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. 2) Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të kenë median e tyre të shkruar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për median e shkruar dhe elektronike. 3) Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të përdorin shërbimet e mediave audio dhe audiovizive, pa diskriminim, në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Licencimi i shërbimeve të radiopërhapjes dhe televizionit bëhet pa diskriminim dhe në përputhje me kriteret e legjislacionit për mediat audiovizive. 4) Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë të drejtën e informimit në gjuhën e tyre amtare.

111. Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH), si i vetmi transmetues publik në Shqipëri, e ka zgjeruar gamën e programeve në gjuhën e pakicave kombëtare nga viti 2016. RTSH-ja ofron shumëllojshmëri programesh në gjuhën e pakicave kombëtare, si nëpërmjet kanalit të RTSH 2 ashtu dhe nëpërmjet Radio Tirana. RTSH-ja, me shërbimet e saj audio dhe audiovizive i ka mundësuar dhe do të vazhdojë të mundësojë për komunitetet e pakicave kombëtare, ofrimin e programeve të ndryshme në gjuhën e pakicave kombëtare.

112. Prej dhjetorit 2016, RTSH-ja ka filluar transmetimin për publikun nëpërmjet një kanali të dedikuar për pakicat në strukturën programore të RTSH-së²². Kanali RTSH 2 është i vetmi kanal që transmeton larmishmëri programesh informative dhe kulturore në gjuhën e pakicave kombëtare, lajme, aktivitete të ndryshme kulturore, si këngë e valle në gjuhën e pakicave kombëtare.

113. Prej vitit 2017, Autoriteti i Mediave Audio-Vizuale (AMA) realizon çdo 6 muaj monitorimin dhe vlerësimin e ndërtimit të paketës programore të transmetuesit publik, RTSH. Në njërin prej

kanaleve, konkretisht të RTSH 2, që është kanal me format të përgjithshëm, transmetohen edhe programe të përditshme informative dhe argëtuese për pakicat kombëtare (në gjuhën bullgare, greke, arumune, rome, maqedonase, serbe dhe malazeze). Bazuar në ligjin 97/2013, “Për mediat audiovizive në RSH, përmbajtja e programeve është konform kontratës së shërbimit të RTSH-së, konceptuar dhe hartuar prej saj dhe miratuar në fillim të vitit 2017 nga AMA.

114. Kanali televiziv RTSH 2 transmeton çdo ditë lajme në gjuhën e pakicave kombëtare në orën 18:30. Transmetohen rubrika të ndryshme në lidhje me problematikat, apo edhe shembuj pozitiv, për pakicat kombëtare. Në emisionin “NE” trajtohen tema të ndryshme në lidhje me pakicat kombëtar, ftohen në studio persona dhe personalitete që u përkasin pakicave kombëtare, ku ndajnë shqetësimet e tyre dhe diskutojnë për projekte dhe aktivitete të ndryshme. Ky emision transmetohet dy herë në javë. Gjithashtu, në kanalin RTSH 2 trajtohen data të caktuara historike, festa të ndryshme që janë pjesë e kulturës së pakicave kombëtare. Emisioni i mëngjesit, “Ora 7” trajton tematika të ndryshme në lidhje me pakicat kombëtare. Çdo javë korrespondentët, të cilat janë pranë zonave ku banojnë kryesisht pakicat kombëtare, trajtojnë tematika të ndryshme nëpërmjet kronikave që realizojnë në terren. RTSH 2 transmeton serialë në gjuhën e pakicave kombëtare. Gjithashtu, bëhet i mundur regjistrimi i aktiviteteve të pakicave kombëtare, si aktivitete kulturore, që transmetohen në RTSH 2.

115. Lidhur me transmetimet radiofonike për pakicat kombëtare, “Radio Tirana” ka realizuar gjatë periudhës 2016–2020, një cikël të përjavshëm me titull “Si gjithë të tjerët”, “Larg përbuzjes, diskriminimit, harresës”, “Nevojat dhe ëndrrat”, “Së bashku do të mundemi, të ndihemi si gjithë të tjerët”. Synimi i tij është të ofrojë informacion mbi mënyrën e jetesës, punësimin, integrimin dhe shembuj për t’u ndjekur. Objektivi i ciklit ishte ofrimi i informacioni në gjuhën e pakicave kombëtare, ku personat e pakicave kombëtare dhe të rinjtë u angazhuan si bashkëpunëtorë të programit. Realizimi i një cikli të tillë, si dhe angazhimi i të rinjve, u konsiderua i rëndësishëm. Duke qenë i transmetuar në orarin pik të dëgjueshmërisë dhe duke pasur një shtrirje në të gjithë territorin synohet ndjekja maksimale.

²² Informacion mbi programet e transmetuara mbi pakicat kombëtare për periudhën 2017–2020 jepet në vijim në anekset, pjesë përbërëse e Raportit.



116. Përfituesit kryesor të drejtpërdrejtë të projektit janë të rinjtë të grup-moshës 15+. Përfitues të drejtpërdrejtë janë shoqëria shqiptare në tërësi, prindërit, mësuesit, specialistët e fushës, gazetarët. Në koherencë me zhvillimet e sotme, gazetarët, në specifikën e emisioneve përkatëse në RTSH, kanë prekur dhe trajtuar në disa fasha orare tematika, apo kanë transmetuar biseda, intervista apo profil, të përfaqësuesve të pakicave kombëtare. Mënyra e përzgjedhur në realizimin e tyre është mbi bazën e interesave të pakicave kombëtare, duke synuar shërbimin ndaj tyre. Mbetet prioritet misioni në shërbim të publikut, përfshirë pakicat kombëtare dhe prodhimi i emisioneve në gjuhën e tyre, duke trajtuar çështje dhe problematika specifike.

117. Sipas informacionit të paraqitur nga AMA deri tani shërbimet audio të komunitetit (ose radiot e komunitetit) janë vetëm nga bashkësitë fetare, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 97/2013. Pranë AMA-s nuk ka pasur asnjë kërkesë, asnjë interesim deri më tani për aplikim të licencës për radio komuniteti nga ana e pakicave kombëtare.

Neni 10 i Konventës Kuadër – përdorimi i gjuhëve të pakicave në marrëdhëniet me autoritetet administrative

Rekomandimi 105, 106

118. Ligji nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare” në nenin 15 “Përdorimi i gjuhës” pika 2, parashikohet se: në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat, që u përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht ose përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj njësie, bazuar në kërkesën e tyre, organet e vetëqeverisjes vendore krijojnë kushtet, për aq sa është e mundur, për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave dhe këtyre organeve.

119. Ligji nr. 96/2017 qartëson termin numër thelbësor, nisur nga fakti se edhe vetë Konventa Kuadër parashikon këtë term, por nuk përcakton shprehimisht se çfarë nënkupton. Pragu prej 20% i popullsisë së pakicës kombëtare i parashikuar nga ligji nr. 96/2017, lidhet me garantimin të së drejtës për përdorimin e gjuhës së pakicës, në marrëdhënie me autoritetet administrative vendore, si dhe vendosjen e toponimeve. Ky prag është një standard i pranuar në përgjithësi bazuar në përvojat relevante evropiane, por i rekomanduar edhe nga ekspertiza e Këshillit të Evropës.

120. Në pikën 5, të nenit 15 parashikohet se: çdo person, që i përket një pakice kombëtare, ka të drejtë të informohet menjëherë në gjuhën që ai/ajo kupton për arsyet e arrestimit të tij/të saj dhe për natyrën e shkakun e çdo akuze kundër tij/saj dhe për të mbrojtur veten e tij/e saj në këtë gjuhë, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

121. Aktet nënligjore në zbatim të këtij neni (neni 15, pika 6) do të synojnë rregullimin ligjor mbi mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare. Sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mënyra e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare parashikohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrive përgjegjëse për punët e brendshme dhe çështjet vendore.

122. Në zbatim të nenit 15, pika 6 të ligjit nr. 96/2017, projektvendimi, “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”, i cili në bazë të ligjit do të propozohet nga Ministria e Brendshme do të synojë rregullimin ligjor mbi krijimin dhe sigurimin e mundësive për përdorimin e gjuhës amtare të personave, që u përkasin pakicave kombëtare. Ky projektvendim ka si qëllim garantimin e së drejtës së tyre ligjore për të përdorur gjuhën e pakicës që i përkasin dhe krijimin e mundësive për ruajtjen e gjuhës, duke marrë parasysh situatën vendore. Ky projektvendim do të bëjë të mundur zbatimin e së drejtës së pakicave kombëtare, që të përdorin zyrtarisht gjuhën e tyre në aspekte të ndryshme në ato njësi të vetëqeverisjes vendore, në të cilat personat që i përkasin një pakice kombëtare banojnë tradicionalisht ose përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së tyre, në bazë të një kërkesë dhe kur ajo i përgjigjet një nevojë reale dhe objektive. Njësitë e qeverisjes vendore do të krijojnë kushtet për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet tyre.

123. Ky projektvendim i cili është proces të hartimit dhe konsultimit do të parashikojë:

- kriteret për paraqitjen e kërkesës për përdorimin e gjuhës së pakicës nga grupi i shtetasve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë njësite të vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës banojnë këta persona;



- marrjen e masave për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, për shqyrtimin e kësaj kërkesë zhvillimin e seancave dëgjimore, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore;

- marrjen e vendimit të Këshillit Bashkiak, pasi i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë nga ana e prefektit të qarkut;

- të drejtën e ankimit të kërkuarve pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, në rast të të refuzimit të kërkesës.

124. Projektvendimi do të parashikojë konkretisht mënyrën sesi do të realizohet përdorimi i gjuhës së pakicës kombëtare (komunikimi në gjuhën e pakicave kombëtare), konkretisht:

- gjatë procesit të informimit mbi të drejtat e tyre, duke hartuar për këtë qëllim rregullore apo nëpërmjet fletëve informuese, të cilat mund të publikohen/afishohen në ambiente të dukshme të organeve të vetëqeverisjes vendore;

- nëpërmjet aksesit në programin e transparencës;

- gjatë seancave të këshillimeve me bashkësinë përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, sipas parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), përfaqësuesit e pakicave kombëtare apo me shoqatat që i përfaqësojnë këto pakica;

- nismave/iniciativave qytetare nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, drejtuar Këshillit Bashkiak për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas parashikimeve të përcaktuara në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak;

- për të siguruar përdorimin në gjuhën e pakicës kombëtare, në rastet e specifikuara të parashikuara në të, organet përgjegjëse të njësisë të vetëqeverisjes vendore, parashikojnë në buxhetin vjetor të tyre, për aq sa është e mundur, zë të veçantë për punësimin e personave që njohin gjuhën e pakicës kombëtare, sipas parashikimeve të ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe ligjit për financat vendore;

- institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij do të jenë: ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe për çështjet vendore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

125. Hartimi i projektvendimit, “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në

marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”, (i cili do të hartohet dhe propozohet nga Ministria e Brendshme do të qartësojë zbatimin e dispozitës ligjore (neni 15), duke siguruar në praktikë përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare të njohura formalisht me ligjin nr. 96/2017, në marrëdhëniet midis personave që i përkasin pakicës kombëtare dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, krahas përdorimit të gjuhës shqipe.

Neni 11 i Konventës Kuadër – Mbiemrat, emrat (patronimet) shenjat dhe treguesit topografike në gjuhët e pakicave kombëtare

Rekomandimet 109, 114, 115

126. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare në nenin 15 “Përdorimi i gjuhës”, në pikën 1, parashikohet se: personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të përdorin, krahas gjuhës shqipe, në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin: a) emrin dhe mbiemrin e tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës; b) shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale, të dukshme për publikun, në çdo aktivitet të jetës së tyre sociale, ekonomike dhe kulturore.

127. Në pikën 3 të nenit 15 parashikohet se: Me vendim të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore, ku mbi 20% e banorëve u përkasin pakicave kombëtare, kur ka një kërkesë të mjaftueshme prej tyre, emërtimet e njësisë administrative përkatëse, të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe, shfaqen dhe në gjuhën e pakicës kombëtare përkatëse, sipas parashikimeve ligjore për vetëqeverisjen vendore.

128. Në zbatim të nenit 15/6, të ligjit nr. 96/2017, projektvendimi, “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”, gjithashtu ka si qëllim garantimin e së drejtës për vendosjen e emërtimeve të njësisë administrative, të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografikë në gjuhën e pakicës së njohur, krahas emërtimeve të tyre në gjuhën shqipe.

129. Ky projektvendim, i cili është në proces hartimi dhe konsultimi do të parashikojë, gjithashtu:



- kriteret për paraqitjen e kërkesës nga grupi i shtetasve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës banojnë këta persona dhe shqyrtimin e saj nga organet e njësive të qeverisjes vendore;

- mënyrën e marrjes së vendimit për emërtimin në gjuhën e një pakice kombëtare nga Këshilli Bashkiak dhe pas verifikimit të ligjshmërisë nga institucioni i Prefektit të Qarkut përkatës;

- efektet financiare të tabelave për emërtimin e njësive administrative, rrugëve shesheve, territoreve, në gjuhën e pakicës kombëtare, brenda territorit administrativ të njësive të qeverisjes vendore, do të përballohen nga buxheti i njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e adresave.

130. Ministria e Brendshme ka hartuar projektvendimin, “Për përcaktimin e specifikimeve teknike të tabelave të emërtimeve të bulevardeve, të rrugëve, rrugicave, shesheve e parqeve dhe të numërimit të ndërtesave”, i cili ka si qëllim të përditësuar dhe përmirësuar standardet e specifikimeve teknike të tabelave, ndërkohë që emërtimi i bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve e parqeve është në kompetencën e Këshillit Bashkiak. Pra, do të jetë në kompetencë të secilës bashki, që në varësi të parashikimeve të buxhetit vjetor dhe numrit të tabelave të bëjnë zëvendësimin e tabelave të emërtimeve me specifikimet e reja.

131. Në këtë projektvendim parashikohet detyrimi i njësive të vetëqeverisjes vendore, ku banojnë pakica kombëtare dhe kur ka kërkesë, që tabelat të shkruhen në dy gjuhë, në përputhje me parashikimet e nenit 15, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, duke iu përmbajtur specifikimeve teknike të tabelave, si dhe duke ruajtur të njëjtën madhësi shkronje për të dyja gjuhët.

Neni 12 Arsimiti i pakicave kombëtare

Rekomandimet 121, 124

132. Në ligjin nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare, (neni 13, pika 4), lidhur me të drejtën e drejta e arsimit në gjuhën e pakicës parashikohet se “ masat e përshtatshme në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, me qëllim nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare dhe të shumicës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit, miratohen me vendim të Këshillit të

Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

133. Në pikën 5 të këtij neni parashikohet se “masat e përshtatshme për krijimin e mundësive dhe kushteve për pajisjen me tekste shkollore, formimin fillestar, trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit”.

134. VKM nr. 1155, datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, të numrit thelbësor dhe të kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”, është nxjerrë në mbështetje të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Brendshëm. Ky vendim parashikon ndër të tjera (në pikën 2) se në institucionet arsimore ekzistuese, ku gjuha e arsimit është gjuha shqipe, nxënësit e një pakice kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, sipas kurrikulave e programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

135. Vendimi nr. 227, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare” dhe udhëzimi i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 1.7.2020, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”, përcaktojnë që nxënësve të arsimit bazë të pakicave kombëtare, u sigurohen tekste shkollore në gjuhën amtare falas.

136. VKM nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar” dhe VKM nr. 682, datë 29.7.2015, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë



dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar, parashikojnë masa konkrete për garantimin e së drejtës për arsimimin e pakicave kombëtare.

137. Në zbatim të VKM-së nr. 486, datë 17.6.2020, duke filluar nga viti shkollor (2020–2021), nxënësit në arsimin bazë që i përkasin kategorisë së pakicave kombëtare, si dhe nxënësit, si dhe nxënësit në arsimin parauniversitar që i përkasin pakicës rome dhe pakicës egjiptiane përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve shkollore.

138. Në zbatim të VKM-së nr. 486, datë 17.6.2020, të sipërcituar është miratuar edhe Udhëzimi i përbashkët nr. 18, datë 1.7.2020, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”. Konkretisht në pikën 3, të kreut II, të këtij udhëzimi, parashikohet se: “3. Çdo drejtor i shkollave ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, me anë të një kërkesë, bën porosinë për tekste shkollore për këtë kategori nxënësish në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) përkatëse. ZVAP-ja përkatëse, brenda muajit janar të çdo viti, paraqet kërkesën në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për vitin e ardhshëm shkollor për të gjitha tekstet shkollore për pakicat kombëtare për shkollat në varësinë e saj. Në këtë kërkesë, parashikohet sasia e teksteve për çdo titull, nga titujt e përzgjedhur pjesë e katalogut zyrtar të teksteve shkollore të publikuar nga MASR-ja”.

139. Në VKM-në nr. 682, datë 29.7.2015 (i ndryshuar), parashikohet që nxënësit që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike (ku përfshihen edhe pakicat), që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht), përfitojnë transport falas. Udhëzimet e Ministrisë (MASR) për regjistrimin me përparësi në kopshte të fëmijëve romë dhe për ofrimin e arsimit bazë dhe të gjimnazit me kohë të pjesshme, janë mbështetje e ndjeshme për këta fëmijë.

140. Gjithashtu në zbatim të pikës 1/c/xi të vendimit nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një

program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët, të cilët janë pranuar në programe të studimeve profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve ose programe të integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, ndër të tjerë studentët, të cilët u përkasin shtresave sociale në nevojë, si studentët romë dhe ata egjiptianë.

141. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, parashikohet që studentët romë dhe egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve të miratuar nga institucionet publike të arsimit të lartë.

142. Janë nënshkruar marrëveshjet ndërministrare për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, si dhe për fëmijët në situatë rruge etj. Në shkollat e arsimit bazë po zbatohet nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë”. Për zhvillimin e veprimtarive të miratuara në kuadër të kësaj nisme, ora e studimit është e barasvlershme me orën mësimore. Në çdo institucion arsimor të përfshirë në këtë nismë realizohen 3 orë studimi në ditë për çdo klasë të krijuar. Mësuesit e ngarkuar kryejnë dhe rolin e mediatorit në shkollat ku ka nxënës romë dhe egjiptianë, për rritjen e nivelit të të nxënës prej tyre. Nxënësit e pakicës rome dhe nxënësit e pakicës egjiptiane janë integruar dhe në të gjitha veprimtaritë që organizojnë “Shkollat qendër komunitare”, ku ndjekim mësimet.

143. Aksesit në arsimim: pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në arsimin parauniversitar në vitin shkollor 2018–2019 është përmirësuar me 6%.

- Në vitin shkollor 2018–2019 u regjistruan 15923 nxënës romë dhe egjiptianë, 915 më shumë, në krahasim me 15008 që u regjistruan në vitin shkollor 2017–2018.



- Në vitin shkollor 2019–2020, u shënua një rënie e ndjeshme e numrit të nxënësve romë dhe egjiptianë, ku u raportuan 14525 nxënës romë dhe egjiptianë (rreth 1500 më pak se një vit më parë).

- Kjo ndoshta edhe për shkak të riorganizimit të ish-drejtorive arsimore rajonale/ zyra arsimore në zyrat vendore arsimore (ZVA) dhe raportimit të ndryshëm të të dhënave statistikore prej tyre.

- Të dhënat për vitin shkollor 2020–2021 janë ende duke u raportuar nga zyrat vendore arsimore.

144. Mësuesit e pakicave kombëtare janë trajnuar çdo vit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për mësimdhënien e kurrikulës me kompetenca. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me mbështetjen e Qendrës Evropiane të Gjuhëve Moderne të Këshillit të Evropës (ECML) organizoi, në vitin 2018, trajnimin “Mbështetja e mësuesve për zhvillimin e gjuhës në kurrikul” vetëm për mësuesit e pakicave kombëtare. Ky trajnim kishte si qëllim zhvillimin profesional të mësuesve të pakicave kombëtare greke/maqedonase mbi rëndësinë e të kuptuarit të shumëgjuhësisë, ndërjegjësimin e mësuesve për kompetencën e të komunikuarit që kërkohet në gjuhët e shkollimit, si dhe roli i tyre si ndërmjetës kulturor në klasë dhe përtej saj. Trajnimi u zhvillua nga ekspertë të Qendrës Evropiane të Gjuhëve Moderne, Graz, Austri.

145. Çdo mësues i pakicave kombëtare trajnohet të paktën 3 ditë në vit, me programe trajnimi të akredituara sipas fushës ku ata shprehin interesat dhe nevojat e tyre. Në kuadër të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë janë ngritur rrjetet profesionale për çdo lëndë për arsimin parauniversitar. Disa nga këto rrjete lëndore drejtohen nga mësuesit e pakicave kombëtare.

146. Kultura, historia dhe traditat e pakicave kombëtare janë përfshirë në kurrikulat shkollore. Në vijim parashikohet hartimi i materialeve ndihmëse (udhëzues, programe trajnimi, module mësimore) për mësuesit në mënyrë që të trajtojnë në mënyrë më efektive, kulturën, traditat dhe historinë e pakicave në praktikën e tyre në klasë/shkollë.

Neni 13 Hapja e institucioneve private

147. Në ligjin nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare, (neni 13, pika 6) lidhur me të drejtën e arsimit, parashikohet se “Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të

hapin dhe të drejtojnë institucione private të sistemit arsimor dhe institucione të arsimit profesional, kur plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi në fushën e arsimit”.

148. Vendimin nr. 466, datë 10.6.2020, të Këshillit të Ministrave, parashikon “përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj”.

Neni 14 E drejta për të mësuar dhe t'u mësuar në gjuhën amtare

Rekomandimet 134–137

149. Në ligjin nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare (neni 13 “E drejta e arsimit në gjuhën e pakicës kombëtare”), konkretisht në pikat 1, 2 dhe 3, parashikohet se: 1) Personat, që i përkasin një pakice kombëtare, gëzojnë të drejtën të mësojnë gjuhën e pakicës. 2) Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato banojnë tradicionalisht ose në numër thelbësor, nëse ka kërkesë të mjaftueshme, u sigurohen mundësi për të mësuar ose për të marrë mësim në gjuhën e pakicës kombëtare, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit. 3) Kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për arsimin dhe çështjet vendore.

150. Në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar që personave, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore.

151. Bazuar në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë dhe të kulturës shqiptare, për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë dhe ata vlerësohen në provimet kombëtare të arsimit bazë në lëndët gjuhë



amtare, gjuhë shqipe dhe, sipas dëshirës, edhe në një gjuhë të huaj.

152. VKM nr. 1155, datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të numrit thelbësor dhe të kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”, parashikon se: personat që i përkasin një pakice kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare në institucione arsimore të caktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

153. Në pikën 3, të VKM-së nr. 1155, datë 24.12.2020, parashikohet se: njësitë e vetëqeverisjes vendore, numri thelbësor dhe kërkesa me qëllim sigurimin e së drejtës për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare përcaktohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

a) numri i personave që i përkasin pakicës kombëtare, i cili duhet të jetë jo më pak se 20% e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative, si nënndarje e bashkisë;

b) periudha e regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas periudhave të regjistrimit të popullsisë, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga regjistrat themeltarë të gjendjes civile dhe/ose Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010;

c) kërkesa shkresore, paraqitur nga prindër apo kujdestarë të fëmijëve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë bashkisë/njësisë administrative, ku shprehet vullneti në mënyrë shkresore dhe bazuar në të drejtën e vetidentifikimit për formimin e klasës.

154. Në pikën 4 të VKM-së nr. 1155, datë 24.12.2020, parashikohet se: numri i nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare, që kanë të drejtën të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare së cilës i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, duhet të jetë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë, në bazë të kërkesës shkresore nga prindërit apo kujdestarët, sipas përcaktimit në shkronjën “c”, të pikës 3, të këtij vendimi.

155. Në pikën 5 të VKM-së nr. 1155, datë 24.12.2020 parashikohet se: administrimi i informacionit për verifikimin e plotësimit të kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, bëhet nga Prefekti i Qarkut. Pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve, Prefekti përcakton njësitë

e vetëqeverisjes vendore, në të cilat personave që i përkasin një pakice kombëtare do t’u sigurohet e drejta të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare. Në pikën 6 të këtij vendimi parashikohet se: njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përcaktuar sipas pikës 5, të këtij vendimi, kanë të drejtën e nismës për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, në përputhje me parashikimet ligjore për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, janë: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme, Prefekti i Qarkut dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

156. Në mbështetje të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, janë miratuar dy vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), me propozim të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), të cilat janë:

- VKM nr. 561, datë 29.9.2018, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”;

- VKM nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”.

157. Bazuar në VKM-në nr. 561, datë 29.9.2018, nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, njësia arsimore vendore përkatëse dhe komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare. Bazuar në këtë vendim, klasat në gjuhën e pakicave kombëtare hapen kur numri i nxënësve të pakicave është jo më i vogël se 15 nxënës për klasë, ndërsa në raste të veçanta kur numri i nxënësve të pakicave është më i vogël se 15 nxënës për klasë, funksionimi i klasave me nxënës të pakicave kombëtare bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

158. Në zbatim të ligjit nr. 96/2017, “Për pakicat kombëtare”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpropozim me Ministrinë e Kulturës kanë propozuar VKM nr. 463, datë 3.7.2019, “Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme



për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur e zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre”. Për këtë qëllim, në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare ka plane të veçanta për promovimin e kulturës, gjuhës dhe identitetit të pakicave kombëtare.

159. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) ka hartuar planin mësimor për pakicat kombëtare, i cili është miratuar edhe nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në institucionet arsimore ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, si në të gjithë sistemin arsimor shqiptar zbatohet kurrikula e re, e bazuar në kompetenca. Të gjitha programet mësimore të pakicave kombëtare janë të publikuara në faqen e ASCAP-it. Programet mësimore janë njësoj si në shkollat e tjera të sistemit arsimor parauniversitar. Programet mësimore për pakicat kombëtare janë hartuar nga ASCAP-ja konkretisht, 45 programe mësimore lëndore, ku përfshihen edhe programet specifike:

- Gjuha amtare greke;
- Gjuha amtare maqedonase;
- Historia e Greqisë;
- Gjeografia e Greqisë;
- Historia e Maqedonisë së Veriut;
- Gjeografia e Maqedonisë së Veriut.

160. Agjencia ASCAP, për zbatimin e kurrikulës së re ka trajnuar mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar, përfshirë edhe mësuesit e pakicave kombëtare për çështjet e mëposhtme:

- kurrikula e bazuar në kompetenca;
- planifikimi i kurrikulës;
- metodologjia e mësimdhënies së kurrikulës së bazuar në kompetenca;
- vlerësimi i nxënësit me kurrikulën e re.

161. Në kuadër të riorganizimit të njërive arsimore vendore, që u bë në vitin 2019, iu kushtua rëndësi që institucionet arsimore ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, të mbulohen nga zyra vendore arsimore (ZVA) të veçanta, me qëllim që t’u sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë shërbim arsimor cilësor. Prej vitit 2019 është krijuar Zyra Vendore Arsimore Finiq-Dropull, për Bashkinë e Dropullit dhe Bashkinë e Finiqit”, miratuar me urdhrin nr. 234, datë 19.4.2019 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për

miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar” (i ndryshuar).

162. Bazuar në VKM-në nr. 227, datë 17.4.2019, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve publike parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”, çdo vit shkollor përgatiten, shtypen, botohen dhe shpërndahen falas nga buxheti i shtetit tekstet shkollore në gjuhën amtare të pakicave për nxënësit e pakicave.

163. Urdhri nr. 186, datë 15.5.2015, “Për përcaktimin e planit mësimor për pakicat kombëtare” i MASR-së, ka miratuar planin mësimor për arsimin bazë për pakicat kombëtare, bazuar në kurrikulën e re me kompetenca. Gjuha shqipe dhe gjuha amtare zhvillohen në të gjitha klasat e arsimit bazë për pakicat kombëtare. Gjithashtu, që nga klasat III–IX nxënësit e pakicave kombëtare mësojnë edhe një gjuhë të huaj.

164. Në zbatim të kurrikulës me kompetenca për të gjithë arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë u hartuan programe të reja lëndore sipas kësaj kurrikule. Nxënësit pakicave kombëtare në arsimin bazë zhvillojnë në gjuhën e tyre amtare lëndë, si: Gjuhë amtare, Histori amtare, Gjeografi amtare, Dituri natyre, Matematikë 1–5, Biologji, Art pamor, Muzikë, Qytetari etj. Tekstet në gjuhën greke dhe maqedonase janë përkthime të teksteve fituese të katalogut të MASR-së. Tekstet shkencore përkthehen në gjuhën greke dhe maqedonase të teksteve fituese të Oxford, Cambridge dhe Pearson. Ndërsa tekstet: Gjuhë amtare greke, Histori amtare greke dhe Gjeografi amtare greke janë tekste të hartuara nga pedagogë të Departamentit të Gjuhës Greke dhe Qytetërimit Grek në Gjirokastër, si dhe nga pedagogë të Departamentit të Gjuhëve Sllavo-Ballkanike në Tiranë.

165. Përveç programeve të përbashkëta, për nxënësit e pakicave kombëtare u hartuan 22 programe specifike për gjuhën, historinë dhe gjeografinë amtare greke dhe maqedonase. Këto programe u hartuan nga grupe pune me pjesëmarrjen e pedagogëve nga Departamenti i Gjuhës Greke dhe Qytetërimit Grek në Gjirokastër dhe Tiranë, si dhe nga mësues të gjuhës greke dhe gjuhës maqedonase.



166. Në sistemin arsimor parauniversitar publik funksionojnë institucione arsimore ku mësojnë fëmijët e pakicës kombëtare greke dhe ata të pakicës kombëtare maqedonase. Në kuadër të riorganizimit të njërive arsimore vendore, që u bë në vitin 2019, iu kushtua rëndësi që institucionet arsimore ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare të mbulohen nga zyra vendore arsimore (ZVA) të veçanta, me qëllim që t'u sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë shërbim arsimor cilësor. Tashmë, institucionet arsimore ku mësojnë nxënës të pakicës kombëtare greke mbështeten nga ZVA Delvinë–Finiq, ZVA Gjirokastër–Libohovë–Dropull, ZVA Sarandë–Konispol dhe institucionet arsimore ku mësojnë nxënës të pakicës kombëtare maqedonase mbështeten nga ZVA Korçë–Pustec.

167. Institucionet arsimore publike ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare janë në bashkitë Gjirokastër, Dropull, Sarandë, Delvinë, Finiq, Pustec²³. Numri i nxënësve të pakicave kombëtare greke dhe maqedonase që kanë ndjekur shkollën, sipas viteve shkollore përkatëse në arsimin publik, janë:

- viti shkollor 2016–2017 – gjithsej 763 nxënës dhe 101 mësues;
- viti shkollor 2017–2018 – gjithsej 685 nxënës dhe 94 mësues;
- viti shkollor 2018–2019 – gjithsej 611 nxënës dhe 96 mësues;
- viti shkollor 2019–2020 – gjithsej 565 nxënës dhe 87 mësues.

168. Në vitin 2018 u miratuar urdhri nr. 754, datë 9.11.2018, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e programit të gjuhës rome, shkalla III–IV, klasat VI–IX”. Ky program vlen për zhvillimin e mësimin të gjuhës rome në arsimin e mesëm të ulët si lëndë me zgjedhje. Programi i gjuhës rome, shkalla III–IV, klasat VI–IX, u hartua dhe u miratua në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020. Mësimi i gjuhës rome dhe zhvillimi i mësimin në gjuhën rome do të bëhen në përputhje me aktet nënligjore për mësimin në gjuhën e pakicave në Republikën e Shqipërisë. Prej disa vitesh, gjuha rome mësohet në shkollën 9-vjeçare “Hamit Mullisi” Elbasan, në kuadrin e

shkollës qendër komunitare. Atë e ndjekin jo më pak se 30 nxënës çdo vit. Aktualisht mungojnë mësues të diplomuar për gjuhën rome.

169. Gjatë periudhës 2016–2020 nuk ka pasur kërkesa të tjera për hapje klasash të reja për pakicat kombëtare.

Neni 15 Pjesëmarrja e personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike

Organet qeveritare përgjegjëse për pakicat dhe dialogun me pakicat. Rekomandimet 142,143

Komiteti për Pakicat Kombëtare

170. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare, në kreun III (nenet 18-22) përmban disa dispozita mbi krijimin e Komitetit për Pakicat Kombëtare, i cili krijohet, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, krijohet Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit. Në këtë nen parashikohet: Organizimi, funksionimi dhe niveli i pagave i anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare dhe personelit administrative. Struktura e Komitetit për Pakicat Kombëtare që miratohet me urdhër të Kryeministrit.

171. Në nenin 19 të këtij ligji parashikohen kompetencat e Komitetit për Pakicat Kombëtare Komiteti për Pakicat Kombëtare ka këto kompetenca:

a) rekomandon dhe jep opinionin e tij në lidhje me hartimin e legjislacionit, politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave kombëtare;

b) propozon rekomandime për Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe organet e pushtetit vendor për trajtimin e çështjeve që lidhen me pakicat kombëtare;

c) përgatit dhe dorëzon raporte periodike për Kuvendin për gjendjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë;

ç) bashkëpunon dhe koordinon me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor raportimin dhe monitorimin për zbatimin e kuadrit ligjor dhe politikave shtetërore në lidhje me pakicat kombëtare;

d) organizon aktivitete, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin për mbrojtjen e promovimin e të

²³ Informacion i detajuar mbi arsimimin e nxënësve të pakicave kombëtare në disa Bashki të vendit jepet në pjesën e katërt të këtij Raporti.



drejtave të pakicave kombëtare dhe forcimin e dialogut me shoqatat e pakicave kombëtare;

e) kontribuon në përgatitjen e raportit kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

f) ndërmerr aktivitete, të cilat kanë si synim përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare;

g) jep opinione në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare;

h) jep opinion, lidhur me kërkesat për njohjen e pakicave;

i) financon, nëpërmjet fondit për pakicat kombëtare, nismat dhe projektet që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe ruajtjen e promovimin e identitetit kombëtar, gjuhësor e kulturor të pakicave kombëtare.

172. Në nenin 20 të këtij ligji parashikohet se Komiteti për Pakicat Kombëtare përbëhet nga përfaqësuesit e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij ligji, pra përfaqësues të 9 pakicave kombëtare të njohura me ligjin nr. 96/2017²⁴. 2. Secila prej pakicave kombëtare, ka të drejtë të ketë nga një përfaqësues në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare. Anëtarët e Komitetit për Pakicat Kombëtare emërohen me urdhër të Kryeministrit, mbështetur në kandidaturat e paraqitura nga shoqatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Mandati i anëtarit të komitetit është katërvjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje. 3. Kryetari i Komitetit për Pakicat Kombëtare dhe nënkryetari emërohen me urdhër të Kryeministrit, çdo katër vjet. 4. Përzgjedhja e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare bëhet nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent dhe gjithëpërfshirës. Procedurat dhe rregullat për zhvillimin e këtij procesi rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga Kryeministri.

173. Në nenin 21 të këtij ligji parashikohet krijimi i Fondit për Pakicat Kombëtare me qëllim mbështetjen e nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të

dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar të pakicave kombëtare. 2. Fondi financohet nga Buxheti i Shtetit dhe administrohet nga Komiteti për Pakicat Kombëtare. 3. Kriteret për mbështetjen e nismave dhe projekteve, kriteret e përzgjedhjes për financimin e tyre dhe administrimi i fondit për pakicat kombëtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

174. Në zbatim të këtyre dispozitave janë miratuar dy akte nënligjore:

- VKM nr. 726, datë 12.12.2018 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare”;

- VKM nr. 286, datë 10.5.2019, “Për miratimin e procedurave të zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare”.

175. VKM nr. 726, datë 12.12.2018 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare” është nxjerrë në zbatim të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

176. Ky vendim parashikon, ndër të tjera se:

- Komiteti për Pakicat Kombëtare është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë;

- Komiteti për Pakicat Kombëtare ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe legjislacionit përkatës në fuqi;

- Komiteti për Pakicat Kombëtare e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Komiteti për Pakicat Kombëtare organizohet në nivel qendror.

177. Komiteti për Pakicat Kombëtare drejtohet nga kryetari, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e këtij institucioni, raporton dhe përgjigjet përpara Kryeministrit.

- Komiteti për Pakicat Kombëtare ushtron kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH”.

- Organizimi i brendshëm, struktura dhe organika e Komitetit për Pakicat Kombëtare miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për

²⁴ Pakicat kombëtare të parashikuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij ligji janë: greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.



organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

- Komiteti për Pakicat Kombëtare financohet nga buxheti i shtetit. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Komitetit për Pakicat Kombëtare miratohet nga Kryeministri, pas propozimit të kryetarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare.

178. VKM nr. 286, datë 10.5.2019, “Për miratimin e procedurave të zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare”, parashikon:

- miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare (në vijim “KPK”), nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent e gjithëpërfshirës;

- përzgjedhja e kandidaturave për kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e KPK-së kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura e publike të konkurrimit, nga Kryeministria, bazuar në pikën 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

179. Kandidatët për kryetar dhe nënkryetar të KPK-së duhet të plotësojnë këto kritere:

a) të jenë persona që u përkasin pakicave kombëtare, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”;

b) të jenë personalitete të shquara, me kontribute të spikatura në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare;

c) të kenë eksperiencë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare;

d) ky vendim parashikon ngritjen e Komisionin *ad-hoc* nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes për kryetarin/nënkryetarin, si dhe shpalljen e vendit të lirë për pozicionin kryetar dhe nënkryetar të KPK-së dhe njoftimin, i cili përmban kriteret i, dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit;

e) të drejtën e propozimit të një kandidati për pozicionin e anëtarit të KPK-së e gëzon çdo shoqatë e regjistruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë mbrojtjen

dhe promovimin e të drejtave të pakicës kombëtare përkatëse²⁵;

f) personat që u përkasin pakicave kombëtare (9 pakicat kombëtare sipas ligjit nr. 96/2017), mund të aplikojnë si kandidatë, individualisht dhe që mbështeten, me rekomandim, nga të paktën pesë individë, që janë personalitete me kontribute të pakicës kombëtare përkatëse.

180. Në zbatim të këtij vendimi, gjatë periudhës janar–shkurt 2021 janë shpallur procedurat e aplikimit për pozicionin e kryetarit dhe nënkryetarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare. Procedurat e hapura publike të konkurrimit ndiqen nga Kryeministria, bazuar në pikën 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Këto procedura përfshijnë edhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët. Në datën 28 shkurt 2021, ka përfunduar afati i aplikimit dhe aktualisht po ndiqen procedurat përkatëse në bazë të ligjit nr. 96/2017 dhe të VKM-së nr. 286, datë 10.5.2019. Ky njoftim është shpallur dhe publikuar në faqen zyrtare të Kryeministrit²⁶.

181. Lidhur me funksionimin e buxhetit të Komitetit të Pakicave për vitin 2021, është financuar numri i punonjësve të shtuar në përputhje me strukturën e tyre të miratuar.

182. Projektvendimi, “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e “Fondit për Pakicat Kombëtare”, do të nxirret në zbatim të nenit 21, pika 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit (duke qenë se Komiteti për Pakicat Kombëtare funksionon si organ i pavarur pranë Kryeministrit).

183. Projektvendimi mbi Fondin për Pakicat Kombëtare, i cili është në proces hartimi dhe konsultimi do të synojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare. Fondi do të përdoret për mbështetjen e nismave dhe të projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të

²⁵ Sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017 (9 pakicat kombëtare).

²⁶ <https://kryeministria.al/newsroom/n-j-o-f-t-i-m-p-e-r-a-p-l-i-k-i-m-8/>



pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional e fetar.

184. Projektvendimi do të përcaktojë një procedurë transparente, funksionale, efektive, të bazuar në legjislacionin në fuqi, lidhur me:

- përfituesit e mundshëm të këtij fondi; procedurën që do të ndiqet për përcaktimin e shumës vjetore të fondit;

- parimet në të cilat mbështetet administrimi dhe shpërndarja e fondit; procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesve;

- mënyrat e monitorimit të zbatimit të drejtë dhe të dobishëm të projekteve të financuara; garantimin e transparencës dhe të barazisë gjatë gjithë procesit, duke u bazuar në rregulla objektive të paracaktuara në detaje.

185. Krijimi i këtij Fondi të posaçëm për financimin ekskluzivisht të nismave dhe projekteve, që ruajnë dhe promovojnë të drejtat e pakicave dhe karakteristikat e identitetit të tyre të dallueshëm përbën një hap të mirëpritur dhe të kërkuar nga shoqatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Efektet e pritshme janë rritja e sasisë dhe cilësisë së kapaciteteve të shoqatave që përfaqësojnë pakicat kombëtare, si dhe ndjenja e vlerësimit dhe përfshirjes së tyre në politikatat favorizuese të shtetit shqiptar ndaj kulturës dhe vlerave të tyre.

186. Fondi për Pakicat Kombëtare parashikohet të financohet nga buxheti i shtetit dhe pas miratimit administrohet nga Komiteti për Pakicat Kombëtare në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin buxhetor në fuqi. Fondi parashikohet si zë me vete në buxhetin vjetor të shtetit dhe duhet të jetë i mjaftueshëm për financimin e projekteve në bazë të një relacioni të argumentuar vjetor që i paraqet Komiteti i Pakicave Kombëtare dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pas konsultimit me përfaqësuesit e pakicave kombëtare.

187. Projektvendimi mbi Fondin do të përcaktojë: përfituesit e mundshëm të financimit nëpërmjet fondit; shqyrtimin e projekteve dhe përzgjedhjen e kandidatëve përfitues; fazat e procesit dhe procedurës së përzgjedhjes, dokumentacionin e nevojshëm, afatet, kriteret e përgjithshme të pranimit të kandidatëve/aplikantëve, kushtet për përfitimin e grantit; detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve, i cili ka dhe rolin kryesor gjatë procesit të përzgjedhjes. Kriteret e përzgjedhjes do të

mundësojnë transparencën e procesit, si dhe arsyet përkatëse të argumentuara në rast të mos shpalljes si fitues. Fondi financiar (buxheti) do të jepet në bazë të një relacioni të argumentuar vjetor, që do të përgatitet nga Komiteti i Pakicave Kombëtare në konsultim me përfaqësuesit e nëntë pakicave kombëtare dhe do të paraqitet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë²⁷.

188. Projektvendimi është hartuar nga Komiteti për Pakicat Kombëtare dhe është në proces konsultimi me institucionet e linjës. Iniciativën propozuese për miratimin në Këshillin e Ministrave ushtrohet nga Kryeministri, duke qenë se Komiteti për Pakicat Kombëtare është institucion, në varësi të Kryeministrit.

- Pjesëmarrja në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike

189. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare në nenin 11 “Pjesëmarrja në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike” parashikon se “Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë për pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën publike, ekonomike, sociale e kulturore të vendit, në veçanti, në çështjet lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kulturës, traditave dhe identitetit të pakicës së cilës ata i përkasin.

190. Ky ligj në nenin 11 parashikon, gjithashtu, se: “personat, që u përkasin pakicave kombëtare dhe organizatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare gëzojnë të drejtën e aplikimit dhe mbështetjen financiare nga institucionet e kulturës, me qëllim promovimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e traditave të tyre, pa dallim identiteti kulturor, etnik, gjuhësor ose tradicional, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kulturën”. Masat dhe politikatat e nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për fushat e lartpërmendura.

²⁷ Sipas propozimeve të Komitetit për Pakicat Kombëtare synohet të paraqiten dy thirrje për aplikim për financim projektsh në vit (një thirrje çdo gjashtë muaj) dhe do të financohen tetëmbëdhjetë projekte në çdo thirrje. Vlera totale e financimit vjetor të kërkuar është me një vlerë të paktën për 2 thirrje dhe rreth 45 000 000 lekë. Minimalisht vlera e një projekti të dedikuar për çdo pakicë në çdo thirrje do të jetë 1 000 000 lekë, atëherë 9 x 1 000 000 = 9 000 000 lekë.



191. Bazuar në pikën 3, të nenit 11, të këtij ligji, është miratuar VKM-ja nr. 462, datë 3.7.2019, “Për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike e në RSH”, propozim i Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

192. Ky vendim parashikon:

- personave, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, u garantohej pjesëmarrje e barabartë në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;

- Ministria e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj, në të gjitha veprimtaritë që zhvillojnë, të trajtojnë si pasuri kombëtare pjesën e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare, duke mbrojtur e promovuar të drejtën e tyre për pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën kulturore të vendit, në drejtim të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të kulturës, traditave dhe identitetit të pakicës, së cilës ata i përkasin;

- Ministria e Kulturës harton politika të posaçme, me qëllim mbështetjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si dhe ata të konsideruar vulnerabël, në drejtim të mbrojtjes së identitetit të tyre kulturor, etnik e gjuhësor, trashëgimisë kulturore;

- Ministria e Kulturës garanton përfshirjen e personave përfaqësues të pakicave kombëtare në procesin e konsultimit e të vendimmarrjes lidhur me çështjet që prekin personat që u përkasin pakicave kombëtare, si politikat e kuadrit ligjor dhe politikat e masat për të siguruar pjesëmarrjen në jetën kulturore të vendit, në drejtim të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të kulturës, traditave dhe identitetit të pakicës kombëtare;

- Ministria e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj marrin masa për krijimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen efektive të personave, që u përkasin pakicave kombëtare, sipas specifikave të çdo institucioni, në aktivitetet që ato organizojnë.

193. Ky vendim parashikon gjithashtu se “Personat, që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë në mënyrë të barabartë me shtetasit e tjerë dhe pa diskriminim pagesat për ndihmë ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet shoqërore, sipas përcaktimeve të

legjislacionit për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

- Personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit e të trajtimit të barabartë në veprimtaritë ekonomike të vendit. Personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare në RSH, përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim nga programet aktive të tregut të punës dhe të arsimit e formimit profesional.

194. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale konsultohet me organizatat përfaqësuese të pakicave kombëtare për hartimin e kuadrit ligjor dhe të politikave, të cilat ndikojnë në situatën social-ekonomike të tyre. Ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi marrin masat e nevojshme dhe evidentojnë konkretisht krijimin e kushteve për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë, pa diskriminim, dhe pjesëmarrjen efektive në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

195. VKM nr. 463, datë 3.7.2019, “Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur e zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre” parashikon gjithashtu se “Personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe përfaqësuesit e tyre ftohen të marrin pjesë në procesin e konsultimit gjatë hartimit dhe miratimit të strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm në RSH.

196. Në udhëzimin nr. 24, datë 30.10.2017, “Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Prindërve” është përcaktuar që në përbërjen e Këshillit Rajonal të Prindërve dhe të Këshillit Kombëtar të Prindërve t’i kushtohet kujdes përfaqësimit të pakicave kombëtare. Në udhëzimin e përbashkët nr. 18, datë 20.8.2019 të MASR-së dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), “Për vitin shkollor 2019–2020 në sistemin arsimor parauniversitar” është parashikuar që institucionet arsimore për arsimin bazë ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, të planifikojnë veprimtari të veçanta, me qëllim



ruajtjen e promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave kombëtare.

- *Rekomandimet 150, 151 – Pjesëmarrja në procesin zgjedhor*

197. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare në nenin 15/4, “Përdorimi i gjuhës” parashikon ndër të tjera se: Në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat, që u përkasin pakicave kombëtare, përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj njësie, ata kanë të drejtë të marrin informacion, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën e pakicës, mbi zhvillimin e procesit zgjedhor. Dhënia e informacioneve në gjuhën e pakicave për zhvillimin e procesit zgjedhor rregullohet me akte të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

- *E drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur për personat që u përkasin pakicave*

198. Kodi Zgjedhor, në nenin e “Parime të përgjithshme”, parashikon garancitë kushtetuese për të gjithë shtetasit shqiptarë të së drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, duke përcaktuar:

- zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës;

- çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

199. Në nenin 63 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se: “Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

- Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.

- Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69, të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie apo komune ose për këshillat vendore në KZAZ.

- Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, ka të drejtë të zgjidhet si kandidat i një partie politike,

kandidat i një koalicioni partish politike, apo i mbështetur nga një grup zgjedhësish.

200. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në përmbushje të misionit të tij për edukimin zgjedhor të shtetasve, ka treguar vëmendje të veçantë për hartimin dhe realizimin e programeve edukues dhe informues për çështje zgjedhore për pakicat kombëtare, me fokus të veçantë pakicën rome dhe pakicën egjiptiane. Problemet e mprehta ekonomike dhe sociale të këtij komuniteti kushtëzojnë qasjen me procesin zgjedhor, ku më evidentet janë mungesa e informacionit dhe pjesëmarrja e ulët në procesin e votimit.

201. Në zbatim të ligjit nr. 96/2017, “Për pakicat kombëtare”, lidhur me përfaqësimin e personave që u përkasin pakicave, në strukturat e Policisë së Shtetit, janë rekrutuar:

- 11 punonjës të policisë që i përkasin pakicës kombëtare greke;

- 14 punonjës të policisë që i përkasin pakicës kombëtare maqedonase;

- 8 punonjës të policisë që i përkasin pakicës kombëtare rome.

- **Informacion mbi informimin e pakicave mbi zhvillimin e procesit zgjedhor (fushata ndërgjegjësuere, spote, fletëpalosje gjatë periudhës 2016–2020**

202. Viti 2016: KQZ-ja ka identifikuar nevojat për informacion zgjedhor të pakicave kombëtare, përmes një projekti të realizuar në bashkëpunim me OSBE-në dhe me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane. Përmes intervistave dhe pyetësorëve të zhvilluar në qarqet Tiranë, Shkodër, Fier dhe Gjirokastrë, u mblodh informacioni i nevojshëm mbi bazën e të cilit, u analizua situata për nevojat dhe mënyrat më eficiente të shpërndarjes së informacionit zgjedhor të pakicat kombëtare, me fokus hartimin e kurrikulave për edukim zgjedhor të pakicave kombëtare: romët dhe egjiptianët.

203. KQZ-ja nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), qëllimi kryesor i së cilës ishte realizimi në vijimësi i projekteve edukuese zgjedhore për komunitetet rome. Mbështetja e OSBE-së, mundësoi që sesionet e edukimit zgjedhor të zhvillohen në të gjitha vendqëndrimet e komunitetit: Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Kuçovë, Pogradec, Korçë, Gjirokastrë, Lezhë, Delvinë dhe të shtrihet në kohë duke garantuar qëndrueshmërinë e veprimtarisë. Zgjedhje për



Kuvendin e RSH-së 2017: KQZ-ja miratoi dhe realizon projekt të veçantë për informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare, pjesë e Strategjisë për Edukimin Zgjedhor të Shtetasve. Pakicat kombëtare: greke, maqedonase, rome, malazeze dhe arumune shpërndarja e informacionit zgjedhor dhe mesazheve sensibilizuese për pjesëmarrje në votim u realizua nëpërmjet posterave dhe fletpalosjeve në gjuhët respektive.

204. KQZ-ja, në bashkëpunimit të ngushtë me Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, si dhe me OJF-të përfaqësuese të pakicave kombëtare identifikoi zonat dhe numrin përkatës së popullsisë së pakicave kombëtare, realizoi përkthimin e materialeve në gjuhët respektive, u realizua prodhimi dhe shpërndarja e posterave dhe fletpalosjeve në gjuhën e pakicave (greke, maqedonase, malazeze, arumune, rome).

205. Në të gjitha zonat respektive sipas numrit përkatës së popullsisë rezidente që i përkasin pakicave kombëtare, KQZ-ja, shpërndau fletpalosje me informacion të plotë për sistemin zgjedhor, llojin e zgjedhjeve, mandatet, subjektet zgjedhore, kandidatët, oraret e votimit, procedurat e votimit, rëndësinë dhe vlerën e votës, rëndësinë e pjesëmarrjes në votime, për veprat penale në zgjedhje dhe masën e dënimit për to, numrin e telefonit pa pagesë dhe aplikacionin ku merret informacion për procesin zgjedhor dhe mund të raportohet për veprime joligjore në zgjedhje;

206. Në të gjitha qendrat e votimit ku ishin të regjistruar zgjedhës të pakicave kombëtare u afishuan postera në gjuhët respektive, me informacion për procedurat e votimit, veprimet e ndaluara në qendrën e votimit. Në zonat me pakica kombëtare u afishohen në vende publike dhe në të gjitha qendrat e votimit, postera ndërgjegjëses dhe sensibilizues në gjuhë të pakicave kombëtare që për të rinj, të moshuar, gra, votues me aftësi të kufizuar, për rëndësinë e pjesëmarrjes në votime, veprat penale në zgjedhje dhe masën e dënimit për to, numrin e telefonit pa pagesë apo adresën e aplikacionit ku çdokush mund të marrë informacion zgjedhor, apo të raportojë për veprime joligjore në zgjedhje.

207. Zgjedhje vendore 2019 – KQZ-ja nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin Shtetëror të Pakicave Kombëtare. Të gjitha materialet informuese/ edukuese/ ndërgjegjëse, që KQZ-ja prodhoi për procesin zgjedhor

të datës 30.6.2019, u prodhuan edhe në gjuhët e nëntë pakicave kombëtare. Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare realizoi përkthimin në gjuhët e pakicave kombëtare të materialeve informuese, edukuese, ndërgjegjëse për zgjedhjet e datës 30.6.2019, si dhe u angazhua për shpërndarjen e tyre në njësitë e vetëqeverisjes vendore me numrin më të madh të tyre.

208. Në bashkëpunim me Policinë e Kufirit, fletpalosje në gjuhë të pakicave kombëtare u shpërndanë në pikat e kalimit kufitar, me vendndodhje pranë territoreve të banuara nga pakicat kombëtare. Komisioneve zonale të administrimit të zgjedhjeve (KZAZ-ve) që ushtronin veprimtarinë në territore me vendbanim të pakicave kombëtare, u janë shpërndanë fletpalosje edhe në gjuhë të pakicave kombëtare përkatëse.

209. Fletpalosjet në gjuhë të pakicave kombëtare u shpërndanë në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat që u përkasin pakicave kombëtare përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, bazuar në informacionin e dërguar nga Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbushjen e Vetëqeverisjes Vendore, e cila referonte të dhëna për popullsinë banuese dhe pakicat kombëtare përkatëse në nivel bashkie, si dhe në nivel qarku. Posterat informues dhe edukues në gjuhë të pakicave kombëtare (5 lloje), u dërguan në KZAZ-të përkatëse për t'u shpërndarë dhe afishuar në qendrat e votimit me vendndodhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore me numrin më të madh të pakicave kombëtare. Informacione për zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 30.6.2019, si dhe mesazhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votime u përcollën nga Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare, në kuadër të bashkëpunimit me KQZ-në, përmes hapësirës mediatike në gjuhë të secilës pakicë kombëtare në Radio-Televizionin Shqiptar (lajmet ditore).

210. U realizua projekti i veçantë “Vota ime vlen” për pakicën kombëtare rome dhe atë egjiptiane në bashkëpunimin me IRCA (Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri), mbështetur nga Instituti Demokratike Amerikan (NDI), në 12 qarqet e vendit. Gjithashtu, KQZ-ja në bashkëpunim me prezencën e OSCE, realizoi në vendqëndrimet e komuniteteve rome dhe egjiptiane projektin informues dhe ndërgjegjëses



me fokus gratë dhe të rinjtë. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, përcakton se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka si kompetencë drejtimin e punës për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve. Aktualisht po punohet për hartimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

211. Programi i veçantë për pakicat kombëtare, parashikon mjete dhe mënyra, jo vetëm të shkruara, por edhe përmes spoteve televizive, duke synuar që zgjedhësit që u përkasin pakicave kombëtare, edhe në gjuhën e pakicave kombëtare:

- të informohen për të drejtat dhe detyrat e zgjedhësit gjatë periudhës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve;

- llojin e zgjedhjeve, orarin e votimit, kush gëzon të drejtën për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur;

- dokumentet e identifikimit të vlefshme për votim;

- kontrollin e emrit në ekstraktin e përbërësve zgjedhor dhe në listën e zgjedhësve, hapat që duhen ndërmarrë për korrigjimin e pasaktësive apo mungesës së emrit në lista;

- procedurat e votimit, ku në fokus do të jetë procedurat për identifikimin elektronik;

- veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

- informimin mbi procesin zgjedhor: sistemin e zgjedhjeve për Kuvend, përmbajtjen e fletës së votimit, kandidatët për deputetë, formulën e shpërndarjes së mandateve; administrimin e procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021. Ndërgjegjësimin, për:

- vlerën që ka vota e lirë dhe e pandikuar në zgjedhjet demokratike;

- shmangien dhe denoncimin e veprimeve që cenojnë votën e lirë dhe sistemin e zgjedhjeve demokratike;

- pjesëmarrjen në votime, si e drejtë kushtetuese dhe detyrim qytetar për shoqërinë dhe vendin.

212. Viti 2020 shënoi finalizimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Integritetit të Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020. Janë përgatitur 4 raporte monitorime për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), nën seksionin Roma Integration.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është duke koordinuar procesin e hartimit të Planit të ri të Veprimit për Integritetin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025.

213. Nga rekomandimet e Seminarit të katërt të Dialogut mbi Politikën për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve, sektorët prioritarë rezultojnë: i) Regjistrimi civil dhe aksesin në drejtësi; ii) Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; iii) Punësimi, aftësimi dhe formimi profesional; iv) Kujdesi shëndetësor; v) Strehimi; vi) Përkujdesja sociale; dhe vii) Antigipsizmi. Procesi është formalizuar me ngritjen e grupit të punës me urdhër nr. 521, datë 23.9.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për hartimin e planit kombëtar të veprimit për integritetin e romëve dhe egjiptianëve, 2021–2025.

- *Rekomandimi: strehimi i pakicave kombëtare, veçanërisht pakicës rome dhe egjiptiane. Zbatimi i rekomandimeve të Komitetit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës*

214. Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social” ka si objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Ky ligj mundëson shtimin e programeve të strehimit nga tri në gjashtë, të cilat janë: 1) Banesë me kosto të ulët. 2) Banesa sociale me qira. 3) Program i zhvillimit të zonave me qëllim strehimin. 4) Programi i përmirësimit të kushteve të banesës. 5) Programi për krijimin e banesave të përkohshme dhe 6) Programi i banesave të specializuara. Njëkohësisht ligji ka parashikuar edhe një sërë instrumentesh financiarë në mbështetje të familjeve me të ardhura të ulëta e të mesme si: subvencionimi i qirasë, subvencionimi i interesave të kredisë për strehim, grant i menjëhershëm për blerjen e një banese me kosto të ulët dhe grantet konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit. Një hap i rëndësishëm në miratimin e këtij ligji është arritur me përcaktimin e procedurave të zhvendosjes, duke përcaktuar mënyrën, kohën dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvendosje.



215. Në nenin 2 të këtij ligji, ndër të tjera, përcaktohet:

- “Programe sociale strehimi” janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që nuk kanë banesë dhe banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuk kanë të ardhura që të sigurojnë pagesën për një qira minimale në tregun e lirë.

- “Dëbim” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale, informale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, pa një proces të rregullt ligjor, në mungesë të konsultimit dhe ofrimit të strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe pa siguruar një mbrojtje ligjore efektive.

- “Zhvendosje” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, me ose kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, mbështetur në konsultim me subjektet e prekura, në ofrimin e strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe në garantimin e mbrojtjes ligjore efektive.

216. Ky ligj mbështetet në një sërë parimesh, si:

- Parimi i mosdiskriminimit: 1) Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga: gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese. 2) Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në

mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t’i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.

- Parimi i respektimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve – njësitë e vetëqeverisjes vendore, në planifikimin e zonave të banimit e të programeve të strehimit, respektojnë traditat dhe kulturat e ndryshme të komuniteteve.

- Parimi i pjesëmarrjes – çdo subjekt që zbaton një program social strehimi përfshin në proces konsultimi komunitetin që preket dhe/ose atë që përfiton nga programi, në përputhje me ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

- Parimi i transparencës dhe i informimit të publikut – organet e njësitë të vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë: informacion të plotë, të lehtë për t’u gjetur, të kuptueshëm dhe të lexueshëm për çdo individ/familje.

- Parimi i sigurisë së qëndrimit: 1) Qëndrimi në një vendbanim, strehim të përkohshëm ose të përhershëm është i pacenueshëm, përveç rasteve që janë në kundërshtim me parimet kushtetuese, si dhe ato të parashikuara me ligj. 2) Ndaloheq dëbimi i individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre. 3) Zhvendosja e individëve/familjeve në rastet e parashikuara në ligj kryhet në përputhje me parimet e njoftimit, konsultimit dhe strehimit të përshtatshëm.

217. Ky ligj parashikon procedurën e zhvendosjes në rast se qëndrimi në një vendbanim ose strehim bëhet i pamundur, për shkak të investimeve me interes publik, prishje të objektit për shkak të përjashtimit nga procesi i legalizimit ose raste të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera. Ligji parashikon procedurën që ndiqet nga njësia e vetëqeverisjes vendore:

- njoftimin me shkrim të individit/familjes për arsyet e zhvendosjes 30 ditë përpara nxjerrjes së aktit administrativ për zhvendosjen nga banesa;

- informimin e individit/familjes për mundësitë alternative të strehimit;

- nxjerr aktin administrativ për zhvendosjen nga banesa 45 ditë përpara zhvendosjes, duke njoftuar edhe formën e miratuar për strehim alternativ;

- zhvendosja, nuk zbatohet pa siguruar më parë sistemimin me strehim të përshtatshëm të individëve/familjeve që zhvendosen dhe nuk përfitojnë shpronësim;

- kundër vendimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për zhvendosje nga banesa, mund të



bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente;

- individët/familjet që preken nga zhvendosja përfitojnë ndihmë juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

- dispozitat tranzitore të ligjit parashikojnë që për dy vjet nga hyrja në fuqi e ligjit, jo më pak se 5% e përfituesve nga programet e strehimit i përkasin pakicës rome dhe pakicës egjiptiane.

218. VKM-ja nr. 405, datë 1.6.2016, “Për miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016–2025”. Qëllimi kryesor i strategjisë është: “Ofrimi i zgjidhjeve të gatshme, të arritshme, të përbalueshme dhe cilësore për strehim për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë një shtëpi në treg të hapur dhe, në veçanti, për familjet me tregues të pozitive të pafavorizuara që çojnë në përfshirje nga strehimi”. Objektivat e strategjisë përfshijnë: 1) Sigurimin e evidencës rreth strehimit social dhe kapaciteteve vendore; 2) Përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional, dhe rregullator; 3) Fuqizimin e instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara; 4) Zgjerimin dhe riorientimin e programeve të strehimit social.

219. Pas miratimit të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, janë miratuar 22 akte nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat mundësojnë edhe zbatimin e tij nga pushteti vendor, duke plotësuar kështu paketën e akteve nënligjore në masën 90%. Janë miratuar:

- VKM-ja nr. 361, datë 29.5.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, i cili parashikon në përputhje me udhëzimet e Kombeve të Bashkuara, procedurat e dëbimit, afatet kohore dhe bashkëpunimin institucional për rastet e zhvendosjes. Kjo VKM trajton të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht nëse ata janë pronarë të shtëpisë ku janë vendosur apo jo. VKM-ja parashikon se qytetarët nuk do të detyrohen të largohen nga shtëpia e tyre, deri në ofrimin e një zgjidhje të përshtatshme për ta sipas programit të strehimit social;

- VKM-ja nr. 453, datë 3.7.2019, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që

përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”;

- VKM-ja nr. 458, datë 3.7.2019, “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore, që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti i shtetit”;

- VKM-ja nr. 459, datë 3.7.2019, “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”;

- VKM-ja nr. 384, datë 12.6.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;

- VKM-ja nr. 361, datë 29.5.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”;

- VKM-ja nr. 362, datë 29.5.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”;

- VKM-ja nr. 522, datë 25.7.2019, “Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”;

- VKM-ja nr. 823, datë 18.12.2019, “Për procedurat e blerjes së shtëpive në tregun e lirë që do t'i shtohen fondit publik të shtëpive me qira sociale”;

- VKM-ja nr. 179, datë 26.2.2020, “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave”;

- VKM-ja nr. 300, datë 15.4.2020, “Për procedurat e shkëmbimit të njëjësive të përbalueshme të banesave”;

- VKM-ja nr. 301, datë 15.4.2020, “Për normat e strehimit, kushtet dhe standardet për shtëpitë sociale që blihen në tregun e lirë dhe shtëpitë me kosto të ulët”;

- rregullorja e ministrit nr. 31, datë 18.11.2019, “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin nga fondet e buxhetit të shtetit për programet e strehimit”;



- mbështetja për strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane, përmes projekteve të investimeve.

- udhëzimi i përbashkët nr. 22, datë 5.6.2020, “Për mënyrën e ndërveprimit të programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor”;

- VKM-ja nr. 496, datë 24.6.2020, “Për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë”;

- VKM-ja nr. 579, datë 22.7.2020, “Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët, i kriterëve, procedurave dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike, si dhe procedurat e administrimit dhe mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme, kompetencat e subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre”;

- udhëzimi i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 33, datë 26.8.2020, “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”;

- udhëzimi i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 40, datë 23.10.2020, “Për mënyrën e administrimit dhe të mirëmbajtjes së banesave të specializuara”;

- VKM-ja nr. 898, datë 18.11.2020, “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banesë të paprivatizuara”.

220. Gjatë vitit 2019, për zbatimin e projekteve të investimeve, janë vënë në dispozicion rreth 292 milionë lekë nga buxheti i shtetit, nga 172 milionë lekë për projektet në vazhdim nga 2018 dhe 120 milionë lekë për zbatimin e fazës së parë të projekteve të reja. Pjesa tjetër e fondeve janë parashikuar nga fondet e buxhetit të shtetit të vitit 2020. Projektet e investimeve, përfshijnë investime për të përmirësuar strehimin, infrastrukturën, furnizimin me ujë dhe kanalizimet dhe investimet për përshtatjen e ndërtesave të shtetëruara, që shtohen në fondin publik të strehimit social. Kanë përfituar 1261 familje, nga të cilat 918 familje kanë përmirësuar kushtet e tyre ekzistuese të strehimit, ndërsa pjesa tjetër kanë përfituar nga përmirësimet e infrastrukturës, kryesisht në vendbanimet informale. Familjet rome dhe egjiptiane përbëjnë rreth 28% të numrit të përgjithshëm të përfituesve.

221. Gjatë vitit 2019, afërsisht 118 milionë lekë janë ndarë nga buxheti i shtetit, nga të cilat 65

milionë lekë janë akorduar për subvencionin e qirasë të 674 familjeve që kanë aplikuar sipas ligjit mbi strehimin. Rreth 15,7% i përkasin përfituesve që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane; 5 milionë lekë për programin e subvencionit të shumës së njëpasnjëshme të 24 familjeve, ku 100% e përfituesve janë familje rome dhe egjiptiane dhe 48 milionë lekë janë dhënë për subvencionin 1-mujor të qirasë së familjeve që janë prekur nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Gjatë vitit 2020, për zbatimin e projekteve të investimeve, janë vënë në dispozicion rreth 354 milionë lekë nga buxheti i shtetit, nga të cilat 92 milionë lekë për projektet në vazhdim nga 2019 dhe 262 milionë lekë për zbatimin e fazës së parë të projekteve të reja. Pjesa tjetër e fondeve janë parashikuar nga fondet e buxhetit të shtetit të vitit 2021. Projektet e investimeve, përfshijnë investime për: a) përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese nga të cilat kanë përfituar 561 familje; b) përshtatjen e ndërtesave shtetërore në objekte banimi, nga të cilat janë përfutur 99 njësi banimi që i shtohen fondit publik të banesave sociale. Familjet e pakicave rome dhe egjiptiane përbëjnë rreth 42% të numrit të përgjithshëm të përfituesve. Në funksion të instrumentit financiar për subvencionimin e qirasë së banesave në treg, janë ndarë nga buxheti i shtetit rreth 3,003 milionë lekë nga të cilat 87 milionë lekë janë akorduar për subvencionin e qirasë për 1,235 familjeve që kanë aplikuar sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”. Rreth 16% e totali të përfituesve i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane dhe 2,945 milionë lekë për subvencionimin e qirasë, për rreth 13,900 familje të mbetura të pastreha si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019.

Neni 16 – Përbërja e popullsisë

222. Ligji nr. 96/2017 mbi pakicat kombëtare, në nenin 16 parashikon ndalimin e kufizimit të të drejtave, konkretisht ndalimin e marrjes së masave që ndryshojnë përbërjen e popullsisë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të banuara nga personat që u përkasin pakicave kombëtare, me qëllim kufizimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj.

223. Siç është informuar dhe sqaruar edhe më sipër, qasja në garantimin dhe ushtrimin e të drejtave të caktuara si përdorimi i gjuhës së pakicës kombëtare në marrëdhëniet mes shtetasve që i përkasin pakicës dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore merr në konsideratë prapen 20%, pra, për



personat që i përkasin një pakice kombëtare dhe që përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë brenda territorit të saj, bazuar në kërkesën e tyre të paraqitur me shkrim.

Nenet 17–18 Bashkëpunimi dypalësh dhe ndërkombëtar

224. Ligji nr. 96/2017 “Mbi pakicat kombëtare”, në nenin 17 parashikon marrëveshjet ndërkombëtare, konkretisht: 1) Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë të drejtën për të vendosur dhe për të mbajtur kontakte të lira e paqësore përtej kufijve të Republikës së Shqipërisë me personat, me të cilët kanë të njëjtin identitet etnik, gjuhësor, fetar ose një trashëgimi të përbashkët kulturore. 2) RSH-ja mund të lidhë

marrëveshje ndërkombëtare me shtete të tjera për të siguruar mbrojtjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në përputhje me ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare në RSH.

IV. Informacion mbi zbatimin e të drejtave të pakicave kombëtare në nivel vendor

BASHKIA TIRANË

225. Bashkia Tiranë përbëhet nga 27 njësi administrative dhe raportohet se në 17 prej tyre ka të paktën një familje rome ose egjiptiane të regjistruar si përfituese e shërbimeve sociale. Zonat me popullsi të konsiderueshme të pakicës rome dhe egjiptiane, janë:

Nr.	Njësia administrative	Nr. i familjeve rome dhe egjiptiane	Zona komunitare
1	Njësia nr. 1	226 familje	Shkozë dhe Lanabregas
2	Njësia nr. 3	52 familje	Rr. “Sitki Cico”, Rr. “Ali Baushi” etj.
3	Njësia nr. 4	290 familje	Allias, Kinostudio, Komuniteti 3700 Grumbullimi, “Gjon Buzuku” etj.
4	Njësia nr. 5	245 familje	Selitë
5	Njësia nr. 6	34 familje	Purpulitet
6	Njësia nr. 8	78 familje	“Siri Kodra”, Bregu Lumit, “5 Maji” etj.
7	Njësia nr. 9	32 familje	Rr. “Jordan Misja”
8	Njësia nr. 11	111 familje	Bregu i Lumit, Instituti, Sulajt etj.
9	Lagja 14	48 familje	Yzberisht
10	Njësia Petrelë	31 familje	Ura e Farkës
11	Njësia Kashar	22 familje	Katund i ri Kashar, Mëzes Fushë-Kashar
12	Njësia Dajt	37 familje	Qendra Kombëtare Tranzitore

226. Pjesa tjetër e familjeve rome dhe egjiptiane të identifikuar në Bashkinë Tiranë ndodhen në njësitë administrative nr. 2, 7, 10, Vaqar dhe Zall-Herr. Këto familje në njësitë administrative të sipërcituara janë të pakta në numër dhe nuk jetojnë në komunitete të identifikuar si të pakicave. Bazuar në Planin Vendor dhe Planin Kombëtar për zhvillimin dhe integrimin e pakicës rome dhe pakicës egjiptiane, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, ka mbështetur dhe ofruar shërbime për individët dhe familjet rome dhe egjiptiane, si vijon:


227. Arsimi: me anë të vendimit nr. 158, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” janë përjashtuar nga tarifat, fëmijët romë dhe egjiptianë që janë regjistruar dhe frekuentojnë çerdhet apo kopshtet. Gjatë vitit 2020 janë regjistruar dhe përfitojnë këtë

shërbim 94 fëmijë nga të cilët 24 janë në çerdhe dhe 70 në kopsht. Ndërkohë, Bashkia mundëson transportin e 35 fëmijëve romë dhe egjiptianë të Lanabregasit që frekuentojnë shkollën 9-vjeçare “Androkli Kostallari”. Sipas programit pilot të mensës në shkollë, është mundësuar salla e mensës në katër shkolla 9-vjeçare: Shkolla e “Kuçe”, shkolla “Hasan Tahsim”, shkolla “Betim Muço” dhe shkolla “Ardian Klosi”. Kjo e fundit është dhe shkolla me pjesëmarrje më të madhe të anëtarëve të pakicës rome dhe egjiptiane.

228. Për disa familje të përfshira në sistemin e ndihmës ekonomike, fëmijët e të cilëve kanë mundur të frekuentojnë shkollën, janë mbështetur me kompensim ushqimor. Llogariten se në vitin 2019 janë përfshirë 11 fëmijë të pakicës rome dhe pakicës egjiptiane në këtë shërbim. Një mbështetje tjetër, është realizuar me anë të vendimeve të Këshillit Bashkiak të



viteve të fundit, ku nxënës të pakicës rome dhe asaj egjiptiane kanë përfituar 77 bursa për regjistrimin dhe frekuentimin e arsimit të mesëm profesional. Të dhëna mbi regjistrimin e romëve dhe egjiptianëve mbi procedurat e regjistrimit civil dhe ndryshimit të vendbanimit, jepen në tabelën më poshtë:



229. Një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së arsimit për këto pakica kanë pasur qendrat komunitare të Bashkisë Tiranë. Shërbimet e ofruara nga këto qendra kanë konsistuar, në: identifikimin e fëmijëve në moshë shkollore, shoqërimin për plotësimin e dokumentacionit, regjistrimin e tyre në sistemin arsimor, ofrimin e klasave mbështetëse për fëmijët me vështirësi, ofrimi i vaktit ushqimor, konsulenca psikologjike etj. Një risi në shërbimet e ofruara në qendra, ka qenë dhe ofrimi i klasave mësimore kundër analfabetizmit të rriturit, ku një interes të lartë kanë pasur banorët romë dhe egjiptianë që frekuentojnë Qendrën Komunitare Shkozë. Të gjitha shërbimet e ofruara nga qendrat komunitare kanë ndikuar edhe në të dhënat e përgjithshme që Zyra Vendore Arsimore jep, sipas viteve.


Vitët shkollore	Nxënës romë dhe egjiptianë sipas nivelit		
	Parashkollor	Klasat I–V	Klasat VI–IX
2017–2018	185	1218	760
2018–2019	385	1586	943
2019–2020	410	1581	852

230. Strehimi: situata e strehimit të pakicës rome dhe pakicës egjiptiane në Tiranë ka qenë problematike dhe e trashëguar prej shumë vitesh. Nga të dhënat dhe studimet e realizuara para vitit 2016 nga institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat monitorojnë dhe adresojnë problematikën e këtyre pakicave në Shqipëri, është konstatuar se, rreth 40% jetojnë në kushte të vështira strehimi, nga të cilat 21% jetonin në baraka, në mungesë të plotë të infrastrukturës së nevojshme.

231. Për të ndikuar pozitivisht në këtë situatë Bashkia Tiranë i ka dhënë një rëndësi të veçantë përfshirjes dhe strehimit të familjeve rome dhe egjiptiane duke i vënë në prioritet në sistemin e pikëzimit dhe duke përfshirë në komisionet e strehimit si përfaqësues i grupit të interesit një anëtar të pakicës rome. Për rastet që janë identifikuar se nuk sigurojnë dot dokumentacionin e nevojshëm të parashikuar nga ligji për përfshirjen në programin e bonusit të qirasë, Bashkia Tiranë i ka përfshirë si raste të veçanta për 1 vit.

232. Me anë të vendimit të Këshillit Bashkiak të vitit 2016 për shpërndarjen e banesave sociale me kosto të ulët, u përfshinë rreth 106 familje rome dhe egjiptiane. Një përfshirje tjetër e konsiderueshme është realizuar dhe në programin e subvencionit të qirasë ku llogariten çdo vit dhjetëra familje të

përfshira në këtë program. Pavarësisht kësaj, efektet e dukshme në strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane, të cilët jetonin në baraka dhe në kushte të vështira higjieno-sanitare, u realizuan në fillim të vitit 2018. Bashkia Tiranë, ka mundësuar ndërtimin e 120 banesave në zonën e Shkozës dhe Lanabregasit për këto familje. Të dhëna mbi familjet rome dhe egjiptiane të përfshira në programet e strehimit social gjatë viteve 2016–2020:



233. Punësimi: Bashkia Tiranë nëpërmjet Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit, mbështet individin për t'u punësuar ose vetëpunësuar në dy forma: 1) duke ofruar grante të rinjtë dhe gratë që kanë një ide dhe duan të hapin ose fuqizojnë një biznes të vogël; 2) duke intervistuar dhe referuar individin për punë në sektorin e shërbimeve të cilat ofrojnë bizneset private. Të dyja këto forma punësimi kanë pasur një ndikim pozitiv në punësimin e individëve rome dhe egjiptianë pasi kjo drejtori i ka dhënë prioritet përfshirjes së tyre. Kjo tregohet nga sesionet informuese që janë realizuar dhe nga projektet që janë realizuar për punësimin e tyre gjatë viteve të fundit. Janë realizuar sesione informimi në Qendrën nr. 4 të Formimit Profesional për 22 të rinj të pakicës rome dhe pakicës egjiptiane, si dhe janë informuar 17 gra për të aplikuar në programet e nxitjes së punësimit. Gjatë periudhës 2016–2020 janë mbështetur 6 individë nga programet e nxitjes së punësimit. Ndërkohë është mundësuar punësimi i 50 individëve, pjesëtarë të pakicave, në sektorin e mbledhjeve të mbetjeve të riciklueshme, ku veç kësaj, përfitojnë dhe një bonus pagese nëse ndjekin klasat kundër analfabetizmit. Iniciativa tjetër është realizuar në vitin 2019 me realizimin e një tregu të rrobave të përdorura për individët rome dhe egjiptianë të zonës së Shkozës. Në këtë treg u mundësua punësimi i 107 individëve nga këto

pakica. Aktualisht është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak hapja e një tregu tjetër për këto pakica në zonën e Selitës.

234. Një risi është dhe hapja e Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë mundëson testimin dhe reflektimin e individëve në moshë të hershme, në mënyrë që kur të zgjedhin profesionin, të dinë aftësitë e tyre dhe nevojat e tregut të punës. Është bërë i mundur:

- Fondi për mbështetjen e grave sipërmarrëse, për trajnim dhe financim të hapjes së bizneseve përmes granteve (rezultojnë – 6 gra përfituese dhe 4 të punësuar në këto biznese).

- Në bashkëpunim me programin ESERE dhe Eco – Tirana ka ofruar 53 vende pune në sektorin e riciklimit dhe pastrimit për banorët e strehuar në Lanabregas dhe Shkozë. (Tre prej të punësuarave janë kontrollues.) Programi i punësimit shton të ardhurat formale në familje dhe i nxit anëtarët e familjes të ndjekin kurset bazë të shkrimit, leximit dhe aftësimin për jetën ose aktivitetet e ngjashme arsimore. (rastet pozitive mbështeten me bonus).

- Përfshirja e personave të kësaj pakice në Qendrën Sociale Multidisiplinare në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekracionit.

- Hapja e tregut publik të rrobave të përdorura në zonën e Shkozës – 107 të vetëpunësuar.



- Hapja e tregut publik të rrobave të përdorura në zonën e Selitës.

- Të vetëpunësuar.

- Programi tranzitor për ricikluesit rom dhe egjiptian:

- të punësuar (rom dhe egjiptian) me kontrata pune 12-mujore;

- marrëveshje bashkëpunimi ECO Tiranë;

- 70 të punësuar në sektorin e pastrimit.


235. Kultura: Bashkia Tiranë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë ditëve të shënuara për pakicat dhe ka realizuar celebrimin e tyre në forma të ndryshme. Konkretisht, më 16 Maj, Ditën e Rezistencës së Romëve në kampin e Autchvits, Bashkia realizoi në fasadën e një pallati në bulevardin “Gjergj Fishta”, një vizatim mural të simbolit të rezistencës rome. Në datën 5 Nëntor të vitit 2013, në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Rome, është vendosur në ambientet përpara oborrit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, monumenti i parë rom, me miratimin e ministrit aktualisht Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj. Bashkia Tiranë nëpërmjet qendrave komunitare realizon aktivitete informuese dhe ndërgjegjëse për çdo ditë të shënuar, si: 8 Prillin, 6 Majin, 16 Majin, 24 Qershorin, 5 Nëntorin etj., ku, veç sensioneve informuese dhe ndërgjegjëse realizohet dhe promovimi i elementeve kulturore, si: gjuha, veshjet, himni, flamuri, gatimet etj.

236. Kujdesi shëndetësor: Bashkia Tiranë nëpërmjet hapësirave ligjore të pushtetit vendor ka ofruar shërbime të informimit, ndërgjegjësimi etj. Konkretisht, nëpërmjet qendrave komunitare është realizuar: informimi, shoqërimi i grave për kryerjen e mamografisë, shoqërimi i fëmijëve për kryerjen e vaksinës, shoqërimi i individëve PAK për ndjekjen e procedurave të daljes në Kemp, shoqërim për

nxjerrjen e kartës së shëndetit, seanca psikologjike, seanca fizioterapie etj. Krahës kësaj, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile është mundësuar ofrimi i shërbimit të mediatorit rom dhe egjiptian. Me anë të këtij shërbimi është mundur të subvencionohet vlera e ilaçeve, duke të rritur dhe ndërgjegjësimin për kujdesin që duhet ndaj shëndetit.

237. Në lidhje me situatën e krijuar nga pandemia Covid-19, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale ka kërkuar kryerjen e dezinfektimit në vendbanimet rome dhe egjiptiane. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 19.3.2020, “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, i ka ardhur në ndihmë me paketa ushqimore, higjeno-sanitare. Rezulton se, gjatë periudhës mars–prill 2020 janë shpërndarë rreth 2950 pako ushqimore për familjet e pakicës rome dhe egjiptiane që jetojnë në Lanabregas, Shkozë, Yzberisht, Selitë, Kombin, Petrelë, Njësinë 3, Njësinë 4, Njësinë 8, Njësinë 9, Njësinë 11.

238. Mbrojtja sociale: në zbatim të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale është krijuar Sektori i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve. Ky sektor, së bashku me punonjësit e mbrojtjeve të fëmijëve në çdo njësi administrative, ka përgjegjësi të identifikojë, të vlerësojë, të referojë për mbështetje dhe të marrë në mbrojtje çdo fëmijë që identifikohet i abuzuar, shfrytëzuar apo neglizhuar. Nga të dhënat e deritanishme rezulton se ka pasur një efekt pozitiv në numrin e rasteve të identifikuara dhe të trajtuara nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve.



239. Informimi dhe ndërgjegjësimi i pakicës rome dhe pakicës egjiptiane mbi rreziqet e trafikimit të qenieve njerëzore është kryer

periodikisht, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve dhe nga qendrat komunitare. Ndërkohë në zbatim të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e



kujdesit shoqëror në RSH” në çdo njësi administrative është instaluar “Regjistri Elektronik i Kujdesit Shoqëror”. Ky regjistër është ndërtuar në vitin 2019 dhe azhurnohet me të dhëna në mënyrë sistematike nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve për rastet që kanë në proces menaxhimi. Në lidhje me ekipet e lëvizshme, Bashkia Tiranë, për periudhën 2018–2020 ka ngritur 11 skuadra terreni, të cilët janë punonjës të qendrave komunitare dhe realizojnë identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e fëmijëve. Me anë të vendimit nr. 66, datë 12.6.2020, të Këshillit Bashkiak, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Komunitare të Terrenit” Bashkia Tiranë mundësoi ndarjen e këtij shërbimi duke e zhvilluar si një strukturë më vete.

240. Me vendimin nr. 129, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”, është përcaktuar edhe procedura për identifikimin dhe referimin e fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Çdo rast i identifikuar në nevojë për mbrojtje, sipas nivelit të rrezikut, është trajtuar me anë të hartimit të Planit Individual të Mbrojtjes, i cili parashikon ndërhyrje konkrete dhe shërbime për fëmijët dhe familjet e tyre në koordinim me Grupin Teknik Ndërsektorial në njësi administrative/bashki.

241. Këto ndërhyrje për rastet e fëmijëve rom të identifikuar në nevojë për mbrojtje, kryesisht janë orientuar, në:

- regjistrimin e çdo fëmije të identifikuar si i paregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe duke ndjekur procedurat e duhura;
- vaksinimin e çdo fëmije që identifikohet i pavaksinuar;
- vizitat mjekësore në institucione shëndetësore për fëmijët dhe mbështetje me medikamente;
- regjistrimin në shkollë dhe kopshte;
- punësimin i prindërve;
- referimin për frekuentim në qendra ditore për fëmijë;
- vendosjen në institucion të përkujdesjes sociale në rast të interesit më të lartë të fëmijës;

- marrjen e masave të mbrojtjes sipas ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

- në rastet e konstatuara ku ka keqtrajtim të mituri sipas Kodit Penal, është bërë dhe kallëzimi penal të shfrytëzuesit;

- këshillimin dhe mbështetjen psikologjike;

- mbështetjen me bonus qiraje apo banesa sociale.

242. Bashkia Tiranë ka gjashtë qendra komunitare në administrim dhe ato janë të shpërndara pothuajse në të gjithë territorin e saj, përkatësisht:

- Qendra Komunitare Shkozë;
- Qendra Komunitare Multidisiplinare;
- Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”;
- Qendra komunitare “Gonxhe Bojaxhi”;
- Qendra Komunitare “Streha Tiranë”;
- Qendra Komunitare të Terrenit.

Shërbimet e tipologjisë multidisiplinare të ofruara në këto qendra, janë:

- mbështetje psikosociale;
- shërbime për nxitjen e punësimit;
- shërbime të parandalimit të riskut;
- orientim i klientit drejt shërbimeve;
- terapi për fëmijët me probleme zhvillimi;
- klasa mbështetëse për fëmijët romë dhe egjiptianë;
- këshillim dhe konsultim të prindërve të fëmijëve me probleme zhvillimi;
- seanca fizioterapie;
- transport i fëmijëve romë dhe egjiptianë të Lanabregasit;
- shërbimi i mensës sociale;
- asistencë ligjore;
- shërbim ditor për të moshuarit;
- kujdes shëndetësor;
- vizita në familje;
- aktivitete social-kulturore etj.



243. Shërbimet në këto qendra në vitin 2020 janë mundësuar të ofrohen në një fashë orare 8:00–20:00 nga e hëna në të shtunë, për të siguruar përkujdes më të zgjatur në kohë dhe mbështetje veçanërisht për fëmijët në shumë procese, të cilat kanë të bëjnë me edukimin dhe zhvillimin e tyre, por edhe vetë familjet. Përfshirja e pakicës romë dhe egjiptiane në këto programe, përmes shërbimeve komunitare



bashkiake është e konsiderueshme dhe llogaritet 998 individë/familje (sipas tabelës më poshtë).

Kategoritë në nevojë	Viti 2020						
	Gjithsej	QKSH	QKM	QKTSB	QKGB	STREHA	QKT
Përfitues total në bazë të dosjeve	1496	479	316	103	305	50	243
Individë/familje rome	807	531	68	5	80	2	121
Individë/familje egjiptiane	191	52	56	0	38	5	40

244. Individë/familje rome dhe egjiptiane, krahas përfitimit të shërbimeve sociale për integrim e fuqizim, janë përfitues edhe në skemat e pagesave për personat me aftësi të kufizuar, ndihmës ekonomike dhe nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për ata aplikues në nevojë të paklasifikuar nga sistemi kombëtar elektronik (sipas tabelave më poshtë).



245. Për të lehtësuar komunikimin midis komunitetit dhe ofruesit të shërbimeve në nivelin vendor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale ka krijuar rrjetin e ndërlidhësve romë dhe egjiptianë. Ky rrjet përbëhet nga përfaqësues të këtyre pakicave në vendbanime të ndryshme dhe ka si qëllim shkëmbimin e informacionit si, nevojat e ndryshme të banorëve, por dhe informimin e tyre për t'u përfshirë në programet e kujdesit. Një aspekt i rëndësishëm në këtë pjesë është fakti se në

Bashkinë e Tiranës janë të punësuar anëtarë të kësaj pakice që lehtësojnë komunikimin dhe në gjuhën e tyre. Në lidhje me investimet konkrete dhe buxhetin e përdorur për strehimin, ofrimin e shërbimeve me impakt pozitiv në komunitetet e pakicave kombëtare, ju informojmë se në zbatim të vendimit nr. 5, datë 31.1.2018, të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e listës përfituese dhe dhënien në përdorim të banesave të ndërtuara për



strehimin e familjeve të komunitetit rom në Shkozë.

246. Nga zbatimi i projektit “New House-New Life: Rehabilitation of Roma Community Settlement”, gjatë periudhës 2016–2017 janë strehuar 60 familje të komunitetit rom, përkatësisht pranë Bllokut të Banesave Sociale Shkozë. Ky projekt ka kushtuar 76 milionë lekë, 69 milionë nga IADSA dhe 7 milionë nga buxheti i Bashkisë së Tiranës. Gjithashtu, në strehim të 60 familjeve të tjera të komunitetit rom, familje këto të prekura nga Projekti i Rehabilitimit të Lumit të Tiranës, me vendim të Këshillit Bashkiak në vitin 2016, është miratuar fondi prej 80,400,000 lekë për ndërtimin e godinave të banimit në territorin e ish-Repartit Ushtarak, Shkozë.

BASHKIA DROPULL

247. Sipas Regjistrit të Gjendjes Civile, Bashkia Dropull ka rreth 22.685 banorë, ku, rreth 98% i përket pakicës greke. Ajo është e shpërndarë në tri njësi administrative (Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm dhe Pogon) dhe 41 fshatra. Të gjitha emërtimet e rrugëve, shesheve, fshatrave, njërive administrative, krahinave janë në gjuhën greke dhe shqipe. Përgjatë aksit kombëtar Gjirokastër Kakavijë, në pjesën që përshkon territorin e Bashkisë Dropull, të gjitha tabelat treguese të fshatrave janë në gjuhën greke dhe gjuhën shqipe. Të gjitha emërtimet e rrugëve të brendshme dhe shesheve në fshatrat pasqyrojnë identitetin dhe traditat.

248. Të dhëna për arsimin: në Bashkinë e Dropullit funksionojnë Shkolla e Bashkuar Dervician dhe Shkolla e Bashkuar Bularat, të cilat kryejnë aktivitetin e tyre në baze të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar. Shkolla e Bashkuar Dervician ka 17 arsimtarë dhe Shkolla e Bashkuar Bularat ka 11 arsimtarë. Gjithashtu, në varësi të Shkollës së Bashkuar Dervician funksionojnë Kopshti Dervician me 1 edukatore dhe Kopshti Goranxi me 1 edukatore. Në varësi të Shkollës së Bashkuar Bularat funksionojnë Kopshti Bularat me 1 edukatore dhe Kopshti Jeorgucat me 1 edukatore. Në institucionet arsimore publike që funksionojnë në territorin e Bashkisë Dropull janë të punësuar 28 arsimtare dhe 4 edukatorë.

249. Për vitin shkollor 2020–2021, në arsimin parashkollor, në arsimin e detyrueshëm dhe në

arsimin e mesëm, janë të regjistruar 215 fëmijë dhe nxënës. Për periudhën 2016–2020, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar për Bashkinë Dropull ishin të regjistruar 870 fëmijë dhe nxënës, për periudhën 2016–2020. Në Shkollën e Bashkuar Dervician dhe në Shkollën e Bashkuar Bularat funksionojnë të gjitha klasat I–XII. Mësimi në kopshte zhvillohet në gjuhën amtare, kurse në arsimin e detyrueshëm, klasat I–IX, 60% e lëndëve zhvillohet mësimi në gjuhën amtare greke dhe në 40% të lëndëve zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe. Ndërsa, për arsimin e mesëm, klasat X–XII, gjuha greke është fakultative.

250. Me urdhrin nr. 234, datë 19.4.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar” (i ndryshuar) është krijuar Zyra Vendore Arsimore Finiq–Dropull, për Bashkinë e Dropullit dhe Bashkinë e Finiqit”.

251. Aktivitete kulturore: në Bashkinë e Dropullit funksionojnë disa grupe artistike dhe folklorike, siç janë grupi i Dropullit të Poshtëm, grupi i Dropullit të Sipërm, grupi polifonik i Pogonit. Nga ana e saj, Bashkia Dropull koordinon punën, duke organizuar dhe financuar festivale lokale dhe shfaqje artistike brenda dhe jashtë vendit. Bashkia Dropull i kushton një rëndësi të veçantë ruajtjes dhe kultivimit të kulturës dhe folklorit të zonës, duke organizuar rrethe jashtëshkollore në bashkëpunim me Shkollën e Bashkuar Dervician dhe Shkollën e Bashkuar Bularat. Gjithashtu, me financimin e Bashkisë Dropull organizohen aktivitete dhe përkujtohen festat kombëtare, si dhe aktivitete të tjera.

252. Të dhëna për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe masën e përfitimit: numri i familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike nëpërmjet aplikimit në Sistemin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike, ka qenë perkatesisht: viti 2016 – 12 individë; viti 2017 – 10 individë; viti 2018 – 52 individë; 2019 – 20. Për vitin 2020 numri është 29 me masë përfitimi vjetore prej 2.980 lekësh. Duke filluar nga viti 2020 dhe në vazhdim janë trajtuar dhe do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar mbi fondin e ndihmës ekonomike (Fond i akorduar nga Bashkia), mesatarisht për 35–40 familje me një fond vjetor prej 1.660–2.000 lekësh.



253. Të dhëna mbi investimet në infrastrukturë. Në periudhën 2016–2020, janë kryer një sërë investimesh në infrastrukturë, të cilat kanë ndikuar në aksesueshmërinë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve qendrore dhe vendore:

- ndërtimi i unazës Pogon, fondi i parashikuar 1.039.180 lekë, ku deri tani janë realizuar 137.898 lekë;

- ndërtimi i Qendrës Multifunkionale në Jorgucat me një fond prej 100.139 lekësh, i përfunduar;

- ndërtimi i Ujësjellësit, me një vlerë prej 552.316 mijë lekësh, nga të cilat janë përfunduar 207.332 lekë;

- rikonstruksion i Urës Llongo me një vlerë 16.345 mijë lekë, i realizuar përfundimisht;

- rehabilitimi i digave të ujëmbledhësve të Bashkisë Dropull me një vlerë 37.002 mijë lekë, realizuar deri tani 14.074 lekë;

- investime të përvitshme në rrugët dhe sheshet e brendshme të Bashkisë çdo në vlerë 35.000 lekë, çdo vit;

- investime të përvitshme në rikonstruksionin e rrjeteve të brendshme të ujësjellësve, depove të ujit në fshatrat e Bashkisë në vlerën 7.500 lekë, çdo vit.

254. Gjithashtu, në kuadër të projekteve INTEREG-IPA, 2016–2020, Bashkia Dropull është përfituese në projektet e mëposhtme:

- “EXTROVER”, vlera 200.000 euro, realizuar 118.000 euro;

- “LED”, vlera 40.000 euro, realizuar 34.000 euro;

- “HERBINO”, vlera 30.000 euro, realizuar 21.000 euro;

- “Polyphonia”, vlera 59.000 euro, realizuar 9000 euro;

- “CLLD-CUITOUR”, vlera 139.000 euro, në proces.

255. Përfaqësimi në organet e zgjedhura dhe organet ekzekutive: përfaqësimi në organet vendore është 100% e anëtarëve të Këshillit Bashkiak ose të 21 anëtarët, i përkasin pakicës greke. Ndërsa nga mesatarja e të punësuarve ndër vite në Bashki në total prej 135 personash, 131 prej tyre ose 97% u përket pjesëtarëve të pakicës greke.

256. Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë zhvillohen në gjuhën greke dhe zbardhen në gjuhën shqipe. Të gjitha dëgjesat publike që lidhen me hartimin dhe zbatimin e buxhetit vendor, me caktimin dhe miratimin e tarifave dhe taksave vendore, që zhvillohen periodikisht çdo vit në njësitë administrative me pjesëmarrje të gjerë, zhvillohen në gjuhën greke.

257. Banorët e Bashkisë Dropull informohen në gjuhën greke, nëpërmjet emisioneve që transmeton Radiotelevizioni Publik Lokal Gjirokastra. (Emision i përjavshëm 60 minuta në televizion dhe i përditshëm 60’ në radio.) Aktualisht, nuk botohet asnjë media e shtypit të shkruar në gjuhën greke. Faqja zyrtare e Bashkisë Dropull, funksionon në gjuhën greke dhe gjuhën shqipe. Një burim tjetër informacioni për banorët janë rrjetet sociale.

BASHKIA FINIQ

258. Bashkia Finiq ka në përbërjen e saj 58 fshatra, me një numër popullsie, që sipas regjistrave civile aktualisht është 35.280 banorë. Në shumicën e fshatrave të 5 njërive administrative të Bashkisë, banorët e regjistruar janë shtetas që i përkasin pakicës greke në masën mbi 90%, por banorët rezidentë janë shumë më pak për shkak të nivelit të lartë të emigracionit, kryesisht në Greqi, por edhe drejt vendeve të Bashkimit Evropian dhe SHBA-së.

259. Përfaqësimi në organet e zgjedhura dhe të emëruara të Bashkisë dominohet nga persona që i përkasin pakicës greke. Në Këshillin Bashkiak prej 21 anëtarësh, 19 prej tyre janë pjesëtarë të pakicës greke dhe 2 janë shtetas shqiptarë.

260. Sa i përket arsimimit të personave që i përkasin pakicës greke, përpjekje të vazhdueshme janë bërë ndër vite. Me krijimin e Zyrës Arsimore Vendore Finiq-Dropull synohet të realizohet ofrimi i teksteve, programeve lëndore, kualifikimi i mësuesve, frekuentimi i rregullt i nxënësve, pavarësisht largësisë nga shkolla më e afërt etj.

261. Si më poshtë informacioni i Zyrës Arsimore Finiq-Dropull, për vitin shkollor 2019–2020 dhe vitin shkollor 2020–2021, mbi shkollat ku mësojnë nxënësit e pakicës kombëtare, numri i nxënësve dhe i mësuesve në to.



Viti shkollor 2019–2020

Nr.	Fshati	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
1	Finig	27	8
2	Bregas	3	1
3	Karahaxh	2	1
4	Mesopotam	36	8
5	Aliko	12	3
6	Dhrovjan	1	1
7	“Lefter Talo”	42	7
8	Dërmish	8	1

Viti shkollor 2020–2021

Nr.	Fshati	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
1	Finig	26	8
2	Karahaxh	2	1
3	Mesopotam	38	8
4	Aliko	7	3
5	Dhrovjan	1	1
6	“Lefter Talo”	52	7
7	Dërmish	8	1

Viti shkollor 2019-2020	Shkolla jopublike “Frymë dashurie”	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
		150	34
Viti shkollor 2020–2021	“Frymë dashurie”	126	19

262. Nxënësit dhe mësuesit punojnë me tekste në gjuhën shqipe dhe gjuhën greke, të miratuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje me planet mësimore. Furnizimi me tekste shkollore sigurohet në lëndët mësimore:

- Gjuha shqipe, klasat I–V;
- Qytetari në gjuhën greke, klasa V;
- Histori në gjuhën greke, klasa IV;
- Qytetari në gjuhën greke, klasa IV dhe klasa IX.

263. Përdorimi i gjuhës së pakicës kombëtare në marrëdhëniet e qytetarëve me autoritetet vendore, veçanërisht në kuadër të informimit të komunitetit është një praktikë tashmë e konsoliduar, kurse gjuha zyrtare në komunikimin shkresor edhe me qytetarët është gjuha shqipe. Njoftimet publike dhe informimi i qytetarëve në faqen zyrtarë të internetit të Bashkisë, si dhe rrjetet sociale bëhet në të dyja gjuhët, gjuhën shqipe dhe gjuhën greke. Brenda territorit të Bashkisë Finiq dhe në rrugën kombëtare (nacionale), tabelat dhe sinjalistika janë në të dyja gjuhët, shqipe dhe greke.

264. Në Bashkinë Finiq janë bërë ndërhyrje në infrastrukturën rrugore, furnizimin me ujë, përpunimin e mbetjeve urbane, mjedisin etj. Sa i takon ofrimit të shërbimeve, nuk ka dallime dhe

janë bërë përpjekje për ofrimin e shërbimeve sociale, shëndetësore, punësimin strehimin sipas nevojave dhe prioriteteve. Sa u takon titujve të pronësisë vijon procesi i pajisjes për të gjithë shtetasit.

265. Promovimi dhe ruajtja e kulturës, trashëgimisë, traditave dhe zakoneve janë në fokus të Bashkisë Finiq dhe është punuar sistematikisht për evidentimin, ruajtjen dhe promovimin e tyre. Përpara kufizimeve të krijuara nga pandemia COVID-19, kalendari i veprimtarive të organizuara apo të mbështetura nga Bashkia ka qenë mjaft i pasur dhe i larmishëm, ku evidentohen:

- Festivali Folklorik, Livadhja, me pjesëmarrje të gjerë të grupeve folklorike nga vendi dhe bota;
- festat kombëtare;
- ndërtimi i Qendrës Kulturore “Katina Papa” në Livadhja;
- rikonstruksioni i Qendrës Kulturore, në Dhrovjan.

266. Bashkia Finiq ka aplikuar në vazhdimësi për të qenë përfituese me projekte në kuadër të programeve të ndryshme të financuara nga Bashkimi Evropian dhe donator. Projektet e zbatuara apo në proces, janë:



- Projekti “Milestones I”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi–Shqipëri 2013–2017, i cili filloi të zbatohet në vitin 2014, me përfutuese ish-komunën e Finiqit dhe përfundoi me sukses në vitin 2017, me objekt kryesor ndërhyrje në infrastrukturën e Parkut Arkeologjik të Finiqit, hapjen e Info Point-it.

- Projekti “Milestones II”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi–Shqipëri 2014–2020, i cili filloi të zbatohet në muajin maj 2018 dhe pritet të mbarojë në muajin qershor të vitit 2021, me objekt kryesor rikonstruksionin e Qendrës Kulturore të Drovjanit.

- Projekti “RyTHM”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi–Shqipëri, i cili filloi të zbatohet në muajin prill 2018, me objekt kryesor instalimin e pajisjeve të nevojshme për Qendrën Kulturore, Livadhja.

- Projekti “Bashkia Finiq më afër grupeve vulnerable me shërbime publike sociale dhe shëndetësore”, nga Programi IADSA II, i cili filloi të zbatohet në muajin korrik 2020 dhe ka parashikuar një kohëzgjatje prej 24 muajsh, me objekt kryesor ndërtimin e Qendrës Sociale, Finiq.

- Projekti “SOLIS”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi–Shqipëri 2014–2020, i cili filloi të zbatohet në muajin dhjetor 2019 dhe pritet të mbarojë në fund të vitit 2021, me objekt rikonstruksionin e një ndërtese në shërbim të bashkisë.

- Projekti “Milestones III”, kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi–Shqipëri 2014–2020, i cili filloi të zbatohet në dhjetor 2019 dhe pritet të mbarojë në fund të vitit 2021, me objekt kryesor rikonstruksionin e një ndërtese për ta kthyer në një muze etnografik në fshatin Livadhja.

BASHKIA PUSTEC

267. Bashkia Pustec është një bashki e cila banohet kryesisht nga persona që i përkasin pakicës maqedonase dhe është e shtrirë në 9 fshatra. Kjo pakicë gëzon të drejtat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe të gjithë shtetasit shqiptarë.

268. Në shkollat e ciklit 9-vjeçar nga klasa I deri në klasën V i gjithë programi shkollor kryhet në gjuhën maqedonase dhe 4 orë në javë në gjuhën shqipe. Nga klasa V deri në klasën IX, 60% e programit zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe 40% e programit zhvillohet në gjuhën shqipe.

Gjuha e dytë në sistemin e shkollës të mesme është maqedonisht dhe anglisht.

269. Bashkia Pustec organizon vazhdimisht aktivitete kulturore për promovimin dhe mbrojtjen e kulturës, traditave zakoneve të pakicës maqedonase. Ritet fetare zhvillohen në gjuhën maqedonase. Në administratën shtetërore janë të punësuar persona që i përkasin pakicës maqedonase.

270. Gjuha zyrtare në të gjitha institucionet e Bashkisë Pustec është gjuha shqipe, por në bashkëbisedimet, gjatë informimit me publikun, konsultimet me komunitetin përdoret edhe gjuha maqedonase. Funksionin gazeta lokale në gjuhën maqedonase “Prespa”.

271. Emërtimi i rrugëve, tabelat orientuese, janë vendosur mbi bazë të emërtimeve që janë miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe kanë emërtime në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase. Toponimet e shkruara kanë emërtime në gjuhën maqedonase.

272. Në bazë të ligjit, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit, “Për të drejtën e informimit”, konsultimet zyrtare me komunitetin përfshijnë: hartimi i buxhetit, paketa fiskale, plani i përgjithshëm vendor, investimet. Zhvillimi i konsultimeve kryhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase. Ka pasur rritje në investimet në punët publike dhe ofrimin e shërbimeve, kryesisht sistemi i ujësjellësit, kanalizimeve.

BASHKIA SHIJAK

273. Në Bashkinë e Shijakut jeton një pjesë e konsiderueshme e pakicës boshnjake, kryesisht në fshatin Borakë. Kjo pakicë është e përfaqësuar denjësisht në Këshillin Bashkiak ku nga 21 anëtarë këshilli 7 prej tyre janë boshnjakë.

274. Në fshatin Borakë tashmë është e ndërtuar dhe shkolla e re 9-vjeçare, e cila mban emrin e një personaliteti të shquar të pakicës boshnjake. Po punohet për finalizimin e hapjes së klasave në gjuhën e pakicës boshnjake.

275. Bashkia Shijak po rindërtohet me 30 pallate të reja dhe mbi 500 shtëpi individuale, nga të cilat rreth 20 shtëpi janë për pakicën boshnjake. Shoqata e pakicës boshnjake “Zambak” ka zhvilluar aktivitete të shumta për promovimin e të drejtave të pakicës boshnjake, aktivitetet kulturore, dokumentarë, botime, publikime etj. Në Bashkinë e Shijakut janë vendosur emërtesa dhe tabela në



gjuhën e kësaj pakice, në zonat ku është e përqendruar kryesisht kjo pakicë, në fshatin Borakë.

BASHKIA GJIROKASTËR

276. Në Bashkinë Gjirokastrë jetojnë në harmoni të plotë banorë, të cilët u përkasin pakicave të ndryshme. Në masën 80% banorët i sigurojnë të ardhurat e tyre në tregtimin e pajisjeve elektro-shtëpiake dhe veshjeve të përdorura, ndërsa pjesa tjetër në grumbullimin e materialeve të riciklueshme, hekurishteve, si dhe bimëve medicinale. Në dispozicion të këtij komuniteti është vendosur edhe hapësira për tregtimin e mallrave. Sipas vendimit nr. 44, datë 28.3.2019, “Për përjashtimin/reduktimin e pagesës së ushqimit në çerdhet/kopshtet për fëmijët në nevojë”, aktualisht përfitues janë 20 fëmijë të cilët frekuentojnë kopshtin “Shpresa Demaj”. Nga Fondi Social, fëmijë që i përkasin këtij komuniteti përfitojnë: paketa ushqimore, veshmbathje, medikamente, mbulim të kostove gjyqësore për fëmijët të cilët vendosen në kujdestari me lidhje gjaku, shërbime psikologjike, ndërmjetësim dhe avokat në rast të të miturve në konflikt me ligjin etj.

277. Të dhëna mbi arsimin e nxënësve të pakicave kombëtare:

Viti 2016 – 18 nxënës të pakicës egjiptiane dhe 15 të pakicës rome;

Viti 2017 – 18 nxënës të pakicës egjiptiane, 11 të pakicës rome;

Viti 2018 – 40 nxënës të pakicës egjiptiane, 14 të pakicës rome;

Viti 2019 – 32 nxënës të pakicës egjiptiane, 20 nxënës të pakicës rome;

Viti 2020 – 75 nxënës të pakicës egjiptiane dhe 16 nxënës të pakicës rome.

278. Nxënësit e pakicës rome dhe pakicës egjiptiane përfitojnë tekste shkollore falas, sipas VKM-së përkatëse. Në shkollën “Siri Shaplllo” janë trajnuar mësues edhe nxënës. Në këtë projekt janë përfshirë edhe çështje të pakicave të marginalizuara, si pakica egjiptiane dhe pakica rome. Pranë shkollës “Pandeli Sotiri” zhvillohet nga klasa I–XI zhvillohet mësimi në gjuhën amtare greke me tekste shkollore në gjuhën greke dhe programe lëndore të përcaktuara nga MASR-ja. Janë zhvilluar trajnime specifike pranë Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit

Grek, në bashkëpunim me Universitetin e Janinës dhe të Selanikut.

279. Fëmijët që frekuentojnë sistemin parauniversitar janë të regjistruar në shkollat publike 9-vjeçare: “së Bashku” – Zinxhira, “Çajupi” – Punëtori, “Koto Hoxhi” – lagja “18 Shtatori”, si dhe “Urani Rumbo” – Palorto. Banorët e këtij komuniteti përbëjnë 2% të popullatës në Bashki. Pakica rome përfiton të gjitha shërbimet duke u trajtuar në të gjitha skemat e mbrojtjes sociale, si pagesat e PAK-ut dhe skemës së ndihmës sociale. 75% e përfituesve të skemës së pikëzimit të ndihmës ekonomike përbëhet nga pakica rome dhe pakica egjiptiane. Për shkak të afërsisë me shtetin fqinj Greqi, konstatohet edhe emigrimi sezonal i personave që u përkasin këtyre pakicave.

280. Pakica egjiptiane është i përqendruar kryesisht në lagjen “Punëtori”, por edhe në lagje të tjera të qytetit. Sipas vendimit nr. 44, datë 28.3.2019, “Për përjashtimin/reduktimin e pagesës së ushqimit në çerdhet/kopshtet për fëmijët në nevojë”, aktualisht përfitues janë 24 fëmijë, të cilët frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet që ndodhen në territorin e Bashkisë. Nga Fondi Social dedikuar fëmijëve, fëmijët që i përkasin këtij komuniteti përfitojnë, paketa ushqimore, veshmbathje, medikamente, mbulim të kostove gjyqësore për fëmijët të cilët vendosen në kujdestari me lidhje gjaku, shërbime psikologjike, ndërmjetësim dhe avokat në rast të të miturve në konflikt me ligjin etj. Ofrohen të gjitha shërbimet duke u trajtuar në të gjitha skemat e mbrojtjes sociale, si pagesat e aftësisë së kufizuar dhe skemës së ndihmës sociale. 75% e përfituesve të skemës së pikëzimit të ndihmës ekonomike përbëhet nga pakica rome dhe pakica egjiptiane.

281. Pakica greke: është i vendosur në Bashkinë Dropull, por banorë që i përkasin kësaj pakice jetojnë në të gjitha lagjet e qytetit të Gjirokastrës, si dhe në njësitë administrative.

282. Pakica arumune: është i vendosur kryesisht në territorin e Njësisë Administrative Odrje dhe në njësitë administrative Cepo, Lunxhëri dhe Antigone. Banorët i sigurojnë të ardhurat e tyre kryesisht nga bujqësia, blegtoria, bletaria dhe tregtia. Nga ana e pushtetit vendor janë marrë të gjitha masat në respektimin e të drejtave të tyre. Bazuar në konventat ndërkombëtare tabelat janë të vendosura edhe në gjuhën arumune në territorin e



Njësisë Administrative Odrie. Me qëllim përmirësimit të cilësisë së jetës së këtyre banorëve, janë kryer një sërë investimesh dhe të tjera janë planifikuar në vijim, investime këto që do të fokusohen edhe në zhvillimin e turizmit për shkak të resurseve dhe trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore të banesave qindraveçare.

BASHKIA KORÇË

283. Në territorin e saj jetojnë persona që u përkasin pakicave kombëtare greke, vllah-arumune, rome, egjiptiane dhe maqedonase. Ajo që duhet theksuar në rastin e pakicës greke në Bashkinë e Korçës është fakti, se si pasojë e emigracionit, shumica dërmuese e anëtarëve të tij ndodhet në emigracion, kryesisht në Greqi. Pakica arumune është e përqendruar kryesisht në disa lagje të qytetit dhe në fshatrat përreth. Pakica maqedonase në bashkinë Korçë është vendosur kryesisht në qytet.

284. Mësimi në gjuhën greke, sipas legjislacionit për arsimin privat zhvillohet në shkollën jopublike “Omios” dhe në gjimnazin “Platon”. Në shkollën jopublike “Omios”, në arsimin parashkollor e frekuentojnë rreth 100 fëmijë, ndërsa arsimin 9-vjeçar e ndjekin rreth 400 nxënës, nga klasat I deri në klasën IX. Gjimnazin “Platon” e frekuentojnë rreth 80 nxënës, nga klasa X deri në klasën XII.

285. Pakicat rome deklarohen me afro 1000 familje (mbi 3 000 anëtarë). Mësimi i gjuhës zhvillohet në mënyrë private prej organizatave rome. Një herë në javë Televizioni Publik Shqiptar jep përmbledhje javore të lajmeve dhe program kulturor në romisht. Pakica egjiptiane është e shpërndarë në gjithë bashkinë.

286. Bashkia Korçë ka miratuar Planin Vendor për Integrimin e Pakicave rome e egjiptiane. Bashkia mban kontakte të vazhdueshme me shoqatat e ndryshme të pakicave kombëtare, në territorin e saj, për të njohur nevojat dhe problematikën e tyre, me pas në planifikimin dhe gjetjen e zgjidhjeve të tyre.

287. Lidhur me strehimin për periudhën 2016–2020, bashkia ka ndërtuar 2 pallate, nga Enti Kombëtar i Banesave, me 74 apartamente, prej të cilave 30% i kanë përfutur persona të pakicave kombëtare. Në bonuset e strehimit që ofron bashkia, mbi 70% të tyre, përfutues janë pjesëtarë të pakicave. Rreth 20% e përfutuesve të kreditë sociale që jepet nga Bashkia, janë prej pakicave.

288. Bashkia është bashkëfinancuese në 30% të vlerës së projektit “Përmirësimi i kushteve të banimit”, me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, ku 80% e përfutuesve janë prej pakicave kombëtare. 26 familje që dolën të pastreha nga rikonstruksioni i Pazarit të Vjetër, si edhe 7 familje që banonin në ndërtesa rrezik shembje, janë strehuar pranë konvikteve të administruara prej Bashkisë. Janë bërë ndërhyrje për përmirësimin e kushteve të banimit në zonën e Gjeologjisë dhe në konviktin e Ndërtimit, ku janë strehuar pjesëtarë të pakicave kombëtare.

289. Është rikonstruktuar Qendra Komunitare, si dhe është miratuar Plani Operacional për funksionimin e Qendrës Komunitare. Janë hapur e funksionojnë 3 qendra ditore për fëmijët e pakicave rome e egjiptiane në bashkëpunim me fondacionin “DORKAS”. Në këto qendra fëmijëve u ofrohet 1 vakt ushqimor, mësues mbështetës dhe aktivitete të larmishme sociale, Bashkia mbështet me qira ambienti dhe mbulim shpenzimesh energji –ujë, 4 qendra të moshës së tretë, ku mbi 50% të përfutuesve janë prej pakicave. Kampi veror 1-mujor “MIQËSIA”, që zhvillohet në periudhën e pushimeve verore, ka mbi 50% të fëmijëve përfutues prej pakicave. Është organizuar java kundër diskriminimit, në bashkëpunim me Komisionerin kundër diskriminimit. Janë organizuar aktivitete të shumta socialo-artistike, për festat e pakicave.

290. Në bashkëpunim me fondacionin “Emanuel” funksionon Qendra Multifunksionale, për të rikthyerit nga emigracioni i paligjshëm, si edhe për të ndihmuar familjet që rrezikojnë për emigracion të paligjshëm, ku edhe këtu 89% e përfutuesve janë nga pakicat kombëtare rome e egjiptiane. Çdo vit bashkia ofron 100 kite shkollore falas, ku 80% e përfutuesve janë fëmijë të pakicave.

291. Bashkia ofron çdo vit kopshte dhe çerdhe falas për fëmijë në nevojë, ku 90%, përfutojnë fëmijë nga pakicat. Është kryer rikonstruksioni i shkollës “Naim Frashëri”, e cila frekuentohet 100% prej fëmijëve të pakicave rome dhe egjiptiane. Në zonat ku është përqendrimi më i madh i tyre, është investuar në një infrastrukturë bashkëkohore si parqe dhe kënde lojërash për fëmijët.

BASHKIA POGRADEC

292. Në Bashkinë Pogradec jetojnë persona që u përkasin pakicave kombëtare: arumune,



egjiptiane, rome, maqedonase, greke. Të dhëna për numrin e popullsisë për secilën prej tyre, Bashkia Pogradec nuk disponon. Nga të dhënat në këtë Bashki janë rreth 2200 egjiptianë dhe romë.

293. Bashkia Pogradec ka marrë masa për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, në nivel vendor, në fushën e arsimit, kulturës, punësimit, strehimit, kujdesit shëndetësor dhe ofrimit të shërbimeve. Më datë 28.2.2020, në Bashkinë e Pogradecit është miratuar Plani Vendor për Integrimin e Komunitetit Rom–Egjiptian 2019–2022, Plan, i cili kushton vëmendje më të madhe integritit të këtij Komuniteti. Zyra e Shërbimit Social në Pogradec ka punuar me familjet e marginalizuara duke i informuar dhe sensibilizuar vazhdimisht rreth temave sociale-kulturore.

294. Në Këshillin Bashkiak Pogradec janë të përfaqësuar:

- 2 këshilltarë të pakicës maqedonase;
- 1 këshilltar të pakicës egjiptiane;
- 1 këshilltar të pakicës arumune.

295. Strehimi i komunitetit egjiptian dhe rom është prioritet i Bashkisë.

- Në vitin 2017, përfitues kanë qenë 17 familje rome–egjiptiane me një vlerë prej 12 milionë lekësh.

- Më 2018 janë restauruar 7 pallate dykatëshe në lagjen nr. 4 ku përfitues kanë qenë 28 familje, 24 familje rome-egjiptiane dhe 4 familje maxhoritare me një vlerë prej 24 milionë lekësh.

- Në vitin 2019 është fituar projekti për restaurimin e banesave ku të përfshira kanë qenë 45 familje nga të cilat 27 familje egjiptiane dhe 5 familje rome me vlerë prej 29 milionë lekësh.

296. Nga programi i kredive të buta për vitin 2020 përfituese janë 6 familje egjiptiane dhe 2 familje rome. Në zonën e Kabashit, ku jetojnë 18 familje rome dhe familje egjiptiane është investuar në infrastrukturë duke u ndërtuar Ura e Kabashit me një vlerë prej 10.000 eurosh dhe ndërtimi i ujësjellësit me vlerë prej 500 eurosh, të financuara nga Këshilli i Evropës dhe vazhdon puna për zgjidhjen e pronësisë të kësaj ndërtese. Në zonën e Gurit të Kuq, ku jetojnë 40 familje rome-egjiptiane në vitin 2019, Bashkia në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit kundër Diskriminimit ka bërë të mundur pezullimin e ankandit të nxjerrë nga Albminiera dhe fitimin e pronësisë të 10 familjeve që jetojnë në këtë ndërtesë. Vazhdon procedura

gjiqësore për familjet e tjera deri në përfundim të kësaj çështje.

297. Në Bashkinë Pogradec, nuk ka problematika të braktisjes së shkollës nga fëmijët e pakicës egjiptiane dhe pakicës rome. Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë, të cilët ndjekin arsimin parashkollor dhe atë të detyrueshëm është: 285 fëmijë romë dhe egjiptianë, 225 egjiptianë dhe 60 romë të përjashtuar nga tarifat për ndjekjen e arsimit. Vëmendje të veçantë i është kushtuar formimit profesional duke i drejtuar të rinjtë romë-egjiptianë drejt Shkollës së Mesme Profesionale ku aktualisht këtë vit janë 61 të rinj, të cilët ndjekin arsimin profesional dhe të gjithë trajtohen me bursa për t'iu mundësuar dhe lehtësuar shkollimin e tyre.

298. Bashkia Pogradec ka mbështetur të rinjtë e pakicave kombëtare duke i punësuar në administratë shtetërore dhe sektorë të ndryshëm, si: Zyra e Shërbimit Social, Zyra e Urbanistikës, Drejtoria e Kulturës, Policia Bashkiake, Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizimeve etj. Në Bashki janë të punësuar nga komuniteti egjiptian dhe rom: 6 specialistë me arsim të lartë dhe 40 punonjës në sektorë të ndryshëm.

299. Për sa i përket mbrojtjes sociale numri i familjeve rome dhe egjiptiane, që përfitojnë ndihmë ekonomike, janë: 161 familje egjiptiane dhe 47 rome. 20 familje, të cilat kanë dalë jopërfituese nga sistemi i ndihmës ekonomike janë trajtuar me 6% të ndihmës. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 janë shpërndarë paketa ushqimore dhe paketa higjeno-sanitare për të gjitha familjet vulnerable rome-egjiptiane në bashkëpunim me organizata dhe fondacione të ndryshme. Është punuar me familjet rome-egjiptiane për të vaksinuar fëmijët e tyre rregullisht pranë qendrave shëndetësore, si dhe të regjistroheshin 4 fëmijë egjiptianë dhe 2 fëmijë romë nga Zyra e Njësisë së Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve.

300. Qendra Ndërkulturore Komunitare ka organizuar aktivitete për pakicat rome dhe egjiptianë për promovimin e kulturës dhe traditës së këtyre dy pakicave kombëtare, siç është data 8 Prill, Dita Ndërkombëtare e Romëve dhe 24 Qershori Dita e Egjiptianëve, si dhe angazhimin e të rinjve romë dhe atyre egjiptianë në aktivitete sensibilizuese mbi tematika sociale-kulturore.

BASHKIA ELBASAN



301. Sipas të dhënave të Bashkisë Elbasan janë identifikuar rreth 2800 romë dhe 5718 egjiptianë. Bashkia Elbasan për t'iu ardhur në ndihmë ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për këtë pakicë ka ngritur struktura të efektshme të cilat bashkëpunojnë me të gjithë aktorët lokalë për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e shërbimeve të ofruara.

302. Bashkia Elbasan ka ngritur prej vitesh një qendër komunitare, e cila ofron edukim, arsimim, dhe aktivitete argëtuese për pakicat rome dhe jo vetëm. Në bashkëpunim me institucione publike dhe jopublike në ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e shkollimit dhe edukimit kemi një rritje të numrit të fëmijëve që frekuentojnë shkolla dhe kopshte.

303. Për arsimin dhe dialogun ndërkulturor, që nga fillimi i vitit shkollor 2020–2021 Bashkia Elbasan ka ndjekur procesin e identifikimit dhe referimit të rasteve të fëmijëve të kësaj në çerdhe, kopshte dhe shkolla. Në koordinim me aktorët lokalë dhe Zyrën Vendore Arsimore në Elbasan u hartua lista me fëmijët që nisën klasën e parë, lista e fëmijëve të cilët për arsye të ndryshme kanë braktisur shkollën. Rastet e fëmijëve që kanë braktisur shkollën janë në monitorim të vazhdueshëm nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar.

304. Për fëmijët që vijnë nga familje me probleme social-ekonomike është bërë koordinim e referim midis strukturave për të përfituar shërbime nga qendrat multifunkionale publike dhe jopublike që operojnë në qytetin e Elbasanit që konsistojnë në përgatitjen e mësimeve pas shkolle, informim mbi situatën aktuale, aktivitete psikosociale etj. Ofrimi i shërbimeve për prindërit e këtyre fëmijëve, por jo vetëm si informim mbi kujdesin dhe vëmendjen që duhet të tregojnë gjatë kësaj periudhe pandemie sesi të kujdesen për rëndësinë e mbarëvajtjes së shkollimit të fëmijëve të tyre, si dhe mbështetje psikologjike në vazhdimësi. Në Bashkinë Elbasan rreth 158-164 familje rome dhe 473 familje egjiptiane përfitojnë ndihmë ekonomike. Afërsisht 220 fëmijë dhe të rritur përfitojnë nga shërbimet sociale që ofrohen nga qendra publike dhe jopublike që operojnë në qytetin e Elbasanit.

305. Në lidhje me punësimin e pakicave rome nga të dhënat aktuale që kemi mbledhur në terren na rezulton që pjesa më e madhe jeton me ndihmë

ekonomike dhe një pjesë të vetëpunësuar në shitjen e rrobave të përdorura, punë artizanale dhe grumbullimin për shitjen e materialeve të riciklueshme.

306. Janë zhvilluar sesione informuese, ndërgjegjëse dhe referim pranë zyrave të punës për të kuptuar përfitimet që rrjedhin nga regjistrimi si punëkërkues i papunë në programet e nxitjes së punësimit apo për orientim drejt kurseve të formimit profesional. Bashkia ka bashkëpunim me organizata dhe fondacione për mbështetjen e familjeve në nevojë nëpërmjet projekteve për fuqizimin e familjeve dhe gjenerim të ardhurave. Rastet e identifikuar nga Bashkia referohen në projekte të nxitjes së punësimit të zbatuar nga Zyra e Punësimit.

307. Për sa u përket problematikave të strehimit të pakicave, Bashkia Elbasan prej vitesh ka mbështetur në përmirësimin e kushteve të banimit duke investuar në lagjen ku jeton pjesa më e madhe e tyre me rregullimin e rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësit, ndriçimin dhe me rikonstruksion banesash. Gjatë vitit 2020 përfituan bonus rreth 158 familje ku 115 ishin nga pakicat rome dhe egjiptiane, ndërsa për vitin 2021 do të trajtohen rreth 130 familje nga këto pakica. Janë rikonstruktuar 41 banesa për egjiptianët dhe 30 për romët. Së fundmi fal bashkëpunimit me ROMACTED u realizua restaurimi i urës në lagjen “5 Maji”.

308. Kujdesi shëndetësor: Bashkia Elbasan në bashkëpunim me strukturat shëndetësore ka garantuar shërbim shëndetësor dhe aksesueshmëri për pakicat rome dhe egjiptiane. Janë realizuar aktivitete informuese në lidhje me masat mbrojtëse ndaj COVID-19, për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e vaksinimit, kujdesit shëndetësor.

309. Lidhur me mbrojtjen sociale, kryhet vlerësimi i nevojave për shërbime sociale dhe i kapaciteteve të institucioneve vendore për të adresuar nevojat specifike të Bashkisë Elbasan, si pjesë e hartimit të Planit Vendor për Mbrojtjen Sociale, 2018–2022. Është ndjekur menaxhimi i rasteve sipas specifikave nëpërmjet tryezave ndërsektorale duke i trajtuar me plane individuale. Funksionojnë 6 skuadrave të terrenit të cilët kanë në përbërjen e tyre punonjës të Drejtorisë së Kujdesit Social dhe Komunitar, si dhe përfaqësues të aktorëve vendorë që kanë në fokus fëmijët. Këto



skuadra identifikojnë dhe monitorojnë rastet e fëmijëve që shfrytëzohen për punë të ndryshme (lypje, shitje ambulatorie, mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme etj.).

BASHKIA VLORE

310. Në Bashkinë e Vlorës trajtohen 67 familje rome në Njësinë Administrative Novoselë dhe 60 familje rome në Njësinë Administrative Shushicë. 13% e familjeve që përbëjnë skemën e Ndhmës Ekonomike në të gjithë Bashkinë Vlorë janë të pakicës egjiptiane. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, lidhur me marrjen e masave të domosdoshme, të menjëhershme për komunitetet rome dhe egjiptiane, në Bashkinë e Vlorës, janë marrë masat për plotësimin e nevojave të tyre bazike për të përballuar këtë situatë emergjente. Konkretisht ka vijuar trajtimi i përfutësve të skemës së ndihmës ekonomike për të gjitha kategorike në nevojë, si dhe të pakicës rome dhe pakicës egjiptiane nëpërmjet ofrimit të paketave ushqimore në mënyrë të vazhdueshme për këta përfutës dhe individë në nevojë, pa përjashtim sidomos në dy njësitë administrative Novoselë dhe Shushicë.

311. Administratorët socialë kryesisht të këtyre njërive, të cilat kanë në përbërje përfaqësues të këtyre pakicave, por edhe administratorët e rajoneve brenda Bashkisë ku trajtohen një numër i konsiderueshëm i këtyre pakicave, ndjekin zbatimin e masave për mos braktisjen e shkollës të fëmijëve të këtyre pakicave. Aktualisht Bashkia e Vlorës po bashkëpunon me Qendrën Kombëtare për Studime Sociale në kuadër të projektit SoRI II. Ky projekt ofron mbështetje për frekuentimin e shkollës pa ndërprerje të fëmijëve të pakicave rome dhe egjiptiane nëpërmjet linjës së internetit që do të shtrihet për këto familje dhe dhënien e tabletave për familjet që kanë dy ose më shumë fëmijë që frekuentojnë shkollën për të mundësuar mësimin *online* në kushtet e pandemisë Covid-19. Janë zhvilluar fushata sensibilizuese kryesisht takime ndërgjegjësuere kundër dhunës, abuzimit dhe martesave në moshë të hershme.

BASHKIA PËRMET

312. Sipas informacionit të Bashkisë Përmet në territorin e kësaj bashkie ndodhen rreth 200 familje të pakicës egjiptiane, të cilat janë shpërndare në qytetin e Përmetit dhe në Njësinë Administrative

Piskovë. Për këtë komunitet, bashkia Përmet ofron mbështetjen me shërbimet bazë të nevojshme. Gjithashtu, janë shpërndarë edhe tekstet shkollore falas për fëmijët. Në strukturat mbështetëse të Bashkisë gjatë vitit 2020 janë punësuar rreth 30 punonjës. Në njësinë administrative Piskovë janë ndërtuar shtëpitë e rreth 15 familjeve të pakicës egjiptiane edhe me mbështetjen e projektit ROMACTED, si dhe bashkia ka ndihmuar rreth 50 familje për rikonstruksionin e shtëpive.

313. Bazuar në ligjin, “Për strehimin sociale” dhe ligjin, “Për vetëqeverisjen vendore”, Këshilli Bashkiak ka miratuar gjatë 2020 listën e fëmijëve të pastreha që kërkojnë të përfitojnë strehim sipas programeve sociale të strehimit, ku kanë përfutur 6 persona të pakicës egjiptiane nga totali prej 9 personash. Në Këshillin Bashkiak është i përfaqësuar një anëtar i pakicës egjiptiane.

ANEKSE TË RAPORTIT

Aneks nr. 1 – Projekte për mbështetjen e kulturës së pakicave kombëtare

1. Ministria e Kulturës, gjatë viteve 2016–2020, janë mbështetur financiarisht nga, projekte me thirrje, për promovimin dhe mbrojtjen e vlerave dhe identitetit kulturor të pakicave kombëtare, konkretisht:

2. Për vitin 2016:

- “Përmeti Multikulturor, Minoritete dhe Etni”, organizuar nga Dega Shqiptare e CIOFF-së, në datat 21–23 qershor, Përmet;

- “Kronikë në Dropull”, organizuar nga shoqata “Connex” sh.p.k., në datat 7–15 gusht, në disa fshatra të zonës së Dropullit;

- Është duke u zhvilluar procesi i regjistrimit dhe i inventarizimit të elementeve të trashëgimisë jomateriale me bazë komunitetin, nga i cili do të përfitojnë edhe kulturat e pakicave kombëtare;

- Festivali Multikulturor Berat – Edicioni III-2016 nga organizata “Njerëz dhe ide”;

- “Arti, fëmijët dhe muzeu” me fëmijët romë;

- Ekspozitë rome: Art e folk;

- Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, edicioni i 11-të - Ora Film Marubi;

- “Fjalor romisht-shqip” - Rromani Baxt Albania.

3. Për vitin 2017:



- “Përmeti Multikulturor, Minoritete dhe Etni”, organizuar nga Dega Shqiptare e CIOFF-së, në qershor (grupe dhe individë të kulturave të ndryshme). Në këtë veprimtari, në vitin 2017 morën pjesë gjithsej 140 artistë. Përveç përfaqësuesve nga pakicat e ndryshme kombëtare, morën pjesë edhe 25 artistë nga komuniteti egjiptian dhe 10 artistë nga komuniteti rom;

- “Aulona festival” (grupe nga shtete e kultura të ndryshme, por dhe përfaqësues të pakicave kombëtare në Shqipëri);

- “Oda dibrane” (marrin pjesë edhe përfaqësues të pakicave kombëtare);

- “Festivali Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut”, edicioni i 12-të. 18–20 shtator 2017, Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”. Qëllimi i tij është të edukojë publikun e të rinjve në Shqipëri rreth çështjes së të drejtave të njeriut dhe pakicave kombëtare;

- Për vitin 2017, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve, Ministria e Kulturës financoi dhe mundësoi performancën teatrore të një grupi të rinjsh romë me titull “Pjata prej druri”, në një nga teatrot më të rëndësishëm shtetërorë.

4. Për vitin 2018:

- Festivali traditë “Përmeti Multikulturor, Minoritete dhe Etni”, organizuar nga Dega Shqiptare e CIOFF-së, ku pati përsëri pjesëmarrje e shkëmbime kulturore mes ansambleve të huaja, si rome, egjiptiane dhe vllahe dhe atyre shqiptare;

- Aktiviteti “Vera kulturore maqedonase 2018” organizuar në Pustec me 25–30 korrik, ku u zhvilluan koncerte folklorike, panaire artizanati dhe kulinarie etj., të pakicës maqedonase.

5. Për vitin 2019:

- Projekti “Dorë për dorë breza vallesh” të komunitetit grek, nga Shoqata Multifunkionale për Kulturë”, zhvilluar në Njësinë Administrative Dervician më 18 prill;

- Projekti “Festivali Folklorik i pakicës maqedonase në Shqipëri” nga shoqata “ILINDEN”, organizuar në Tiranë, më 9 qershor;

- Projekti “Mijëvjeçari i romëve: Panairi i kulturës dhe traditës rome” nga OJF “Disutni Albania” organizuar në qytetin e Korçës më 15 prill;

- Projektfestivali traditë “Përmeti Multikulturor 2019 pakicat kombëtare dhe etni”, organizuar nga Seksioni Shqiptar i CIOFF-së, ku përveç

ansambleve shqiptare morën pjesë edhe grupe pakicat kombëtare egjiptiane dhe greke;

- Projektfestivali “Përmeti Multikulturor 2019”, zhvilluar në qytetin e Përmetit, më 21–23 qershor 2019. Në këtë festival morën pjesë 7 grupe me rreth 130 pjesëmarrës.

6. Pjesëmarrës në këtë festival ishin:

- Grupi i Shoqatës Kulturore “Afërdita, Tiranë”, grupi i minoritetit grek nga Finiqi, Sarandë, Grupi “Syziu Danc” nga Lushnja, grupi popullor “As e madhe as e vogël” Kolonjë, grupi i Shoqatës Kulturore “Avjerinos” nga Janina, Greqi, Grupi i Vevçanit, Maqedoni dhe grupi popullor i Këlcyrës, përfaqësues i komuniteti egjiptian (9 artistë). U ndoq nga 1000 spektatorë;

- “Mijëvjeçari i romëve: Panairi i kulturës dhe i traditës rome në qarkun e Korçës”. Aplikues OJF “Disutni Albania”;

- U zhvillua në periudhën 15 shkurt–15 prill 2019, në Korçë;

- Në këtë projekt u përfshi edhe krijimi i Ansamblit Popullor të Kërcimit Tradicional Rom me djem dhe vajza rome. Aktiviteti u zhvillua në hapësirat e Pazarit Karakteristik të Korçës, më datë 15 prill. Morën pjesë 60 artistë rom dhe 10 artizanë nga pakica kombëtare rome. U ndoq nga 600 spektatorë;

- Projektfestivali Folklorik i pakicës kombëtare maqedonase në Shqipëri, nga shoqata “ILINDEN”, organizuar në Teatrin e Kukullave. Morën pjesë 100 artistë nga pakica kombëtare Maqedonase. U ndoq nga 100 spektatorë;

- Projekti “Dorë për dorë breza vallesh” Shoqata Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim, organizuar në Dervician (pakica greke). Morën pjesë 80 artistë dhe 35 fëmijë nga pakica kombëtare greke. U ndoq nga 800 spektatorë.

7. Për vitin 2020: Projekti Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Rome”, që u zhvillua nga shoqata “Rromano Kham”, në Tiranë, më 5 nëntor 2020. Për shkak të pandemisë COVID-19 nuk është bërë i mundur realizimi i një sërë aktiviteteve të cilat ishin parashikuar.

Aneks 2 – Programet e transmetuara mbi pakicat nga viti 2017 deri në vitin 2020

Viti 2017

Reportazh për ERIAC - qendra kulturore e romëve në Berlin

Kulla e Hirit/romët



Identiteti nis nga Abetarja/romët

Këngë serbo-malazeze

Lajme nga e hëna në të premte

Lajme shkurt në gjuhën bullgare, greke, arumune, rome, maqedonase, serbe

Çdo të shtunë dhe të diel, çdo minoritet ka 30 minuta hapësirë për muzikë në gjuhën e çdo pakice.

Viti 2018

Aliazh-bullgare

24 orë reportazh (për egjiptianët)

Ata janë tjetri ... , por si ne (dokumentar për romët)

Dita Kombëtare e Egjiptian NE në Shqiptari

Punësimi dhe strehimi i pakicave egjiptiane

Rikonstruksioni i pakicave egjiptiane në Librazhd

Shkolla Komunale Komuniteti Egjiptian

Të rinjtë egjiptianë drejt punësimit-formimit

Trashëgimia kulturore e romëve të Shqipërisë

Vllahët e Selenicës

Selenica

Në Nartë

Lajme nga e hëna në të premte

Lajme shkurt në gjuhën bullgare, greke, arumune, rome, maqedonase, serbe

Çdo të shtunë dhe të diel, çdo minoritet ka 30 minuta hapësirë për muzikë në gjuhën e çdo pakice kombëtare.

Viti 2019

Dokumentar “Ama dorën-romë”

Ansambli “Vangeloff” në Shqipëri 2019 – Bullgari

Gjuha e urrejtjes

Emisioni NE – Romët

Emisioni NE – Arumunët

Emisioni NE – Pakica malazeze në Shqipëri

Emisioni NE – Pakica bullgare

Emisioni NE – Pakica maqedonase

Emisioni NE – Fëmijët romë arsimohen njësoj si ne

Emisioni NE – Pakica greke

Lajme nga e hëna në të premte

Lajme shkurt në gjuhën bullgare, greke, arumune, rome, maqedonase, serbe

Çdo të shtunë dhe të diel, çdo pakicë kombëtare ka 30 minuta hapësirë për muzikë në gjuhën e çdo pakice.

Viti 2020

Dokumentar – Punësimi i romëve në Kosovë

Dokumentar – “Kultura egjiptiane në Pejë”

Në gjurmët e mjeshtërve të mëdhenj romë

Emisioni NE gjatë vitit 2020

Emisioni NE – Pakica maqedonase

Emisioni NE – Pakica malazeze

Emisioni NE – Arsimi i fëmijëve romë

Emisioni NE – Fëmijët romë arsimohen njësoj si të gjithë fëmijët

Emisioni NE – Arumunet ndër shekuj me ne

Emisioni NE – 28 Qershori – Dita e Pakicës Egjiptiane

Emisioni NE – Ligji mbi pakicat kombëtare në Shqipëri

Emisioni NE – Pakica malazeze në Shqipëri

Emisioni NE – Pakica egjiptiane

Emisioni NE – Arsimi për fëmijët romë në Shqipëri

Lajme nga e hëna në të premte

Lajme shkurt në gjuhën bullgare, greke, arumune, rome, maqedonase, serbe

Çdo të shtunë dhe të diel, çdo pakicë ka 30 minuta hapësirë për muzikë në gjuhën e çdo pakice kombëtare.

Aneks nr. 3 – Informacion shtesë mbi informimin e pakicave mbi zhvillimin e procesit zgjedhor (fushata ndërgjegjësuere, spote, fletëpalosje gjatë periudhës 2016–2020)

1. Celebrimi i Ditës Botërore të Zgjedhjeve, një nga veprimtaritë më të rëndësishme për edukimin zgjedhor organizohet çdo vit nga KQZ-ja, më 5 shkurt 2016 u realizua në ambientet e Qendrës Rinore “Tirana”, me të rinj të kryeqytetit, votues për herë të parë. Me moton, “Për romët, me romët”, në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri IRCA-n, u hartuan dhe u vunë në zbatim programe edukuese zgjedhore për komunitetet rome dhe egjiptiane. Metodologjia, format dhe mjetet e përdorura, u bazuan në specifikat sociale, nivelin kulturor dhe arsimor të komuniteteve. Në bashkëpunim me OSBE-në u shpërndanë fletëpalosje me informacion për procesin zgjedhor në gjuhën rome u shpërndanë për pjesëmarrësit, kryesisht gra dhe të rinj romë dhe egjiptianë.

2. Zgjedhjet për Kuvend 2017. KQZ-ja zbatoi projektin për edukimin zgjedhor të komunitetit rom, me mbështetjen e OSBE-së. Gjithashtu u prodhuan dhe u shpërndanë në vendqëndrimet e pakicave kombëtare:



- në gjuhën greke: 3000 postera, fletëpalosje: 2000 format A4 dhe 2000 format 85x400;

- në gjuhën maqedonase: 2000 postera, fletëpalosje: 1000 format A4 dhe 1000 format 85x400;

- në gjuhën romishte: 1000 postera fletëpalosje: 1000 format A4 dhe 1000 format 85x400;

- në gjuhën arumune: 1000 postera fletëpalosje: 1000 format A4 dhe 1000 format 85x400;

- në gjuhën malazeze: 700 postera fletëpalosje: 700 format A4 dhe 700 format 85x400.

3. U trajnuan nga administrata e KQZ-së, 25 studentë romë nga të 12-të qarqet e vendit dhe u aftësuan për të zhvilluar sesione edukimi zgjedhor në komunitet. Të rinjtë e trajnuar, në bashkëpunim me administratën e KQZ-së realizuan mbi 22 sesione edukimi zgjedhor në vendqëndrimet e komunitetit rom në qarqet Gjirokastrë, Lezhë, Durrës, Delvinë, Berat, Fier, Korçë, Tiranë, Elbasan, Shkodër, Pogradec. Në këto sesione morën pjesë rreth 856 anëtarë të komunitetit rom, nga të cilët 432 ishin femra, ndërsa 328 ishin meshkuj. Studentët rom të angazhuar si trajnerë, ishin në ndihmë të komunitetit gjatë muajit qershor 2017 për të orientuar zgjedhësit për qendrat e votimit ku ishin të regjistruar, vendndodhjen e tyre, si dhe për adresimin e problemeve të ndryshme të komunitetit në prag zgjedhjesh, përfshirë edhe tentativa për blerjen e votës. Në sesionet e edukimit numri i kontaktit të trajnerit iu vendos në dispozicion pjesëmarrësve për të raportuar çdo situatë që mund të pengonte pjesëmarrjen e lirë në zgjedhje.

4. Ky projekt solli përfitime të prekshme për procesin e votimit, por, gjithashtu, synoi lënien e një trashëgimie afatgjatë në komunitet, nëpërmjet trajnimit me parimet themelore demokratike, për trajnimin e anëtarëve të komunitetit si të bëjnë zgjedhjen e tyre, dhe si të vlerësojnë mbajtjen e përgjegjësisë nga përfaqësuesit e tyre politikë.

5. Si rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm me shoqata të pakicave kombëtare u realizuan takime për informim zgjedhor në Dervician (pakica kombëtare greke), në Pustec (pakica kombëtare maqedonase) në Vlorë (pakica kombëtare arumune) në Tiranë, Fier dhe Durrës (pakica kombëtare rome dhe egjiptiane).

6. Zgjedhje vendore 2019: KQZ-ja nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin Shtetëror të Pakicave Kombëtare. Posterat dhe fletëpalosjet,

në gjuhët të pakicave kombëtare, dhanë informacion të plotë për llojin dhe datën e zgjedhjeve, sistemin e zgjedhjeve vendore, oraret dhe procedurat e votimit, dokumentet e identifikimit për votim, të drejtat dhe detyrat e zgjedhësve, veprat penale që cenojnë zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

7. Posterat informues dhe edukues në gjuhë të pakicave kombëtare (5 lloje), u dërguan në KZAZ-të përkatëse për t'u shpërndarë dhe afishuar në qendrat e votimit me vendndodhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore me numrin më të madh të pakicave kombëtare.

- në gjuhën greke: 4000 postera, fletëpalosje: 2000 format A4 dhe 2000 format 85x400;

- në gjuhën maqedonase: 3000 postera, fletëpalosje: 1000 format A4 dhe 1000 format 85x400;

- në gjuhën romishte dhe egjiptiane: 2000 postera, fletëpalosje: 1000 format A4 dhe 1000 format 85x400;

- në gjuhën arumune: 1000 postera, fletëpalosje: 1000 format A4 dhe 1000 format 85x400;

- në gjuhën malazeze: 700 postera, fletëpalosje: 700 format A4 dhe 700 format 85x400;

- në gjuhën serbe: 700 postera, fletëpalosje: 700 format A4 dhe 700 format 85x400;

- në gjuhën boshnjake: 700 postera, fletëpalosje: 700 format A4 dhe 700 format 85x400;

- në gjuhën serbe: 300 postera, fletëpalosje: 300 format A4 dhe 300 format 85x400;

- në gjuhën bullgare: 300 postera, fletëpalosje: 300 format A4 dhe 300 format 85x400.

8. Për pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane u realizua projekti i veçantë “Vota ime vlen”, në bashkëpunimin me IRCA (Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri), mbështetur nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI), në 12 qarqet e vendit. Studentë romë (25) nga të 12-të qarqet e vendit u trajnuan nga administrata e KQZ-së dhe u aftësuan për të zhvilluar sesione edukimi zgjedhor në komunitet. Të rinjtë e trajnuar, në bashkëpunim me administratën e KQZ-së realizuan mbi 30 sesione edukimi zgjedhor në vendqëndrimet e komunitetit rom në qarqet Gjirokastrë, Lezhë, Durrës, Delvinë, Berat, Fier, Korçë, Tiranë, Elbasan, Shkodër, Pogradec. Në këto sesione morën pjesë rreth 900 anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian nga të cilët 550 ishin femra, ndërsa 350 ishin meshkuj.



9. Studentët romë të angazhuar si trajnerë, ishin në ndihmë të komunitetit gjatë muajit qershor 2019 për të orientuar zgjedhësit për qendrat e votimit ku ishin të regjistruar, vendndodhjen e tyre, si dhe për adresimin e problemeve të ndryshme të komunitetit në prag zgjedhjesh, përfshirë edhe tentativa për blerjen e votës. Në sesionet e edukimit numri i kontaktit të trajnerit iu vendos në dispozicion pjesëmarrësve për të raportuar çdo situatë që mund të pengonte pjesëmarrjen e lirë në zgjedhje. Metodologjia dhe mjetet e përshtatura, bënë që sesionet e edukimit zgjedhor të ndiqeshin me interes nga komunitetet rome dhe egjiptiane, duke i qartësuar procedurat e votimit dhe rritur besimin për të ushtruar të drejtën e votës në mënyrë të pandikuar.

10. Gjithashtu, KQZ-ja, në bashkëpunim me prezencën e OSBE-së, realizoi në vendqëndrimet e pakicës rome dhe pakicës egjiptiane projektin informues dhe ndërgjegjësues me fokus gratë dhe të rinjtë, për trajtimin e fenomenit negativ të shitblerjes së votës, pasojat individuale dhe shoqërore në rast të tjetërsimit të vullnetit përkundërt ofrimit/dhënies së të hollave apo të mirave materiale, si dhe të votimit familjar. Në sesionet që u realizuan në kuadër të këtij projekti morën pjesë 356 anëtarë pakicave rome dhe egjiptiane (198 gra dhe 158 burra).

Aneks nr. 4 – Informacion shtesë – Avokati i Popullit (AP)

1. Avokati i Popullit vlerëson si prioritet të aktivitetit të tij, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Duke iu referuar rekomandimeve për marrjen e masave të menjëhershme, lidhur me: “Miratimin pa vonesa të mëtejshme të legjislacionit dytësor të nevojshëm për ta bërë ligjin mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare të zbatueshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe veçanërisht dispozitave të Konventës Kuadër për Pakicat Kombëtare”, konstatohen se ka pasur vonesa në këtë proces.

2. Më datë 25.2.2020, AP-ja i është drejtuar me një rekomandim kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për përmbylljen e procesit të nxjerrjes së akteve nënligjore, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2017.

Konstatohen se ende nuk janë nxjerrë dhe nuk kanë hyrë në fuqi, disa akte të rëndësishme nënligjore për këtë qëllim.

3. AP-ja vlerëson se ky proces është shumë i nevojshëm dhe duhet përmbyllur në një kohë sa më të shpejtë, me qëllim garantimin e plotë të të drejtave në komunitet, por edhe të të drejtave individuale të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në Shqipëri. Gjatë vitit 2020, AP-ja ka dhënë mendim mbi tri projektvendimet e paraqitura nga Ministria e Brendshme:

- projektvendimi, “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”;

- projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”;

- projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”.

4. Censusi i popullsisë: Gjatë procesit të konsultimit të projektligjit, “Për censin e popullsisë dhe të banesave”, si dhe më herët në Raportin “Mbi të drejtat e pakicave kombëtare në Shqipëri”, dërguar Kuvendit të Shqipërisë, më 2015, Avokati i Popullit ka dhënë rekomandimet lidhur me: “zhvillimin e një censusi të ri të popullsisë, mbi bazën e kriterëve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, ku pakicat, do të gjenin veten për t’u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre”. Zhvillimi i një censi në këto standarde do të ndihmonte në zbatimin e disa dispozitave të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”.

5. Sipas Avokatit të Popullit, legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare ka njohur ndërkohë zhvillim dhe përmirësim, referuar këtu edhe procesit të konsultimit të projektvendimeve, që do të nxirren në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe që do të propozohen për miratim nga ana e ministrit të Brendshëm.

6. Sipas Avokatit të Popullit, është e nevojshme të kryhet një proces harmonizimi i të gjithë



legislacionit në tërësi, që synon të rregullojë regjimin juridik të censit, pa përfshirur këtu projektaktet nënligjore dhe projektligjet që lidhen direkt, ose indirekt, në zbatimin e tyre, me procesin e censit dhe të dhënat që sigurohen prej tij. Kjo kërkesë bëhet edhe më sensitive, në rastin e pyetjeve për grupin etnik, fenë dhe gjuhët, përgjigjet e të cilave bazohen në deklarin e lirë dhe jo të detyrueshëm të individit. Gjetja e alternativave të duhura në përmbajtjen e pyetësorit të censit të hartuar nga INSTAT-i, merr një rëndësi të veçantë për vet objektivitetin dhe besueshmërinë e procesit, në këtë kuptim.

7. Në vazhdim në nenet e tjera të projektligjit, tregohet një kujdes i veçantë dhe i detajuar për ruajtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe jepet një përcaktim i detajuar për përbërjen dhe kompetencat e institucioneve dhe strukturave administrative, që do të kujdesen për mbarrëvajtjen e procesit të censit (Komisioni Qendror i Censit, INSTAT-i dhe zyrat e censit). Sipas Avokatit të Popullit, INSTAT-i ka një rol domethënës në këtë proces, për konstatimin, shqyrtimin dhe vendosjen e dënimit administrativ, sipas parashikimeve të ligjit.

8. Kuadri legjislativ për ndalimin e diskriminimit: që në fillim të vitit 2013, institucioneve kompetente është dërguar një rekomandim për disa përmirësime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, për përfshirjen si shkaqe për diskriminim të; kombësisë; qëllimit të shpallur për të diskriminuar; nxitjes për diskriminim dhe ndihmesës dhe inkurajimit të diskriminimit. Me ndryshimet e fundit në ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka pasur përmirësime, por nuk përfshihen rekomandimet e risjella në vëmendje nga ana e Avokatit të Popullit.

9. Situata socio-ekonomike e romëve dhe egjiptianëve: Avokati i Popullit prej kohësh ka trajtuar problematikat e pakicës kombëtare rome dhe pakicës kombëtare egjiptiane, të cilët hasin ende shumë pengesa për përfshirjen dhe integrimin në sistemin social: strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike apo edhe arsimimin, punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor.

10. Kushtet e vështira të pandemisë COVID-19, në vendin tonë, kanë bërë që vëmendja e AP-së

të drejtohet në mënyrë të veçantë te gjendja e pakicave rome dhe egjiptiane, duke adresuar disa rekomandime specifike për marrjen e masave të domosdoshme, të menjëhershme, për pakicën rome dhe pakicën egjiptiane.

- 11. “Aleanca pa Urrejtje” dhe institucionet themeluese të saj: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti Audiovizual i Medias dhe Këshilli Shqiptar i Medias do të punojnë së bashku për promovimin dhe advokimin në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në Shqipëri. “Aleanca pa Urrejtje” konsiston në një qasje të përbashkët në promovimin e diversitetit dhe më konkretisht, do të:

- zhvillojë komunikimin dhe materiale informuese për të ndërgjegjësuar dhe promovuar diversitetin dhe lirinë e shprehjes, si: broshura, raporte, fushata etj., për të arritur audiencat e saj dhe publikun e gjerë;

- nxisë bashkëpunimin me organizata dhe agjenci partnere, të cilat luajnë kanë një rol në luftën kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, si: Ministria e Edukimit, Rinisë dhe Sporteve, furnizuesit e shërbimit të internetit (ISP), organizatat e gazetarëve, organizatat e shoqërisë civile, organizatat për mbrojtjen e konsumatorit etj.;

- mbështesë partnerët në identifikimin e mekanizmeve efektive për të luftuar gjuhën e urrejtjes bazuar në praktikat dhe standardet evropiane;

- identifikojë mekanizmat për përmirësimin e ndarjes së informacionit dhe trajnimin e stafit.

12. “Aleanca pa Urrejtje” do të zhvillojë një agjendë të përbashkët dhe do të ndajë një plan të veprimeve ku do të përcaktohen ndërhyrjet për t’u përmbushur gjatë 3 vjetëve në vazhdim. Aleanca mbështetet nga dy projektet e Programit të përbashkët të BE-së dhe të Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022”, respektivisht Projekti “Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri” dhe projekti “Liria e Shprehjes dhe e Medias (JUFREX)”.

Aneks nr. 5 – Informacion shtesë – Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)

1. Një ndër mekanizmat kombëtarë për mbrojtjen e pakicave dhe për garantimin e zbatimit



të ligjit, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) si një institucion publik dhe i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij i cili “siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin” (neni 21, pika 1). Ndryshimet ligjore të ligjin nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, kanë rritur garancitë ligjore për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH. Zyra e Komisionerit i ka të gjitha instrumentet për t’i shqyrtuar situatat diskriminuese ndaj pakicave kombëtare në mënyrë profesionale dhe efektive.

2. Krahas zyrës qendrore, Komisioneri e ushtron veprimtarinë e tij edhe nëpërmjet zyrave rajonale në Korçë, Shkodër, Fier. Me vendimin nr. 88, datë 23.7.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe i organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës, nga 23 punonjës që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KE-së, “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit”, Komisioneri pilotoi 3 zyra rajonale në qytetet Korçë, Gjirokastrë dhe Shkodër deri në vitin 2018. Burimet financiare të Komisionerit, kanë pësuar një rritje të lehtë ndër vite (kjo në përputhje me zgjerimin e strukturës së KMD-së), por mbështetje e mëtijshme nevojitet me qëllim realizimin e kompetencave të zgjeruara të Komisionerit.

3. Rastet e shqyrtuara nga Komisioneri.

- Gjatë vitit 2016, janë trajtuar, 82 çështje (75 ankesa dhe 7 *ex-officio*), me subjekte: 38 meshkuj; 29 femra dhe 8 OJF.

- Çështjet e trajtuara janë drejtuar 80 institucioneve publike dhe 2 subjekteve private (5 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 75 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor).

- Sipas fushave: 16 arsim; 10 punësim dhe 56 shërbime.

- Në vitin 2016, Komisioneri është shprehur me 70 vendime dhe 2 rekomandime në fushën e arsimit. 70 vendimet e dhëna ndahen në: 51 vendime themeli, 13 vendime mospranimi; dhe 6 vendime me gjobë për mosdhënie informacioni. Vendimet kategorizohen si më poshtë:

- 7 vendime diskriminimi (4 vendime në fushën e arsimit janë zbatuar, 2 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë zbatuar dhe 1 vendim në fushën e të mirave dhe shërbimeve është kundërshtuar në gjykatë.)

- 32 vendime mosdiskriminimi;

- 13 vendime mospranimi;

- 9 vendime për arritje efektiviteti;

- 2 vendime për ndërprerje procedurash pasi është arritur efektiviteti;

- 1 vendim për ndërprerje procedurash pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa;

- 6 vendime me gjobë për mosdhënie informacioni.

4. Gjatë vitit 2017, janë trajtuar, 92 çështje (89 ankesa dhe 3 çështje *ex-officio*), me subjekte: 40 meshkuj; 39 femra, 6 grup-personash dhe 4 OJF.

- Çështjet e trajtuara janë drejtuar 11 të tilla kundër subjekteve private dhe 81 kundër institucioneve publike (6 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 75 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor).

- Sipas fushave: 5 arsim, 5 punësim dhe 82 shërbime.

5. Në vitin 2017, Komisioneri është shprehur me 72 vendime dhe 1 rekomandim në fushën e arsimit si më poshtë:

- 12 vendime diskriminimi (9 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë kundërshtuar në gjykatë, 1 vendim në fushën e të mirave dhe shërbimeve është zbatuar, 1 vendim në fushën e punësimit është zbatuar, 1 vendim në fushën e punësimit nuk është zbatuar dhe është dhënë vendim me gjobë);

- 26 vendime mosdiskriminimi;

- 24 vendime mospranimi;

- 3 vendime për arritje efektiviteti;

- 1 vendim ndërprerje procedurash hetimore, pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa;

- 4 vendime ndërprerje procedurash hetimore, për mungesë provash;

- 1 vendim gjobe për moszbatim vendimi;

- 1 vendim me gjobë mosdhënie informacioni.

6. Gjatë vitit 2018, janë trajtuar, 63 çështje (59 ankesa dhe 4 çështje *ex-officio*), me subjekte: 19 meshkuj; 20 femra, 9 grup-personash dhe 11 OJF.

- Çështjet e trajtuara janë drejtuar 7 të tilla kundër subjekteve private dhe 56 kundër institucioneve publike (6 çështje kundër



institucioneve të pushtetit qendror dhe 50 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor).

- Sipas fushave: 10 arsim, 5 punësim dhe 48 shërbime.

7. Gjatë vitit 2018, Komisioneri është shprehur me 64 vendime: 41 vendime themeli, 20 vendime mospranimi; dhe 1 vendim pezullim shqyrtimi, 2 vendime ndërprerje të procedurave. Vendimet kategorizohen si më poshtë:

- 10 vendime diskriminimi;
- 25 vendime mosdiskriminimi;
- 20 vendime mospranimi;
- 6 vendime për arritje efektiviteti;
- 1 vendim ndërprerjeje procedurash hetimore, pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa;
- 1 vendim ndërprerjeje procedurash hetimore, pasi çështja është paraqitur për gjykim në gjykatë;
- 1 vendim pezullim shqyrtimi.

8. Gjatë vitit 2019, janë trajtuar 35 çështje (33 ankesa dhe 2 çështje *ex-officio*), me subjekte: 9 meshkuj; 10 femra, 5 grup-personash dhe 9 OJF. 7 çështje kundër subjekteve private dhe 28 ndaj institucioneve publike (7 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 21 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor). Sipas fushave: 7 çështje mbi arsimin dhe 28 çështje mbi shërbimet.

9. Gjatë vitit 2019, Komisioneri është shprehur me 33 vendime: 26 vendime themeli, 4 vendime mospranimi dhe 3 vendime ndërprerje të procedurave, që kategorizohen:

- 12 vendime diskriminimi (7 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë zbatuar, 1 vendim në fushën e të mirave dhe shërbimeve është kundërshtuar në gjykatë, 2 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë ende në proces dhe 2 vendime në fushën e arsimit janë zbatuar);
- 9 vendime mosdiskriminimi;
- 4 vendime mospranimi;
- 5 vendime për arritje efektiviteti;
- 2 vendim ndërprerjeje procedurash hetimore, pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa;
- 1 vendim ndërprerjeje procedurash hetimore, për mungesë informacioni.

10. Gjatë vitit 2020, janë trajtuar, 16 çështje (15 ankesa dhe 1 çështje *ex-officio*), me subjekte: 4 meshkuj; 4 femra, 4 grup personash dhe 3 OJF.

- Çështjet e trajtuara janë: 2 të tilla kundër subjekteve private dhe 14 kundër institucioneve

publike (7 çështje kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe 7 çështje kundër institucioneve të pushtetit vendor).

- Sipas fushave: 2 arsim, 3 punësim dhe 11 shërbime.

11. Gjatë periudhës janar–nëntor 2020, Komisioneri është shprehur me 14 vendime: 12 vendime themeli dhe 2 vendime mospranimi, si më poshtë:

- 5 vendime diskriminimi (4 vendime në fushën e të mirave dhe shërbimeve janë në proces, 1 vendim në fushën e punësimit është kundërshtuar në gjykatë);
- 4 vendime mosdiskriminimi;
- 2 vendime mospranimi;
- 3 vendime për arritje efektiviteti;

12. Raste të trajtuara – tipologjia e problematikave:

- Problematika e furnizimit me energji elektrike për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane. Komisioneri urdhëroi Entin Rregullator të Energjisë Elektrike të marrë masa për ndryshimin e Rregullores, duke çliruar nga barra e pagesës së tarifës së lidhjes së re, aplikantët që trajtohen me statusin e “klientit në nevojë”, të cilët ndodhen në pamundësi financiare.

- Problematika e furnizimit me ujë të pijshëm, mungesa e kanalizimeve apo ndriçimit në zona ku pjesa më e madhe e banorëve u përkasin pakicave rome apo egjiptiane është trajtuar në disa raste nga Komisioneri në qytete të ndryshme, si: Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë. Në rastin e banorëve në Shkodër dhe Korçë, autoritetet kanë zbatuar vendimet e Komisionerit, duke zgjidhur problematikat e konstatuara.

- Problematika e përdorimit të terminologjisë së papërshtatshme për etiketimin e zonave të caktuara të cilët banohen nga anëtarë të pakicave rome ose egjiptiane, në dokumentacion zyrtar të përdorur nga ofruesi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike në qytetin e Shkodrës. Gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioneri operatori i furnizimit me energji elektrike në qytetin e Shkodrës mori masa të menjëhershme mbi problematikën.

- Problematika e braktisjes së shkollës nga fëmijët romë, për shkak të varfërisë. Institucionet përgjegjëse morën masat përkatëse për hapjen e klasave të arsimit bazë me kohë të pjesshme në shkollën 9-vjeçare “Agimi” Maliq, për vitin



shkollor 2020–2021, duke zgjidhur problematikën e adresuar pranë Komisionerit.

- Problematika e segregimit të fëmijëve që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane në shkolla të caktuara. Komisioneri konstatoi diskriminimin në formën e segregimit, të nxënësve romë dhe egjiptianë, që mësonin në shkollën 9-vjeçare “Liria” Shkodër dhe shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem, Shkodër dhe urdhëroi marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e situatës dhe parandalimin e situatave të tilla në të ardhmen.

- Gjuha e përdorur në media, medien sociale, ndaj pakicave rome, egjiptiane, nga gazeta, persona publike madje edhe deputetë, janë konsideruar nga KMD-ja si diskriminim ndaj këtyre grupeve.

- Largimi nga puna, nga punëdhënësi institucion publik, për një grua që i përkiste pakicës rome, është gjetur diskriminuese nga Komisioneri.

13. Lidhur me arsimimin e pakicave kombëtare, Komisioneri ka konstatuar problematikat e mëposhtme, të cilat i ka adresuar tek organet kompetente.

- Problematika e regjistrimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në kopshtet publike në qytetin e Tiranës. Bazuar në rekomandimin e Komisionerit, Bashkia Tiranë mori masa për përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom/egjiptian, si kategori, që përfiton shërbim pa pagesë në kopshtet dhe çerdhet publike të Tiranës.

- Problematika e segregimit të fëmijëve që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane në shkolla të caktuara është evidentuar nga Komisioneri. Problematikat me transportin e fëmijëve.

- Problematika e braktisjes së shkollës nga fëmijët romë për shkak të varfërisë. Përmes arsimit bazë të pjesshëm atyre mund t’u jepet mundësia për të përfunduar arsimin e detyrueshëm për t’u regjistruar më pas në arsimin e mesëm profesional dhe më tej.

14. Rekomandimet e KMD-së: në zbatim të nenit 32, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”. Rekomandimet kanë pasur si qëllim zbatimin e parimeve të ligjit, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”:

- për projektligjin, “Për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

- për projektaktin e ligjit, “Për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

- për projektligjin, “Për programet sociale të strehimit”, janë mbajtur parasysh propozimet;

- mbi projektligjin, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”;

- rekomandime për Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Plani i Veprimit, 2019–2022;

- rekomandim në lidhje me strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane, në zonën e Selitës, Tiranë;

- rekomandime mbi aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”;

- rekomandim (kuadër COVID-19) për miratimin e një fondi shtesë të skemës së ndihmës ekonomike, në vlerën prej 500 lekësh në muaj, për çdo fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, të cilët ndjekin rregullisht procesin mësimor;

- rekomandim (në kuadër COVID-19) për miratimin e një fondi shtesë për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuara, me qëllim përmbushjen e detyrimit për përdorimin e barrierave mbrojtëse (jashtë shtëpisë nga çdo individ);

- rekomandim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit mbi marrjen e masave për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, që u përkasin grupeve të disavantazuara, siç janë: fëmijët romë, egjiptianë me aftësi të kufizuara, fëmijët me aftësi të kufizuara nga familjet e varfra;

- rekomandim në lidhje me mbështetjen financiare nëpërmjet VKM-së nr. 236, datë 19.3.2020, “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, për përfshirjen në skemë të familjeve të cilat sigurojnë të ardhurat përmes punës informale, situatë kjo që prekte në një masë më të madhe anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane.

15. *Amicus curie*/palë e tretë në gjykatë: bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2014, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet shprehimisht se “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e



hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”. Komisioneri ka parashtruar mendimin e tij, si person i tretë, lidhur me çështjen objekt “Konstatimin e diskriminimit në formën e ‘Shqetësimit’ dhe ‘Diskriminimit të tërthortë’” ndaj paditësve anëtarë të pakicës rome dhe për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese përmes ndreqjes së shkeljeve ligjore.

16. Ndërgjegjësimi i pakicave nëpërmjet aktiviteteve të Komisionerit.

Rritja e ndërgjegjësimi të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të Komisionerit, gjithashtu, edhe e përfaqësuesve në zyrat rajonale në qytetin e Fierit, Shkodrës dhe Korçës. Aktivitetet ndërgjegjëse kanë qëllim nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sensibilizimin dhe informimin, ofrimin e informacioneve për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, aktivitetet konsistojnë, në:

- daljet publike të Komisionerit në medien vizive dhe të shkruar;
- shpërndarja e materialeve ndërgjegjëse dhe organizimi i ditëve të hapura;
- botimeve i fletëpalosjeve të KMD-së dhe botimeve të tjera;
- vazhdimin e fushatave ndërgjegjëse në shkollat 9-vjeçare;
- leksione të hapura me studentët; zhvillimi i aktiviteteve për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, organizatat joqeveritare.

17. Në fushën e strehimit janë trajtuar temat:

- diskriminimi në fushën e strehimit;
- mungesa e banesave dhe kushtet në të cilat jetojnë romët dhe egjiptianët;
- mungesa e të ardhurave, kusht për të pasur një banesë;
- dëbimi i romëve dhe i egjiptianëve nga banesat e tyre për shkak të ndërhyrjes në infrastrukturë;
- politikat sociale të Planit të Veprimit për romët dhe egjiptianët në fushën e strehimit.

18. Në fushën e punësimit janë kryer takime me grupe të ndryshme, siç janë gratë e dhunuara, të rinjtë dhe vetë komunitetin. Temat që janë trajtuar:

- Punësimi. Situata aktuale e tyre;
- Diskriminimi që ndodh në vendin e punës nëpërmjet institucionet dhe bizneset private;
- Punësimi informal;
- Kurset profesionale risi për t’u integruar në punë;

- Politikat e shtetit për këtë kategori dhe zbatueshmëria e tyre;

- Punësimi i të rinjve që kanë mbaruar arsimin e lartë.

19. Në fushën e arsimit janë trajtuar këto tema:

- Diskriminimi në arsimin parauniversitar.
- Braktisja e shkollës fenomen tepër shqetësues në ditët e sotme.

- Politikat sociale që ekzistojnë në fushën e arsimit parauniversitar dhe atë universitar.

- Promovimi i modeleve të suksesshme në komunitet.

- Promovimi i vlerave, kulturës traditave për romët dhe egjiptianët. Rruajtja e gjuhës rome.

- Përfshirja e mësuesve romë dhe egjiptianë në sistemin e arsimit parauniversitar.

- Arsimi mjet që të çon drejt integritetit shoqëror. Arsimimi në kohë pandemie.

20. Në vendimmarrje:

- njohja me miratimin e ligjit për pakicat kombëtare;
- diskriminimi në institucionet. Punësimi në administratë publike;
- rëndësia e votës. Përfshirja në këshillat bashkiakë dhe institucionet qendrore;
- regjistrimi i fëmijëve, fenomen që sjell problematika sociale për shfrytëzim dhe trafikim të qenieve njerëzore.

21. Në fushën e shëndetit:

- Diskriminimi në fushën e shëndetit.
- Marrja e shërbimeve në ambientet shëndetësore dhe spitalore; Kushtet higjieno-sanitare të banesave në kohën e pandemisë.

22. Memorandumi i Bashkëpunimit mbi Luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes”, u nënshkrua gjatë konferencës kombëtare “Liria pa urrejtje” (dhjetor 2019), e cila u organizua nga Avokati i Popullit dhe u mbështet nga programi “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022”.

23. Aleanca ka për objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

- të luftojë gjuhën e urrejtjes nëpërmjet ngritjes së vetëdijes, informimit dhe kontributit në një dialog kombëtar, duke krijuar ura dialogu dhe bashkëveprimi me shoqërinë civile dhe organet publike, mbi pasojat e gjuhës së urrejtjes, ndikimin e saj në zhvillimin demokratik të vendit dhe reduktimin e këtij fenomeni në shoqërinë shqiptare;



- të promovojë lirinë e shprehjes si domosdoshmëri të një shoqërie demokratike duke lehtësuar një debat të hapur dhe sensibilizues për publikun për promovimin e lajmit në mënyrë korrekte dhe etike, promovimin e diversitetit në media dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri;

- të sigurojë një harmonizim më të plotë ndërmjet legjislacionit civil dhe atij penal kundër diskriminimit. Të nxisë publikimin e rregullt dhe të saktë të statistikave për gjuhën e urrejtjes sipas Kodit Penal;

- të sensibilizojë dhe intensifikojë përpjekjet për të parandaluar përdorimin e gjuhës së urrejtjes në internet dhe/ose në mediet sociale, si dhe mënyrat për ta luftuar atë;

- të rrisë aftësimin e mësuesve, si dhe forcimin e përpjekjeve në mjedisin arsimor të të gjitha niveleve ndaj fenomeneve negative të gjuhës së urrejtjes dhe parandalimin e saj;

- të rrisë ndërgjegjësimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, për detyrimin që kanë për të parandaluar dhe adresuar gjuhën e urrejtjes, krimet e urrejtjes dhe ngacmimit në vendin e punës, si dhe garantimin e përpjekjeve sistematike për luftimin e saj në fushën e shëndetit, sigurisë dhe mjedisin e vendit të punë;

- në realizimin e këtyre objektivave, Aleanca synon të ftojë dhe bashkëpunojë ngushtësisht me individë apo organizatat e shoqërisë civile, si dhe organet publike në të gjitha nivelet për të eliminuar gjuhën e urrejtjes dhe pasojat e saj negative në shoqërinë shqiptare.

Aneks nr. 6 – Informimi në gjuhën e pakicave kombëtare dhe COVID-19

1. Në kuadër të aktiviteteve të zbatimit të Instrumentit Horizontal Facility II, lidhur me “Promovimin e diversitetit dhe barazisë në Shqipëri”, Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë në bashkëpunim me Institutin për Shëndetin Publik, në muajin prill 2020, mundësoi përkthimin në gjuhët përkatëse të pakicave kombëtare të broshurës “Informacion mbi virusin COVID-19”.

2. Kjo iniciativë u mbështet, gjithashtu, nga veprimi i përbashkët “Romacted” i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Komiteti i Pakicave Kombëtare, Shtëpia e Evropës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Broshura e përgatitur përmes informacionit të siguruar nga Instituti i Shëndetit Publik, përmban informacion të rëndësishëm mbi masat e sigurisë COVID-19, informacion mbi rregullat për parandalimin dhe trajtimin e pandemisë COVID-19. Broshurat e përkthyer në 8 gjuhë të pakicave kombëtare u janë vënë në dispozicion pakicave kombëtare greke, maqedonase, malazeze serbe, bullgare, boshnjake, vllahe, rome. Këto broshura janë, gjithashtu, të aksesueshme në internet²⁸.

Aneks nr. 7 – Informacion mbi projektet që po zbatohen në kuadër të Instrumentit Horizontal Facility, faza II

1. Në Shqipëri po zbatohet Instrumenti Horizontal Facility (HF) për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, 2019–2022, i cili është një Program Bashkëpunimi i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Faza e dytë e HF-së për Ballkanin Perëndimor (ku përfshihet edhe vendi ynë) zbatohet për një periudhë 3-vjeçare (2019–2022), financohet nga Bashkimi Evropian BE dhe Këshilli i Evropës KE (respektivisht 85% dhe 15%), si dhe projektet zbatohen nga Këshilli i Evropës. Fushat e veprimit janë: sistemi i drejtësisë; lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; barazia, antidiskriminimi dhe të drejtat e njeriut; liria e shprehjes dhe media. Programi Horizontal Facility faza II në Shqipëri (2019–2022) me një buxhet të dedikuar prej mbi 4 milionë eurosh përfshin gjashtë fusha veprimi në mbështetje të zbatimit të reformave, në lidhje me: gjyqësorin, të drejtat e pronës, sistemin penitenciar, luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, barazinë dhe mosdiskriminimin, lirinë e shprehjes dhe medias. Pavarësisht efekteve të pandemisë COVID-19 në zbatimin e veprimeve në kuadrin e fazës së dytë të HF-së në Shqipëri, rezultate të dukshme u arritën gjatë vitit të dytë të zbatimit (viti 2020 – mars 2021).

2. Disa nga arritjet kryesore të zbatimit të Instrumentit Horizontal Facility në Shqipëri gjatë 2020–2021, konkretisht në fushën e

²⁸ Informacioni gjendet i publikuar në shqip dhe anglisht në faqen e internetit të Zyrës së Këshillit të Evropës, Tiranë:

<https://www.coe.int/sq/web/tirana/-/covid19-outbreak-information-in-minority-language-1>
<https://www.coe.int/en/web/tirana/-/covid19-outbreak-information-in-minority-language-1>



antidiskriminimit dhe promovimit të diversitetit, janë:

- Në fushën e antidiskriminimit dhe promovimit të diversitetit, ekspertiza ndërkombëtare është siguruar për t'i sjellë ato në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Këshillit të Evropës për Racizmin dhe Intolerancën (ECRI) dhe Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, konkretisht:

- gjatë hartimit të akteve nënligjore të ligjit mbi pakicat kombëtare;

- ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ligjit të regjistrimit;

- iniciativat për rritjen e ndërgjegjësimit u përqendruan në promovimin e të drejtave LGBTI dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes. Është siguruar ekspertizë në vlerësimin e planit kombëtar të veprimit LGBTI 2016–2020 dhe në përgatitjen e planit të ri 2021–2027.

- Në fushën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias është siguruar mbështetje e aktorëve lokalë në përpjekjet e tyre për të siguruar një mbrojtje më të mirë për gazetarët. Në shtator 2020, Aleanca Shqiptare për Median Etike u themelua me mbështetjen e programit dhe krijoi një mekanizëm vetërregullimi, i cili po angazhon në mënyrë aktive dhe ndihmon mediat, veçanërisht ato në internet, të respektojnë Kodin Gazetar të Etikës.

Aneks nr. 8: Tekstet e plota të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 96/2017, “Për pakicat kombëtare”

VENDIM nr. 561, datë 29.9.2018

“PËR PAJISJEN ME TEKSTE SHKOLLORE TË NXËNËSVE, FORMIMIN FILLESTAR, ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM PROFESIONAL TË MËSUESVE, SI DHE PËR KRIJIMIN E FUNKSIONIMIT E KLASAVE NË GJUHËN E PAKICAVE KOMBËTARE

Fletore Zyrtare nr. 143

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësve të arsimit bazë të pakicave kombëtare, të cilët mësojnë dhe/ose mësohen në gjuhën e pakicës kombëtare, u sigurohen tekstet shkollorë falas.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin bashkërendon punën me institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore dhe shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, për nevojat e formimit fillestar për mësues që do të zhvillojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare.

3. Trajnimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve që zhvillojnë mësim në gjuhën e pakicave kombëtare financohet me fondet e buxhetit të shtetit. Mësuesit trajnohen, të paktën 3 (tri) ditë në vit, me programe trajnimi të akredituara. Njësitë arsimore vendore organizojnë, koordinojnë dhe mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në nivel institucioni arsimor.

Procedurat e trajnimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve në nivel institucioni arsimor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga:

a) njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse;

b) njësia arsimore vendore përkatëse;

c) komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare.

5. Për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, kryetari i bashkisë dhe titullari i njësisë përkatëse arsimore vendore, pas konsultimit me

përfaqësues të pakicave kombëtare, i paraqesin propozimin përkatës ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Propozimi për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në institucionet arsimore parauniversitare publike shoqërohet me studimin mbi argumentimin e domosdoshmërisë së hapjes së klasave me nxënës të pakicave kombëtare, si dhe me kontributin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

7. Propozimi për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare paraqitet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para fillimit të vitit mësimor.

8. Klasat në gjuhën e pakicave kombëtare hapen kur plotësohen kriteret si më poshtë vijnë:

a) ndërtesa e institucionit arsimor dhe mjediset e saj të plotësojnë standardet sipas legjislacionit në fuqi;

b) institucioni arsimor të jetë i pajisur me mjete mësimore për funksionimin normal të procesit mësimor;



c) numri i nxënësve të pakicave kombëtare të jetë jo më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë;

ç) personeli mësimor i klasave me nxënës të pakicave kombëtare plotëson kriteret profesionale dhe është emëruar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

9. Në kushte të veçanta, kur numri i fëmijëve apo i nxënësve të pakicave kombëtare është më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë, funksionimi i klasave në gjuhën amtare të pakicës kombëtare bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Efektet financiare për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare të parashikohen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

11. Nisma për mbylljen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga:

- a) ministri përgjegjës për arsimin;
- b) njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse;
- c) njësia arsimore vendore përkatëse.

12. Kryetari i bashkisë dhe titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse, në rastet kur institucioni arsimor nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi, i paraqesin ministrit përgjegjës për arsimin propozimin për mbylljen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare në institucionin arsimor publik, pas konsultimit me përfaqësues të komunitetit të pakicës kombëtare, ku ndodhet institucioni arsimor publik.

13. Hapja dhe mbyllja e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

14. E drejta për arsim në gjuhën e pakicës kombëtare nuk duhet të cenojë mësimin e gjuhës shqipe.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM nr. 562, datë 29.9.2018

Fletore zyrtare nr. 143

PËR MASAT E PËRSHTATSHME PËR NXITJEN E NJOHJES SË KULTURËS, HISTORISË, GJUHËS DHE BESIMIT FETAR TË PAKICAVE KOMBËTARE NË VEPRIM-TARINË MËSIMORE DHE SHKENCORE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, të përfshijnë në veprimtarinë e tyre mësimore njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit të përfshijnë, të mbështesin dhe të inkurajojnë realizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore lidhur me njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nëpërmjet aktiviteteve, fushatave sensibilizuese dhe koordinimit me institucionet e arsimit të lartë, promovon njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

4. Efektet financiare të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve, fushatave sensibilizuese që do të ndërmerren me nismën e ministrisë përgjegjëse për arsimin, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore e shkencore, të realizuara nga institucionet e arsimit të lartë, do të përballohen nga të ardhurat e vetë institucioneve të arsimit të lartë.



5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM nr. 462, datë 3.7.2019

Fletore Zyrtare nr. 97

PËR MIRATIMIN E MASAVE DHE TË POLITIKAVE TË NEVOJSHME PËR TË SIGURUAR PJESËMARRJEN E PERSONAVE, QË U PËRKASIN PAKICAVE KOMBËTARE, NË JETËN PUBLIKE, KULTURORE, SOCIALE DHE EKONOMIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për sigurimin e pjesëmarrjes së personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike.

2. Personave, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, u garantohet pjesëmarrje e barabartë në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit.

3. Personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, gëzojnë, në veçanti, të drejta lidhur me çështjet për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kulturës, të traditave dhe identitetit të pakicës, së cilës ata i përkasin.

4. Ministria e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj, në të gjitha veprimtaritë që zhvillojnë, të trajtojnë si pasuri kombëtare pjesën e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare, duke mbrojtur e promovuar të drejtën e tyre për pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën kulturore të vendit, në drejtim të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të kulturës, traditave dhe identitetit të pakicës, së cilës ata i përkasin.

5. Ministria e Kulturës, në projektet me thirrje, që organizon çdo vit, të mbështesë financiarisht, bazuar edhe në nivelin cilësor, projektet e

personave që u përkasin pakicave kombëtare në drejtim të mbrojtjes së identitetit kulturor, etnik e gjuhësor dhe trashëgiminë kulturore të tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të pakicave kombëtare në projekte të ndryshme bëhen në përputhje me ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, dhe udhëzimin e përvitshëm që nxjerr Ministria e Kulturës, “Për thirrjet për projektpropozime”.

7. Nga numri i përgjithshëm i projekteve që do të financohen, 5 (pesë) për qind e tyre të mbështeten me burime financiare, logjistike dhe/ose materiale për shoqata kulturore/individë, të cilët kanë aplikuar dhe që u përkasin pakicave kombëtare.

8. Ministria e Kulturës harton politika të posaçme, me qëllim mbështetjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si dhe ata të konsideruar vulnerabël, në drejtim të mbrojtjes së identitetit të tyre kulturor, etnik e gjuhësor dhe trashëgimisë së tyre kulturore.

9. Ministria e Kulturës garanton përfshirjen e personave përfaqësues të pakicave kombëtare në procesin e konsultimit e të vendimmarrjes lidhur me çështjet që prekin personat që u përkasin pakicave kombëtare, si politikat e kuadrit ligjor dhe politikat e masat për të siguruar pjesëmarrjen në jetën kulturore të vendit, në drejtim të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të kulturës, traditave dhe identitetit të pakicës kombëtare, së cilës ata i përkasin.

10. Ministria e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj marrin masa për krijimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen efektive të personave, që u përkasin pakicave kombëtare, sipas specifikave të çdo institucioni, në aktivitetet që ato organizojnë.

11. Personat, që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë në mënyrë të barabartë me shtetasit e tjerë dhe pa diskriminim pagesat për ndihmë ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet shoqërore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale konsultohet me organizatat përfaqësuese të pakicave kombëtare për hartimin e kuadrit ligjor dhe të politikave, të cilat ndikojnë në situatën social-ekonomike të tyre.



13. Personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim nga programet aktive të tregut të punës dhe të arsimit e formimit profesional.

14. Personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit e të trajtimit të barabartë në veprimtaritë ekonomike të vendit.

15. Ministritë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi marrin masat e nevojshme dhe evidentojnë konkretisht krijimin e kushteve për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë, pa diskriminim, dhe pjesëmarrjen efektive në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

16. Burimet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të mbulohen nga buxheti vjetor, që parashikohet çdo vit për ministritë përgjegjëse për zbatimin e tij.

17. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM nr. 463, datë 3.7.2019

Fletore Zyrtare nr. 97

PËR PËRCAKTIMIN E DREJTIMEVE PËR MIRATIMIN E STRATEGJIVE, PROGRAMEVE DHE PLANEVE TË VEPRIMIT PËR PROMOVIMIN DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE TË NEVOJSHME PËR PERSONAT QË U PËRKASIN PAKICAVE KOMBËTARE PËR TË PËRDORUR E ZHVILLUAR ELEMENTET THEMELORE TË IDENTITETIT TË PAKICAVE KOMBËTARE, DUKE PËRFSHIRË DHE GJUHËN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre të dallueshëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Ministria përgjegjëse në fushën e kulturës dhe ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë kanë detyrimin për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve e të planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat, që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur e zhvilluar elementet themelore të identitetit të tyre.

3. Ministria përgjegjëse në fushën e kulturës dhe ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë garantojnë mbrojtjen dhe promovimin e gjuhës së personave, që u përkasin pakicave kombëtare si një element përbërës të identitetit të tyre.

4. Ministria përgjegjëse për kulturën dhe institucionet në varësi të saj marrin masat për të krijuar kushtet e nevojshme për garantimin dhe ushtrimin e së drejtës së personave, që u përkasin pakicave kombëtare për ruajtjen e zhvillimin e identitetit të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor e fetar të tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Ministria përgjegjëse për kulturën, në strategjinë për kulturën dhe në programin kombëtar “Edukimi përmes kulturës” parashikon dhe krijon kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen, katalogimin e digjitalizimin për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare dhe ndalimin e praktikave, që synojnë asimilimin e kulturës dhe të identitetit të tyre të dallueshëm.

6. Ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë planifikon veprimtari të veçanta për institucionet publike të arsimit parauniversitar, me qëllim ruajtjen, promovimin, zhvillimin e kulturave, identitetin kulturor të dallueshëm dhe të gjuhëve të pakicave kombëtare.

7. Ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë mbështet të rinjtë e organizatat rinore për organizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe promovuese për ruajtjen e zhvillimin e kulturave, të identitetit dhe të gjuhëve të pakicave kombëtare, si dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare.



8. Ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë dhe ministria përgjegjëse në fushën e kulturës promovojnë programe e projekte për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave, gjuhëve dhe elementeve kryesore të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare, zhvillimin e aktiviteteve në konsultim me ta dhe përfaqësuesit e tyre, bazuar në nevojat e grupeve të ndryshme dhe në përputhje me procedura transparente.

9. Kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, ku aplikojnë përfaqësues të pakicave kombëtare janë të parashikuara në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

10. Personat që u përkasin pakicave kombëtare dhe përfaqësuesit e tyre ftohen të marrin pjesë në procesin e konsultimit gjatë hartimit dhe miratimit të strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm në Republikën e Shqipërisë.

11. Burimet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të mbulohen nga buxheti vjetor që parashikohet çdo vit për ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM nr. 726, datë 12.12.2018

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT PËR PAKICAT KOMBËTARE

Fletore Zyrtare nr. 176

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti për Pakicat Kombëtare është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. Komiteti për Pakicat Kombëtare ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

3. Komiteti për Pakicat Kombëtare ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Kryeministria, Komiteti për Pakicat Kombëtare”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

4. Vula e Komitetit për Pakicat Kombëtare ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Komiteti për Pakicat Kombëtare e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Komiteti për Pakicat Kombëtare organizohet në nivel qendror.

7. Komiteti për Pakicat Kombëtare drejtohet nga kryetari, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e këtij institucioni, raporton dhe përgjigjet përpara Kryeministrit.

8. Komiteti për Pakicat Kombëtare ushtron kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

9. Organizimi i brendshëm, struktura dhe organika e Komitetit për Pakicat Kombëtare miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

10. Komiteti për Pakicat Kombëtare financohet nga buxheti i shtetit.

11. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Komitetit për Pakicat Kombëtare miratohet nga Kryeministri, pas propozimit të kryetarit të Komitetit për Pakicat Kombëtare.



12. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

13. Për nëpunësit civilë aktualë të Komitetit Shtetëror për Minoritetet zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

14. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Komitetit për Pakicat Kombëtare, sipas këtij vendimi, strukturat aktuale të Komitetit Shtetëror për Minoritetet vazhdojnë funksionimin e tyre sipas strukturave dhe organikave të miratuara.

15. Vendimi nr. 127, datë 11.3.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet”, i ndryshuar, shfuqizohet.

16. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM nr. 286, datë 10.5.2019

Fletore Zyrtare nr. 71, faqe: 5315

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË KRYETARIT, NËNKRYETARIT DHE ANËTARËVE TË KOMITETIT PËR PAKICAT KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare (në vijim “KPK”), nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent e gjithëpërfshirës.

2. Përzgjedhja e kandidaturave për kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e KPK-së kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura e publike të konkurrimit, nga Kryeministria, bazuar në pikën 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për

mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

3. Për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes për kryetarin/nënkryetarin, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ngre komisionin *ad-hoc*, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të caktuar prej tij.

4. Kandidatët për kryetar dhe nënkryetar të KPK-së duhet të plotësojnë këto kriteret:

a) të jenë persona që u përkasin pakicave kombëtare, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

b) të jenë personalitete të shquara, me kontribute të spikatura në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare;

c) të kenë eksperiencë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare.

5. Shpallja e vendit të lirë për pozicionin kryetar dhe nënkryetar të KPK-së bëhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e përfundimit të mandatit të kryetarit dhe/ose nënkryetarit në detyrë, në Buletinin e Njoftimeve Publike, në faqen zyrtare elektronike të Kryeministrisë dhe të KPK-së, për një periudhë 30-ditore.

6. Njoftimi për shpalljen përmban kriteret e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit.

7. Komisioni *ad-hoc* bën vlerësimin e kandidaturave të paraqitura brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit, harton listën e kandidatëve të kualifikuar për kryetar dhe/ose nënkryetar të KPK-së, sipas renditjes së pikëve të grumbulluara, dhe ia propozon Kryeministrit.

8. Procesi i përzgjedhjes dhe i emërimit të anëtarëve të KPK-së zhvillohet pas emërimit të kryetarit dhe të nënkryetarit të këtij institucioni.

9. Të drejtën e propozimit të një kandidati për pozicionin e anëtarit të KPK-së e gëzon çdo shoqatë e regjistruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicës kombëtare përkatëse, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

